


VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT LOKAL TË BASHKISË KORCE

RAPORTI MJEDISOR I QYTETIT TË KORCES



TP Development Group

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	6
1.1 Qëllimi i Raportit	6
1.2 Autoritetet Përgjegjëse	7
1.3 Ekipi i Konsulencës	7
1.4 Një përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së Planit	8
1.5 Metodologjia dhe përmbajtja e Raportit Mjedisor të VSM	10
2. Analiza e situatës së sotme të kushteve mjedisore të zonës në studim	15
2.1 Shëndeti i popullatës dhe Mjedisi natyror	15
2.1.1 Biodiversiteti, Fauna & Flora, Pyje dhe Zonat Natyrore	15
a) Biodiversiteti, Fauna & Flora	15
b) Zonat e rëndësishme natyrore dhe ato të mbrojtura	18
2.1.2 Trupat ujore	19
a) Uji i Pijshe	19
2.1.3 Toka	22
a) Kushtet e tokës, Përdorimi i Pesticideve	22
2.1.4 Klima dhe Cilësia e Ajrit	23
a) Kushtet Klimaterike	23
b) Cilësia e Ajrit dhe Ndotja	24
2.1.5 Menaxhimi i mbetjeve dhe struktura mjedisore	25
a) Menaxhimi i mbetjeve të ngurta	25
b) Mbetjet ujore dhe ujërat e zeza	26
2.1.6 Zhurmat dhe Ndotja akustike	27
2.2 Struktura urbane	28
2.2.1 Përdorimi i tokës dhe struktura e zhvillimit	28
a) Përcaktimi i përgjithshëm i përdorimit të tokës	28
b) Qendra e qytetit	29
c) Zonat Rezidenciale	29
d) Zonat tregtare dhe industriale	30
e) Shërbimet Publike	30
f) Parqet dhe Hapësirat e hapura	31
2.2.2 Aksesueshmeria dhe Rrjeti i Transportit	31
a) Rrjeti Rrugor Kombëtar dhe Rajonal	31
b) Sistemi Rrugor Ekzistues Bashkiak	32

c) Transporti Publik	33
2.2.3 Energjia dhe Telekomunikacioni	33
a) Furnizimi me Energji	33
b) Telekomunikacioni	34
2.3 Peizazhi Urban dhe Trashëgimia Kulturore	34
2.4 Profili socio-ekonomik	35
2.4.1 Profili social dhe demografik	35
2.4.2 Profili ekonomik	36
2.4.3 Aktivitetet primare të sektorit dhe rezultatet	37
2.4.4 Financat lokale	40
2.4.5 Aktivitetet aktuale dhe të ardhshme ekonomike	40
2.5 Presionet më të mëdha mjedisore	41
a) Sfidat kryesore mjedisore	47
3. Objektivat Kombëtare dhe Ndërkombëtare për një Zhvillim të Qëndrueshëm- Përfshirja e Objektive në Plan	52
3.1 Hyrje	52
3.2 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar	53
a) Biodiversiteti	53
b) Menaxhimi i Burimeve Ujore	55
c) Mbrojtja e Tokës	58
d) Cilësia e Ajrit	60
e) Ndryshimet Klimaterike	63
f) Menaxhimi mbetjeve	64
g) Ndotja Akustike	66
3.3 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar	68
3.4 Permbledhja e Objektiveve	77
3.5 Bashkëngjitja e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm në Plan	81
4. Skenarët Alternative	84
4.1 Hyrje	84
4.2 Vlerësimi i skenarëve	86
4.2.1 Skenari Zero	86
4.2.2 Skenari 2: Permiresimi i Mjedisit dhe Ruajtja e Trashëgimise Kulturore	88
4.2.3 Skenari 3: Nxitja e zhvillimit ekonomik	91
4.2.4 Skenari 4 Skenari i Planit Urbanistik	95

5. Vlerësimi i efekteve të pritshme mjedisore të Planit dhe masat për parandalimin / zbutjen e tyre	98
5.1 Metodologjia e realizimit të vlerësimit	98
5.2 Zbërthimi i planit të Korçes	100
5.3 Vlerësim i detajuar i efekteve të pritshme mjedisore nga zbatimi i planit lokal dhe masat parandaluese/zbutëse	127
6. Vlerësimi i përgjithshëm i sistemit të Monitorimit të PPV-se	129
6.1 Vlerësim i Përgjithshëm	129
6.2 Sistemi i Monitorimit	130
7. Studime Referuese Kryesore	148
8. Vështirësitë e hasura	150
9. Përmbledhje jo-teknike	153
10. Referenca	159

Lista e Tabelave

Tabela 1 : Shpërndarja e përdorimit të tokës në Qarkun e Korçës (Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit)	22
Tabela 2- Të dhënat kryesore të klimës në Korçë	23
Tabela 3- Cilësia e ajrit ndër vite në qytetin e Korçës	24
Tabela 4-Disa vlera të gazeve të ndryshëm në Korçë	24
Tabela 5- Monitorimi i zhurmave në Korçë	27
Tabela 6: Shpërndarja e përdorimit të tokës në Qarkun e Korçës (Burimi: Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit)	28
Tabela 7: Shpërndarja e fasiliteve publike në Qarkun e Korçës (Burimi:Qarku Korçe)	31
Tabela 8 : Zona e Mbrojtur në Qarkun e Korçës (Burimi: Qarku i Korçës)	35
Tabela 9: Popullsia e qytetit të Korçës, 2001 – 2008/9	36
Tabela 10: Popullsia e regjistruar në qytetin e Korçës në vitin 2008 sipas gjinisë	36
Tabela 11: Popullsia e regjistruar në qytetin e Korçës në vitin 2008 sipas grupmoshave	36
Tabela 12: Ndryshimi i popullsisë në Korçë, 2008	36
Tabela 13 : Punesimi në sektore primare e sekondare Korça, 2009	37
Tabela 14- Synimet e ujit të pijshëm –Qyteti i Korçës	133
Tabela 15 Normat dhe synimet për cilësitë fiziko-kimike	133
Tabela 16.- Indeksi mikrobiologjik i ujit të pijshëm Bashkia Korçë	134
Tabela 17 : Shpërndarja e përdorimit të tokës në Qarkun e Korçës dhe synimet	135
Tabela 18- Ndotësit e ajrit që duhen monitoruar në Bashkinë e Korçës	136
Tabela 19- Synimet për reduktimin e mbetjeve	139
Tabela 20- Synimet për reduktimin e ujërave të ndotura	139
Tabela 21- Monitorim dhe shtim i sipërfaqeve të gjelbra	140

Tabela 22- Monitorimi i industrive

140

Lista e Figurave

Figura 1: Akset këmbësore të gjelbërta në qytetin e Korçës	17
Figura 2: Zona e Parkut të ardhshëm Shetro	17
Figura 3: Hapësira të lira në banesat socialiste	17
Figura 4: Zonat kryesore të rekreacionit dhe sporteve të qytetit të Korçës	17
Figura 5: Kodrat e Moravës: Situata aktuale	18
Figura 6: Tokë e zonës industriale për rehabilitim	21
Figura 7: Vendgrumbullimi i mbetjeve Korcë	25
Figura 8: Vendonodhja e impiantit të trajtimit ujërave	27

Akronime

AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit Territorial
ARZH	Agjencia Rajonale e Zhvillimit
B1	Mbrojtja e Biodiversitetit
BE	Bashkimi Evropian
CA	Cilësia e Ajrit
COGAP	Kodi i Praktikave të mira Bujqësore (Code of Good Agriculture Practice)
DUP	Direktiva e Ujit të Pijshëm
EIMS	Shërbimi i Menaxhimit të Ndikimit Mjedisor (Environment Impact of Management Service)
GIS	Geographic Information System (Sistemet të Informacionit Gjeografik)
INSTAT	Instituti i Statistikave, Republika e Shqipërisë
IPPC	Integrated Pollution Prevention and Control
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KE	Këshilli European
LAMP	Projekti për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës
MBU	Menaxhimi i Burimeve Ujore
MDG	Millennium Development Goals
MM	Menaxhimi i Mbetjeve
MT	Mbrojtja e Tokës
NA	Ndotja e Ajrit
NK	Ndryshimi i Klimës
NSDI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
NVM	Ndërmarrjet e Vogla te Mesme
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PT	Planifikimi i Territorit
QKZH	Qendra për Kërkim dhe Zhvillim
SKM	Strategjia Kombëtare e Mjedisit
ToR	Termet e References
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (United Nations Development Programme)
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
VSM	Vleresimi Strategjik Mjedisor
WHO	Organizata Botërore Shëndetësisë

1 Hyrje

1.1 Qëllimi i Raportit

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një nga kërkesat për aprovimin e çdo plani hapësinor në Shqipëri bazuar kjo në Ligjin e ri 1019/2009 “Për Planifikimin e Territorit”, si dhe në përputhje me specifikimet e Ligjit 91/2013 për “Vlerësimin Strategjik Mjedisor” dhe ligjit 10440/2011 për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

Ligji 91/2013 i miratuar se fundmi, për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, ka ratifikuar Direktivën e BE 2001/42/EC (EU Directive 2001/42/EC), e njohur si Direktiva VSM (SEA Directive), e cila kërkon një seri planesh dhe programesh që duhen të ndërmerren për një proces Vlerësimi Mjedisor në nivel Strategjik. Qëllimi i përgjithshëm i këtij procesi është ndërthurja e kërkesave mjedisore në përgatitjet e planifikimeve dhe procesin e vendimmarrjes, në përmirësimin e planeve, që bëjnë të mundur mbrojtjen e mjedisit sikurse edhe rritja e pjesëmarrjes së komunitetit (publikut) në procesin e vendimmarrjes për problematikën e lidhur me mjedisin. Ky proces përfshin përgatitjen e një Raporti Mjedisor, i cili është objekt aprovimi i Këshillit Bashkiak.

Ky raport, që njihet si **Raporti Mjedisor**, është përgatitur për të vlerësuar efektet mbi mjedisin dhe shëndetin publik të Instrumentit të Përgjithshëm të Bashkisë Korçe. Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor që shoqëron Instrumentin e Përgjithshëm Vendor të Korces është përgatitur duke mbajtur parasysh kërkesat e nenit 7 të Ligjit 91/2013 për fazat neper te cilat duhet te kaloje procesi si dhe nenin 10 te te njëjtit ligj lidhur me përmbajtjen dhe gjithë informacionin që duhet paraqitur ne këtë raport:

1. Përmbajtja dhe objektivat kryesore të planit ose programit dhe lidhjet e tij me planet e programet e tjera;
2. Aspekte të rëndësishme të kushteve ekzistuese mjedisore dhe shëndetësore si dhe zhvillimet e mundshme në rast se Plani nuk zbatohet;
3. Karakteristikat mjedisore dhe shëndetësore të zonës të cilat mund të ndikohen në mënyrë të dukshme;
4. Çështje mjedisore dhe shëndetësore që lidhen me planin ose programin;
5. Objektivat mjedisore dhe shëndetësore të vendosura në nivel kombëtar, ndërkombëtar etj, që janë të rëndësishme për planin apo programin dhe mënyrën se si këto objektiva dhe çështje të tjera mjedisore dhe shëndetësore janë marrë parasysh në përgatitjen e këtij plani apo programi;
6. Pasojat mjedisore dhe shëndetësore më të rëndësishme, ku përfshihen këtu ato mbi shëndetin publik, florën dhe faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, cilësinë e ujit dhe të ajrit, peizazhin, qendrat natyrore, asetet materiale, trashëgiminë kulturore, si dhe ndërveprimin e këtyre faktorëve; këto efekte duhet të përfshijnë edhe efekte

- anësore, kumulative, sinergjike, efekte afat shkurtër, të mesëm apo të gjatë; të përhershme apo të përkohshme, pozitive apo negative;
7. Masat që duhen të ndërmerren për të evituar, parandaluar, reduktuar çdo impakt mbi mjedisin dhe shëndetin, që mund të nevojiten gjatë zbatimit të planit apo programit;
 8. Një përshkrim të arsyeve të përzgjedhjes së alternativave së bashku më përshkrimin se si është kryer vlerësimi, duke përfshirë këtu edhe vështirësitë e hasura në grumbullimin e informacioneve, të metat teknike dhe mungesa e njohurive;
 9. Masat e marra për monitorimin e pasojave mjedisore dhe shëndetësore në vënien në zbatimin të planit apo programit;
 10. Pasojat e mundshme ndërkufitare në mjedis dhe shëndet publik; si dhe
 11. Një përmbledhje jo teknike të informacionit të grumbulluar.

Ky studim VSM u krye për një zonë me një sipërfaqe prej 2,143 Ha, e cila i korrespondon territorit brenda kufirit administrativ të Bashkisë për një popullsi prej 87.000 banorësh dhe i referohet një periudhe 10 vjeçare në përputhje me planin e propozuar.

1.2 Autoritetet Përgjegjëse

Autoriteti përgjegjës për VSM është Bashkia e Korces, e cila është edhe Klienti. Raporti është përgatitur në kuadrin e plotësimit të dosjes së Planit Lokal të Korces që do t'i dorëzohet për aprovim Këshillit Bashkiak. Drafti i Planit të qytetit u fillua dhe u drejtua sipas Projektit të Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës (LAMP), me fondet e Bankës Botërore pa një kërkesë për implementimin e VSM. Duke pasur parasysh se ky studim është i kërkuar sipas ligjit të ri nr. 10119 i vitit 2009, siç është e cituar deri tani, kompanisë tonë konsulente TP DEVELOPMENT GROUP, Tirane, iu kërkuua nga kryetari i Bashkisë Korce, të përgatisë Studimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, të referuar në nenin 48 të Ligjit të ri të urbanistikës nr. 10119/2009.

1.3 Ekipi i Konsulencës

Plani Urbanistik i Korces u drejtua në përputhje me Kontratën e lidhur midis Kompanive të Konsulencës: "*Lerman Architects & Town Planner Ltd*"; "*Thymio Papayannis Inc.*" dhe Qendrës për Kërkim dhe Zhvillim e mbikëqyrur nga Ministria e Transportit dhe e Punëve Publike dhe BB dhe rishikuar në vitin 2012 konform me Ligjin e ri 1019/2009 "*Për Planifikimin e Territorit*", nga TP DEVELOPMENT GROUP, Tirane.

Ekipi i Konsulencës përbëhet kryesisht në pjesën më të madhe të tij nga kompanitë që kanë përgatitur Planin e përgjithshëm Urban të Bashkisë së Korces. Pjesë e këtij ekipi janë bërë edhe disa ekspertë të tjerë vendas dhe të huaj, me një eksperiencë dhe reputacion të lartë në fushën e mjedisit. Pra ky studim u realizua kryesisht nga i njëjti

ekip (me kontributin shtesë edhe të ekspertit të mjedisit), i cili hartoi me sukses Planin Urbanistik të Korces dhe që do të shërbejë edhe si një garanci për një punë të suksesshme në këtë nivel të rëndësishëm të plotësimit të dokumentacionit në bazë të legjislacionit të ri, duke kontribuar procesin e aprovimit të Planit Urban të Bashkisë Korce dhe në fillimin e fazës fillestare të implementimit.

Përbërja e Ekipit të Konsulencës për VSM

- Dr. Thanos Pagonis, Urbanist, Zëvendës Drejtues i Ekipit të Projektit MAT, Ekspert për rregulloret dhe Legjislacionin e Planifikimit Urban
- MSC Emil Xhuvani, Biolog, Ekspert Mjedisi i Licencuar
- Dr. Halit Kamberi, Inxhinier Hidro, Ekspert Infrastruktore
- MSC Ereda Xhumari, Inxhiniere Mjedisi
- MA Mirlinda Rusi Ekonomiste, Ekspert i Zhvillimeve Socio-ekonomike
- Elmira Kapo, Arkitekte

1.4 Një përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së Planit

Qëllimi kryesor i Projektit LAMP, në bazë të Termave të Referencës (ToR), ishte "rritja e kapaciteteve të menaxhimit të tokës në Bashki, përmes: (i) përgatitjes së planeve rregulluese, dhe (ii) përgatitjes së manualëve të planifikimit urban dhe trajnimeve, udhëzuesve të planifikimit për të mundësuar përditësimin e rregullt dhe përsosjen e planit me stafin e Bashkisë.

Në bazë të ToR, Projekti synonte arritjen e rezultateve të mëposhtme: *Përgatitjen e planeve strategjike të fizibilitetit, planeve rregullatore dhe të investimeve kapitale në përputhje me ligjet e reja dhe standardet kombëtare, duke u mbështetur nga qeverisja vendore. Implementimin e konsultimeve publike në vazhdim për të informuar dhe mësuar palët e interesuara mbi rëndësinë e planifikimit, të pronësisë dhe menaxhimit të tokës urbane mbi bazë-tregu, e strategjive të propozuara, planeve, rregulloreve dhe programeve kapitale të investimit.*

Gjatë procesit të planifikimit, Konsulenti bazuar në çështjet kyçe, bashkëpunoi me Bashkinë për vlerësimin saktësisht të situatës lidhur me aspektet mjedisore, infrastrukturën, shërbimet, demografinë, bazën ekonomike dhe financiare si dhe profilin kulturor. Realizimi i projeksioneve demografike dhe skenarët real demografik për zonat e qytetit u realizua përmes:

- Sigurimit të një vizioni të saktë për qytetin.
- Objektivave të qarta strategjike për qytetin.

- Formulimit të një strategjie të shpejtë urbanizimi, duke marrë në konsideratë edhe zhvillimet informale.
- Harmonizimit të Planit lokal të zhvillimit me strategjitë rajonale dhe ato kombëtare.
- Koordinimit të zhvillimeve lokale me ato të një territori me *nivel* më të gjerë.
- Diskutimit dhe dakortësisë me palët e interesuara për strategjinë e zhvillimit urban.
- Përpunimit të një plani rregullues të thjeshtë dhe real.
- Identifikimit të të metave në strukturë dhe shërbime dhe formulimit të planeve strategjike financiare për qytetin si dhe implementimit të planit të veprimit.
- Bashkëpunimit me kapacitetet lokale në përgatitjen e planeve rregullatore dhe në menaxhimin e tyre.
- Vendosjes së standardeve për hartën e zonimit(për tu përcaktuar tek rregulloret).

Tre janë temat kryesore, që ka veçuar Konsulenti, lidhur me Korcen ku qyteti mund të luajë një rol qendror në zhvillimin rajonal: (1) Korça si një **qendër kryesore ekonomike, administrative dhe arsimore** për Shqipërinë jugore (2) Korça **pjesë e rrjetit të përbashkët ndërrajonal të turizmit** ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë (3) Korça si një **qytet kompakt i larmisë humane dhe kohezionit social**.

Korça mund të zhvillohej në një qendër të fortë rajonale në jug të Shqipërisë duke forcuar rolin e saj si një qendër administrative dhe arsimore / universitare, si një qytet me një identitet të veçantë, që rrjedh nga historia e saj urbane, traditës qytetare, niveli human dhe i kulturës dhe i rrethuar nga një vendosje e bukur e natyrshme, në rrëzë të malit të Moravës mbi një pllajë pjellore bujqësore. Për më tepër, qyteti është perceptuar si një shtyllë dinamike e zhvillimit rajonal dhe pjesa tjetër në aktivitetet plotësuese ekonomike dhe plotësisht të shfrytëzuara në aftësitë lokale, pasuritë dhe potencialet. Pozita gjeografike strategjike e qytetit, si fqinje me Greqinë dhe Maqedoninë gjithashtu mund të promovojë rolin e qytetit si qendër ndërrajonale për zonën më të gjerë, përmes bashkëpunimit ndërkufitar dhe veprimet e përbashkëta. Korça mund të jetë një mundësi që ofron qyteti për sukses dhe prosperitet, duke siguruar qasje të barabartë në zhvillimin e të ardhurave, punësimit, tregjet, strehimi dhe shërbimet.

Korça do të mbetet në mënyrë ideale një qytet kompakt, me një strukturë të përcaktuar mirë urbane dhe funksionale. Qyteti do të duhet të integrojë të gjitha zonat informale dhe do të sigurojë që zhvillimi urban të ardhmen do të ndjekë proceset e planifikimit formal, duke u bazuar në parimet e qëndrueshme të standardeve moderne evropiane. Për më tepër, qyteti do të sigurojë të lehtë, akseset të sigurt dhe të këndshëm në të gjithë indet urbane, gjithashtu promovimin, jo-motorizuarat format e transportit, të tilla si bicycling dhe këmbë. Qyteti do të arrijnë të ofrojë shërbime me cilësi të lartë urbane dhe shërbimet publike dhe do të ofrojë qasje të barabartë në kanalizime, transporti përbalueshme dhe një mjedis të sigurt.

Ndarja e zonave të reja industriale dhe rigjenerimin e atyre ekzistuese, së bashku me zhvillimin modern urban, bazuar mbi një të shëndetshme sektorin e ndërtimit do të

vendosë për terren Korçës që të bëhet një vend atraktiv për banorët dhe bizneset e mundshme. Aktivitetet rrezikshme do të minimizohen dhe të vendosura në distanca të sigurta nga zonat e banuara dhe përdorime të tjera të papajtueshme tokës, ndërsa aktivitetet e reja ekonomike dhe industriale do të jetë e vendosur në zona të caktuara në mënyrë të qartë industriale.

Zonimi i përdorimit të tokës përcakton kushtet për ndalimin ose përdorimin e tokës (rregullore për mospërputhjen e përdorimit), ne raste te vecanta siguron një largim gradual (me afate kohore te percaktuara VSM) të aktiviteteve që nuk përputhen ne strategjine afatmesme dhe afatgjate te qytetit, duke përfshirë këtu edhe zonat ekonomike operative.

Rregulloret janë hartuar për të qenë një Plan i mjaftueshëm, i integruar, i plotë dhe fleksibël, që përmban zonimin, kontrollin mbi densitetin dhe rregulloret e nënndarjeve së bashku me specifikimet e mëtejshme ne Rregulloret Vendore te Planifikimit duke iu referuar proceseve të kontrollit të zhvillimit, mekanizmave dhe instrumenteve për një planifikim dhe menaxhim të tokës të detajuar¹.

Rregulloret i klasifikojnë aktivitetet industriale dhe ekonomike në tre kategori në lidhje më mjedisin, me impakt të ulët, të mesëm dhe të lartë, dhe sigurojnë rekomandime për studimin e VSM në procesin e kontrollit të zhvillimit; legjislacioni kombëtar do të përcaktojë cilat nga aktivitetet i përkasin kategorive respektive si pjesë e një procesi të përditësuar për të rregulluar kornizën ligjore të aktiviteteve industriale.

Rregullorja e Planifikimit Urban trupëzon udhëzimet mjedisore, për ta drejtuar planifikim drejt një planifikimi urban të qëndrueshëm(raporti i hapësirës publike me atë private), udhëheqje në krijimin e hapësirave dhe korridoreve të gjelbër, në klasifikimi e sipërfaqeve të gjelbër, etj.

1.5 Metodologjia dhe përmbajtja e raportit mjedisor të VSM

VSM është një metodë sistematike për marrjen në konsideratë të efekteve të planeve dhe programeve strategjike si dhe për reduktimin e disa presioneve ekzistuese mbi mjedisin në zonën ku ato do të zbatohet.

VSM mund të konsiderohet si mjeti i përshtatshëm për të arritur në vendimet e drejta mbi planifikimin për çështjet si:

- Integrimi e konsideratave mjedisore në planet strategjike/planifikimin urban si dhe në procesin e vendimmarrjes për investimet në zonën në studim.
- Vlerësimin e alternativave të planeve të zhvillimit dhe në kontributin për orientimin e rritjes, përdorimit të tokës dhe zgjedhjeve për investimet e infrastrukturës.

¹ Në këtë kuptim, Plani Rregullator për projektet e qyteteve mbulon aspekte të niveleve të larta(kombëtare) dhe të ulëta(të detajuara) të Sistemit Rregullator të Planifikimi Territorit.

- Përmirësimi i komponentëve mbrojtës të Planit ndaj mjedisit.
- Ndikimet sasiore dhe cilësore mbi burimet natyrore dhe kapacitetet mbajtëse të këtyre burimeve me qëllim pranueshmërinë e implementimit të qëndrueshëm të planit.

Metodologjia për përgatitjen e Raporti Mjedisor u zhvillua pas një studimi të plotë duke pasur si udhërrëfyes ligjin 91/2013, ligjin 10440/2011 si dhe dokumentet në nivel BE ²; por edhe qasje të tjera të suksesshme që janë përdorur sot në vlerësime Planesh të ngjashme në Evropë, duke pasur si qëllim një kornizë të kuptueshme vlerësimi që identifikon pikat kritike dhe thelbësore që duhen drejtuar në vlerësimin e impakteve të mundshme mbi shëndetin publik dhe mjedisin tek Plani Lokal i Korces. Si përfundim, mund të themi se qëllimi kryesor i Raportit Mjedisor ka qenë:

- Të përcaktojë drejt përmbajtjen dhe qëllimin e veçantë të Planit Lokal të Korces;
- Të sigurojë një vlerësimin në disa nivele të Planit Lokal në kuptimin e:
 - Qëllimeve dhe objektivave;
 - Politikave në përgjithësi;
 - Propozimeve të veçanta për zhvillim;
- Shmangien e paraqitjes së një informacioni të tepërt që nuk është pjesë e këtij raporti;
- Sigurimin e një paraqitjeje ballë për ballë me partnerët më të rëndësishëm të Planit Lokal;

Së fundmi, ka për qëllim sigurimin e një mjeti të nevojshëm që mund të kuptohet nga të gjithë si nga publiku ashtu edhe nga autoritetet kompetente, në përputhje me **parimet e transparencës dhe konsultimeve efektive me publikun në procesin e vendimmarrjes**, që nënvizohet edhe në ligjin 91/2013 dhe në direktivën e BE 2001/42/EC.

Për këtë qëllim VSM konsiston në gjetjet në faza të ndryshme të rrezikut mjedisor si pasojë e planifikimit urban që propozohet sikurse edhe në masat që duhet të ndërmerren për reduktimin e këtyre rreziqeve si dhe të presioneve të zhvillimit mbi mjedisin dhe shëndeti publik.

Ky studim VSM është kryer në lidhje të ngushtë me Planin e Zhvillimit Urban të qytetit të Korces, i cili përmban tre komponentë kryesore:

1. Një strategji zhvillimi, e quajtur “Strategjia dhe Vizioni i zhvillimit të qytetit”, që është i ndërtuar në formën e qëllimeve dhe objektivave të cilat zërthehen në programe

² Kryesisht punimet janë:

- *Handbook on SEA for Cohesion Policy 2007-2013*, Greening Regional Development Programmes Netëork, 2006.
- *Implementation of Directive 2001/42 on the Assessment of the Effects of Certain Plans and Programmes on the Environment*, European Commission, DG Environment.
- *The Relationship between the EIA and SEA Directives*, Imperial College of London, Final Report to the European Commission, 2005.
- *Methods of Environmental Impact Assessment*, Edited by Peter Morris and Riki Therivel, 3rd Edition, 2009.

2. Një plan Urban–Hapësinor, i quajtur “Plani strukturor i Bashkisë” i cili përmban përdorimin e tokës rregulloret e kontrollit të zhvillimit
3. Një plan investime për infrastrukturën, i quajtur “Plani i Strategjik i Investimeve në Infrastrukturë” i cili përfshin kornizat e prioritare të planeve strategjike në formën e shënimeve.


Kështu, metodologjia e VSM e zhvilluar për këtë plan të veçantë të Korces duhet të përfshijë këto tre struktura të planit dhe të trajtojë kompleksitetin e rregullimit të planifikimit të zhvillimit lokal paralelisht me Planifikimin urban-hapësinor si dhe me planifikimin e infrastrukturës, i cili nga ana e tij rregullon të dy zhvillimet e planifikimit urban dhe qëllimet e tyre si dhe lehtëson presionet kryesore mbi mjedisin në zonë.

Drafti i Metodologjisë së Raportit të VSM për Korcen është i bazuar në skemën e mëposhtme (1.5).

QASJA METODOTOLOGJIKE E VSM NË LIDHJE ME VECORITË E PLANIT TË KORCES DHE NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN KOMBËTAR

VERIFIKIMI I SITUATËS AKTUALE DHE I KUSHTEVE MJEDISORETË ZONËS NË STUDIM

Mjedisi natyror dhe shëndeti publik	Struktura hapësinore	Profili social-ekonomik	Presionet kyçe mbi mjedisin
<p><u>Biodiversiteti, Fauna & Flora, Pyjet dhe Natyra</u> a. Biodiversitet, Fauna & Flora b. Zonat e mbrojtura dhe ato natyrore</p> <p><u>Trupat ujore</u> a. Burimet ujore dhe ujërat nëntokësore</p> <p><u>Toka</u> a. Gjendja e tokës b. Sizmiciteti</p> <p><u>Klima dhe cilësia e Ajrit</u> a. Kushtet klimaterike b. Ndotja dhe cilësia e ajrit</p> <p><u>menaxhimi i mbetjeve dhe infrastruktura mjedisore</u> a. Menaxhimi mbetjeve të ngurta b. Ujërat e zeza /ujërat urbane</p> <p><u>Ndotja akustike</u></p>	<p><u>Përdorimi i tokës dhe modelet e zhvillimit</u> a. Ndarja e përgjithshme e përdorimit të tokës b. Struktura e vendbanimeve dhe modelet</p> <p><u>Aksesi dhe rrjeti i transportit</u></p> <p><u>Energjia dhe Telekomunikacioni</u> a. Energjia dhe Elektriciteti b. Rrjeti i Telekomunikacionit</p> <p><u>Peizazhi dhe trashëgimia kulturore</u> Struktura e peizazhit Trashëgimia kulturore</p>	<p><u>Demografia dhe shpërndarja hapësinore e popullsisë</u></p> <p><u>Ekonomia dhe Punësimi</u> a. Bujqësia b. Industria dhe shërbimet e biznesit c. Shërbimet për turizmin d. Sektori publik</p> <p>Perspektiva kryesore e biznesit dhe infrastruktura e investimeve</p>	<p>Rritja urbane/mjedisi, zonat e gjelbra</p> <p>Kufizimet e furnizimit me ujë</p> <p>Grumbullimi i mbetjeve të ngurta dhe i ujërave të ndotura</p> <p>Ndotja sipërfaqësore dhe nëntokësore</p> <p>Mbetjet e rrezikshme</p> <p>Impakti i zhvillimit të biznesit dhe industrial</p> <p>Presionet mbi tokën e mbrojtur, monumentet e kulturës, llojet.</p>



<u>Mjetet</u> - vjetari statistikor kombëtar - të dhënat e mbledhura - Hartat AutoCad - të dhënat e klimës/mjedisit - Rregulloret ligjore Konsultime Sondazhet	Përzgjedhja e Mjeteve dhe e Metodave për monitorimin e shtrirjes së Planit dhe të Aplikimit të propozimeve të lidhur më të	<u>Mjetet e VSM</u> - Metodat e korelimit - Analiza statistikore - Analizave e Regresionit - Analiza e kosto/përfitimit
Integrimi – Konsolidimi i mjeteve të Monitorimit dhe indekset		

Skeleti i qasjes metodologjike janë objektivat e VSM, të cilat rrjedhin nga konsideratat mjedisore dhe janë përdorur për të:

- vlerësuar impaktet e pritshme mbi mjedisin dhe shëndeti publik të skenarëve alternativë (kapitulli 4);
- vlerësuar me hollësi impaktet mbi mjedisin dhe shëndetin publik të politikave dhe projekteve të Planit Lokal (Kapitulli 5).
- krijuar bazat për ngritjen e listës së indikatorëve për sistemin e propozuar të monitorimit të Planit Lokal (Kapitulli 6).

Procesi i VSM përfshin si të dhënat bazë të kërkimit ashtu edhe ato të korrigjuara të Planit Urban. Procesi karakterizohet nga ndërveprim midis ekipit të konsulentëve, personave të interesuar si dhe me zhvillimin e planit urban dhe presupozon vlerësimin e alternativave për opsionet për zhvillimin e planit urbanistik (në seksionin e skenarëve).

Testimi i objektivave të planifikimit në nivel trelateral me objektivat e VSM përbën konceptin kryesor të procesit dhe është shumë e rëndësishme të thuhet që të tre komponentët e planit do të testohen në kapitullin për vlerësimin përkundrejt objektivave të VSM në tre tabelat me komente që nënvizojnë çështjet, të cilat kërkojnë një vlerësimin të mëtejshëm dhe një adresim i tyre në seksionin e aplikueshmërisë.

Raporti Mjedisor është i ndërtuar në dhjetë kapituj. Struktura e përzgjedhur u zgjodh e tillë për të siguruar një kohezion të brendshëm të Raportit, në mënyrë të tillë që të gjithë konkluzionet e secilit kapitull t'i paraprijnë konceptit të kapitullit që pason. Më tej, paraqitja e brendshme e secilit kapitull ndjek çështjet e paraqitura më sipër, duke siguruar një strukturë tërësore edhe më të kuptueshme të Raportit.

2

Analiza e situatës së sotme të kushteve mjedisore të zonës në studim

2.1. Shëndeti i popullatës dhe mjedisi natyror

2.1.1 Biodiversiteti, Fauna dhe Flora, Pyjet dhe Zonat Natyrore

a) Biodiversiteti, Fauna dhe Flora.

Flora

Bimësia e pyjeve të rajonit shtrihet në tre zona fitoklimatike, zona e dushkajave, zona e ahut dhe zona e kullotave alpine.

a) *Zona e dushkajave* njihet lloje të shumtë drurësh pyjore si dushqet (shpardh, bungë, qarr, bungëbutë), blinjtë (bliri flete-vogël, blir gjethegjere, bliri i argjendtë), panjat (panja e malit, panja fleterap, panja gjethengushtë, krekëza), plepat, shelgjet, mëlleza, vidhet, etj.

b) *Zona e ahut* njihet gjithashtu lloje të shumta drunore pyjore si ahu, bredhi, pisha e zeze, hartina, vodhezat, ajdësi, bredhi (*Abies borisi Regis*) dhe tisi (*Taxus bacata*)

c) *Zona e kullotave alpine* njihet një shumëllojshmëri barërash rreth 130 të tilla kanë. Në secilën zonë ka gjithashtu kategori të tjera bimore si shkurret e shumta, kërpudhat, mikroflora, etj.

Fauna

Fauna në rajonin e Korçës është e larmishme. Rajoni i Korçës përmban një shumëllojshmëri faune. bazuar në klasifikimin nga pikëpamja e sistematikës në këtë rajon hasen në përgjithësi llojet e mëposhtme :

- Vertebrorë si : Amfibët gjenden rreth 12 lloje; Reptilët tokësore gjenden rreth 23 lloje nga të cilët 2 me status lloj i rrezikuar globalisht;

- Invertebrore: Gjenden rreth 25 lloje nga të cilët 6 me status lloj i rrezikuar globalisht.
- Insekte 24 lloje nga të cilët 6 me status lloj i rrezikuar globalisht. Mes tyre ka lloje me rendesi te vecante.
- Gjitarë mishngrënës, dallohen lloje si ariu i murmë, ujku, cakalli, macja e egër dhe baldosa;
- Gjitarë të vegjël janë evidentuar 23 lloje;
- Lakuriqe nate janë evidentuar 20 lloje;
- Gjarpri i vogël i ujit dhe hardhuca e barit janë dy lloje reptilësh të kërcënuar;

Dhe së fundi *Avifauna* përfaqësohet nga 177 lloje shpendësh nga të cilët 3 prej tyre janë me status të rrezikuar globalisht.

a) Hapësirat e Lira dhe të Gjelbërta dhe Zonat e Mbrojtura

Fakti që një pjesë e faunës dhe e florës së Korçës janë të kërcënuara si dhe që mesatarja për banor për sipërfaqe të gjelbër është rreth 3m² bën të mendosh se presionet mbi natyrën dhe sidomos mbi pyjet dhe hapësirat e gjelbërta janë të mëdha dhe se kanë çuar në dëmtime serioze të habitateve të këtyre llojeve. Për këtë arsye në qytetin e Korçës kërkesa për shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe ruajtjen e sipërfaqeve ekzistuese është një domosdoshmëri që lidhet jo vetëm me dëmtimin e larmisë së botës shtazore dhe bimore por drejtpërdrejt edhe me shëndetin e popullatës. Realizimi nga ana e Bashkisë gjatë viteve të fundit i disa projekteve rehabilitimi në kuadrin e projektit “Rigjenerimi i Hapësirave të Gjelbërta” kanë dhënë kontributin e tyre në këtë drejtim. Sot në Korçë ekziston një mori hapësirash të lira me përmasa të ndryshme dhe e përdorur për qëllime të ndryshme: Më specifikisht ato janë: **Rrugët dhe sheshet** dhe **bulevardi** në Korçë të cilat karakterizohen nga një bimësi e lartë e pemëve të reja dhe të rritura. Të kombinuara me trotualet e gjera, disa prej tyre mund të karakterizohen si “akse këmbësore të gjelbërta”. Gjithashtu një kontribut më rritjen e sipërfaqes së gjelbër janë edhe **parqet e lagjeve dhe “kopshtet xhepa”** janë hapësira të gjelbërta të madhësisë së vogël dhe mesatare me distanca të afërta me zonat e banimit. Një hapësirë për tu zhvillim është **Parku Shetro**, i lokalizuar në zonën ku rridhte në të kaluarën lumi i qytetit, në perëndim të Birra Korça. Veç kësaj kërkohet nga PPV të kryhet punë për rehabilitimin e hapësirave të lira në hapësirat e degraduara ndërmjet blloqeve kolektive të banimit, në lagjet jugore të qytetit. **Parqet e bashkisë** janë një tjetër mundësi që rrit sipërfaqen e gjelbër për banorë në qytet. Ato gjenden në pjesën periferike më veriore urbane të qytetit dhe ofrojnë një shumëllojshmëri aktivitetesh për banorët e zonës. Këtu mund të përmendim **parkun ‘Rinia’** që është dhe parku urban më i madh i qytetit, i përdorur gjerësisht nga banorët për shëtitje dhe argëtim. Parku është i vendosur pranë hyrjes veriore të qytetit dhe ndodhet pranë Universitetit Fan S. Noli dhe Kompleksit Sportiv Skënderbeu. PPV parashikon edhe një zhvillim për një **kompleks modern sportiv** në hapësirat e lira përreth Kompleksit Sportiv Skënderbeu. Kjo hapësirë duhet të ruhet dhe të mbillet me pemë të larta për të siguruar një sipërfaqe hijeje sa më të madhe në ato hapësira ku nuk do ketë terrene sportive.



Figura 1: Akset këmbësore të gjelbërta në qytetin e Korçës




Figura 2: Zona e Parkut të ardhshëm Shetro



Figura 3: Hapësira të lira në banesat socialiste



Figura 4: Zonat kryesore të rekreacionit dhe sportive të qytetit të Korçës

b) Zonat e rëndësishme natyrore dhe ato të mbrojtura

Një ndër zonat më të rëndësishme për Bashkinë e Korcës janë edhe **Kodrat e Moravës**. Kodrat, shkëmbinjtë dhe vendet e pjerrëta të Moravës janë mushkëria e qytetit si dhe ndikojnë shumë në peizazhin e tij. Kjo pjesë e bashkisë në të kaluarën ka qenë publike dhe e pyllëzuar. Shpyllëzimi dhe procesi i kthimit të pronave mbas vitit 1990 që ju riktheu ish-pronarëve një pjesë të kodrave, pavarësisht që solli një rivendosje të drejtësisë e dëmtoi zonën në fjalë. Gjithashtu përdorimi i drurit si burim për ngrohje nga ana e banorëve e cenoi edhe më tej këtë hapësirë të gjelbër. Plani Rregullues i vitit 1994 ndaloi çdo aktivitet ndërtues, pavarësisht nga kërkesat për ndërtime e pronarëve të ndryshëm.

Ky pyll në të kaluarën shërbente për banorët e Korçës për një mori aktivitete të orientuara nga natyra dhe argëtimet si dhe shërbente si vendstrehimi i mjaft llojeve që sot janë të kërcënuara. Habitata të tëra janë dëmtuar apo copëtuar në këto kodra në vitet pas 1990 si pasojë e ndërhyrjeve brutale nga ana e njeiut. Sidoqoftë kjo zonë mbetet dhe shërben për banorët e qytetit të Korcës për të kryer aktivitete sportive, vrapime apo shëtitje. Kjo zonë e qytetit duhet të mbrohet me ligj si dhe të marrë një kategori mbrojtjeje të **një peizazhi të menaxhuar** duke mundësuar kështu një rrugë të ndërmjetme midis kërkesës së pronarëve dhe nevojave dhe domosdoshmërisë së ruajtjes së kësaj zone për të mirën e qytetit dhe qytetarëve.



Figura 5: Kodrat e Moravës: Situata aktuale

Një zonë tjetër e rëndësishme për shëndetin e popullatës të bashkisë Korçë është zona përreth puseve në zonën e Turanit dhe Porodinës. Kjo zonë aktualisht nuk gëzon ndonjë status të veçantë prandaj me kërkesën e UKKO por bazuar edhe në rregulloret për ruajtjen dhe mbrojtjen e zonave ujëmbajtëse, bashkia duhet të gjejë rrugët ligjore për ta shpallur si zonë e mbrojtur, ku të aplikoheshin katër shkallë zonash në varësi nga distanca nga pusët. Specialistët rekomandojnë ndarjen e kësaj zone si mëposhtë:

- I. Zona e në një distance përreth pusit 20x20m ku nuk duhet të hyjë njeri përveç personave të autorizuar.

- II. Zona mbrojtëse 1 e cila do të përfshinte zonën ujëmbajtëse në një zonë me një distancë rrethuese rreth 200m. Brenda kësaj zone mund të lejohen aktivitete bujqësore organike por jo ato industriale apo bujqësore që përdorin pesticide apo plehra kimike.
- III. Zona e mbrojtur 2, e cila rrethon zonën ujëmbajtëse në një distancë prej 1500m nga lart dhe 500m poshtë për arsye të thjeshtë që nga lart kullimi i elementëve të ndryshëm është më i mundshëm. Në këtë zonë nuk duhet të lejohen vend-depozitime mbetjesh si dhe ndërtime shtëpish.
- IV. Zona e tretë e mbrojtjes përbën një mbrojtje kundrejt burimeve të mundshme të ndotjes e cila duhet të shtrihet nga 2.5 to 7.2 km në drejtim të Korces dhe ku përsëeri nuk duhet të lejohen vend-depozitime mbetjesh dhe ndërtime shtëpish.
- V. Së fundmi, zona e katërt e mbrojtur që lidhet me zonën ku shkarkohen ujërat në jug të qytetit. Përreth kësaj zone ka mjaft aluvione të depozituara nga aktiviteti i lumenjve dhe i përrenjve, dhe çdo aktivitet i rrezikshëm duhet të ndalohej si p.sh industri kimike apo të lidhura me të, depozita karburantesh etj.

Gjithashtu për të patur një informacion të vazhdueshëm dhe të saktë për gjendjen e ujit nëntokësor në këto puse duhen të monitorohen dhe të kryhen në mënyrë periodike analizat e ujit ku të regjistrohen vlerat për temperaturën, pH, konduktivitetin, përqindjen e oksigjenit të tretur, kloruret, hidrokarburet, metalet (Cu, Cd, Cr total, Fe, Ni, Pb, Mg, Zn) dhe hidrogjenin amoniakal. Këto vlera duhen të krahasohen me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.1.2 Trupat ujore

a) Uji i pijshëm

Qyteti i Korçës ka një furnizim me ujë të pijshëm nga më të mirët në Shqipëri si përse i përket burimeve, kohëzgjatjes (24 orë) ashtu edhe për rrjetin e shpërndarjes dhe sasisë për banorë(direktiva 11 evropiane për ujin është 200l/d/b). Gjatësia e këtij rrjeti arrin në rreth 120km ka mundësuar uljen e humbjeve në rrjet, përmirësimin e stacionit të pompave si dhe sasinë e depozitimit. Ky furnizim me ujë i qytetit të Korçës realizohet nga ujësjellësi qytetit i ndodhur në fshatin Turan ku është ngritur dhe stacioni i pompave. Në tërësi janë 4 puse arteziane të cilët janë rreth 150 m të thellë, nga të cilët një ndodhet në fshatin Turan, ndërsa tre të tjerët poshtë fshatit Porodinë. Puset janë të rrethuar dhe hermetikë. Nga këta puse për arsye shfrytëzimi sa më racional, dy janë në shfrytëzim ndërsa dy të tjerët janë lënë rezervë. Në puset e qytetit merren mostra 2-3 herë në vit direkt në pus. Uji kalon nga këto puse nga stacioni i pompave të Turanit ku bëhet dhe klorinimi i ujit. Që atje me pompa ngjitet në depot e ujit në kodrat e qytetit dhe me anë të rrjetit, i cili është brenda çdo parametri, hermetik me tubacione që janë shtrirë në të gjithë qytetin e Korçës nga ku shpërndahet uji.

Tubacionet janë të reja bashkëkohore dhe përveç qytetit të Korçës kanë shtrirje dhe në 2 fshatrat përreth si Turani dhe Cifligu të cilët furnizohen nga rrjeti i qytetit të Korçës.

Ujësajllësi monitorohet çdo dite nga ana e drejtorisë duke marrë mostra uji në 16 pika, nga të cilat 15 pika janë fikse dhe 1 pikë është e lëvizshme sipas problemeve që paraqesin qytetaret. Ky monitorim bëhet paradite dhe pasdite. Përqindja e klorit del në të gjithë qytetin njësoj pas analizave të përditshme në laboratorin tonë. Në Direktivën Evropiane për Ujin e Pijshëm thuhet që duhen monitoruar përditë dhe në mënyrë të rregullt rreth 48 parametra kimik dhe mikrobiologjik, ndërkohë që aktualisht këtu bëhet një kontroll periodik për një numër më të vogël elementësh.

Përveç ujësajllësit, qyteti i Korçës ka edhe 11 çezma me vetërrjedhje, nga të cilat një pjesë janë me një origjinë qindra vjeçare. Edhe atyre ju bëhet analiza çdo tre muaj.

Emrat e tyre janë:

1. Shetro
2. Cezma e amzes
3. Ish fabrika e çorapeve
4. Ish-fabrika e miellit
5. Papallambro
6. Radamec
7. Lulishtja Shën Mëria
8. Partizani
9. Rr. Pano
10. Xhamballo
11. Rr. Niko Kovaci
12. Rr. Petraq Shamo

Tabela e ujit të pijshëm – Qyteti i Korçës		
Parametri	Vlerat aktuale (mg/l)	Norma kombëtare (mg/l)
pH	7,9	6,5-8,5
Cl i mbetur	0,1-0,3	>1 mg/l
NH ₄ ⁺	0	Maks 0,05
NO ₂ ⁻	0	>50
NO ₃ ⁻²	1,4	>5
CO ₂ ⁻²	12,2	>500
HCO ₃ ⁻²	267,3	>500
O ₃	1,7	
Fortësia gjermane	13,8°	>20°

Po ashtu nga monitorimi dhe analizat, uji i Korçës rezulton pa ndotje bakteriologjike.

Pavarësisht që momentalisht situata hidrike dhe pastërtia e ujit të kësaj zonë është e brenda standardeve, sipas UKKO zona ujëmbajtëse kërcënohet nga ndërtimet dhe nga aktivitetet e pakontrolluara në zonë. Kjo ndodh pasi në këto zona të mbrojtura nuk ka masa efektive lidhur me kanalizimet e ujërave, llojin e ndërtimeve dhe destinacionin e tyre dhe për pasojë janë shtuar mbetjet industriale dhe ato urbane duke e kërcënuar pastërtinë e kësaj zone. PPV i qytetit të Korçës duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kriterëve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare duke kërkuar zbatimin e kriterëve shumë të forta lidhur me llojin e aktivitetëve (depo karburantesh, industri kimike, blegtori, magazina si dhe për shërbime të tjera), lejet e ndërtimit etj. Është e domosdoshme, në bazë edhe të ligjit, që të gjitha këto aktivitete përpara se të marrin lejet dhe të lidhen me rrjetin e ujërave të zeza duhet të paraqesin një projekt lidhur me

trajtimin paraprak të mbetjeve dhe të ujërave. Zbatimi i propozuar për zonat e mbrojtura do të ishte një zgjidhje përfundimtare për këtë çështje.

b) Lumenjtë

Lumenjtë në qytetin e Korçës janë ai i Drenicës dhe i Dunavecit. Lumi Drenicë, i cili vite më parë kalonte në qytetin e Korçës tani shtrati i tij është devijuar dhe lumi rrjedh në unazën e qytetit. Lumi Dunavec kalon në fund të qytetit të Korçës në pjesën Jug

Perëndimore të qytetit dhe aty ai bashkohet me lumin e Drenicës. Përpara shumë vitesh këta lumenj kanë qenë problematik pasi gjatë vërshimit përmbynin zonat përreth, ndërsa në kohën e sotme niveli i ujërave të tyre ka rënë dhe nuk paraqesin asnjë problem në këtë drejtim për qytetin e Korçës

Gjendja aktuale e këtyre lumenjve paraqitet e kërcënuar nga zhvillimi i aktiviteteve industriale dhe nga hedhja e mbetjeve të ndryshme. Mjaft banorë janë ankuar pasi kanalet ujtitëse, që ushqehen me ujë nga këta lumenj janë ndotur dhe për pasojë edhe tokat e tyre, se bagëtia u ka ngordhur si dhe një aromë e keqe pushton zonën në orët e natës. Kjo është më e dukshme sidomos në lagjet 15, 16 dhe 17 të Korçës. Aktivitetet industriale derdhin mbetjet dhe ujërat e tyre të patrajtuara në ujërat e lumit të Drenicës si dhe në një kanal tjetër që shkon drejt fshatit Turan. Edhe banorë të Turanit ankohen



Figura 6. Tokë e zonës industriale për rehabilitim

se përveç erës së keqe, u janë ndotur rrugët dhe tokat dhe për më keq, u kanë ngordhur bagëtia. Në fushën e Turanit ndodhet dhe pellgu ujëmbajtës i ujësjellësit të qytetit të Korçës, ku janë shpuar katër puse që furnizojnë me ujë të pijshëm këtë qytet. Ekspertë të shoqërisë së Ujësjellës-Kanalizimeve Korçë (UKO) shprehin dyshimin se

nga infiltrimi i mbetjeve toksike mund të ndotet edhe pellgu ujëmbajtës. Një vit më parë organet e pushtetit vendor dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit kanë pezulluar veprimtaritë industriale në këtë zonë por pezullimi ka qenë i përkohshëm. Gjithashtu një Plan Veprimi për menaxhimin e këtyre lumenjve duhet të merret në konsideratë nga bashkia.

2.1.3 Toka

a) Kushtet e Tokës, përdorimi i pesticideve, sizmiciteti

bashkia e Korcës ka një sipërfaqe të konsiderueshme toke. Karakteristikë themelore e tokës në rajon është përbërja e saj kryesisht (75%) nga toka kodrinore dhe malore si dhe për nga pikëpamja mekanike ajo ndahet në përqindje të ndryshme në: toka argjilore, argjilore e rëndë : subargjilore të mesme, subargjilore te lehta dhe toka subranore.

Emri	Sipërf. totale (ha)	Sipërf. e kultiv (ha)	Sipërf. pyjore (ha)	Kullota(ha)	Të tjera (ha)				
Rrethi	366,024	86,108	24%	132,075	36%	53,732	14%	94,109	26%
Korça	172,478	44,207	26%	54,900	32%	23,604	13%	49,767	29%

Në rajon dallon fusha e madhe e Korcës, e cila gjendet rreth 850 m mbi nivelin e detit. Kjo fushë formon sipërfaqen e dytë bujqësore më të madhe në Shqipëri, pjesa më e madhe e së cilës është pjesë e sipërfaqes kënetore e bonifikuar pas luftës së dytë botërore në periudhën e komunizmit dhe nga kjo fushë një pjesë nuk përdoret për bujqësi për shkak të mungesës së investimeve dhe emigracionit.

Sipërfaqe e konsiderueshme pyjore, që ndodhet rreth qytetit të Korçës, është dëmtuar dhe ka sjellë degradimin e saj gjatë viteve të fundit, kjo për shkak të prerjeve të pemëve për qëllime ngrohje nga kompani private dhe individ të palicencuar të cilët nuk e kanë bërë dhe nuk e bëjnë zëvendësimin me fidanë të rinj pyjor. Shembulli më tipik negativ janë dëmtimet e shkaktuara në malin e Moravës, gjatë viteve '90.

Toka bujqësore kërcënohet nga presioni i ndërtimeve informale si dhe nga ato formale duke e zvogëluar sipërfaqen e saj. Gjithashtu kjo tokë duke mos u kultivuar për një periudhë relativisht të gjatë është varfëruar. Nevoja për rehabilitimi të tokës bujqësore është prioritare dhe duhet të shoqërohet me masa teknike të njohura.

Hartimi i një Plani Veprimi për mbrojtjen e tokës nga erozioni është i nevojshëm për të parandaluar dhe rehabilituar terreni i dëmtuar. Ky plan veprimi është i domosdoshëm për të zvogëluar këtë fenomen të dëmshëm.

Problematike paraqitet situata e tokës dhe në ish zonat industriale, toka pranë zonës së vend grumbullimit të mbetjeve si dhe ajo pranë kanaleve të hapura të ujërave të patrajtuara. Është e domosdoshme që këto toka t'i nënshtrohen një plani veprimi për rehabilitimin e tyre përpara se ato të marrin një destinacion të ri.

Nga pikëpamja sizmike, sipas Institutit Gjeo-teknik në Korçë situata sizmike ndryshon në varësi të zonës. Sugjerimet e këtij Instituti janë për studime të

hollësishme për çdo projekt që do të zhvillohet sipas PPV por sidoqoftë thekson që çdo projekt kërkon një studim të mirëfilltë gjeologjik përpara se ai të zbatohet siç e kërkon edhe ligji shqiptar. Konsiderata e përgjithshme për PPV lidhur me zonat e ndryshme janë si më poshtë:

Zona më kushte të mira gjeologjike konsiderohet ajo poshtë fshatit Barc dhe Varrezave të qyteti e deri tek Antena. Zona që gjendet mbi varrezat e qytetit deri në afërsi të fshatit Mborje dhe pranë fabrikës së birrës Korça është me kushte më pak të favorshme ndërsa zona që shtrihet na tokat bujqësore, OSSH-së dhe parking Ylli kushtet nuk e favorizojnë ndërtimin.

2.1.4 Klima dhe cilësia e Ajrit

a) Kushtet klimaterike

Qyteti i Korçës gjendet në një lartësi 850m mbi nivelin e detit, shtrihet në pjesën juglindore në Krahinën Malore Qendrore të Shqipërisë dhe bën pjesë në zonën mesdhetare para-malore me një sipërfaqe rreth 300km², e cila ka një klimë të karakterit kontinental që karakterizohet nga një klimë pjesërisht mesdhetare malore dhe pjesërisht kontinentale, me dimër të ftohtë ku temperatura zbret nën 0°C (Janar) dhe verë të nxehtë e të thatë me temperatura që i kalojnë 30°C (Gusht).

Tabela 2- Të dhënat kryesore të klimës në Korçë

Temp. mes vjetore (°C)	Mes e orëve me diell/vit	Reshjet vjetore mes (mm)	Lagështia vjetore mes (%)	Maks. i reshjeve (mm)
10,6	2350	720	68	104,9

Korça shtrihet në një zonë mesatare të ndriçimit nga dielli. Orët me diell mesatarisht në vit janë rreth 2350 orë dhe vlera energjetike e rrezatimit vjetor llogaritet në 1451.60 kWh/m². Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare 0,4°C, ndërsa më i ngrohti është gushti me 20,6°C. Përgjithësisht Korça ka mot të thatë: lagështia relative mesatare vjetore është 68%. Muaji me më shumë reshje është nëntori (rreth 104,9mm) pastaj dhjetori, tetori, janari e shkurti. Vera zakonisht është e thatë, gjatë të cilës bien rreth 14% e reshjeve vjetore. Temperatura mesatare vjetore arrin deri në 10,6°C. Muaji më i lagësht është nëntori me reshje shiu mesatarisht 104 milimetra ndërsa sasia mesatare vjetore e reshjeve arrin në 720 milimetra, gjithashtu edhe reshjet në formën e dëborës bien zakonisht në periudhën Dhjetor-Janar.

Korça karakterizohet nga një ndryshueshmëri me variancë të lartë të erërave si në drejtim dhe në shpejtësi. Megjithatë për sa i përket drejtimit jepen këto të dhëna për shpërndarjen e erërave gjatë stinëve të vitit: 23.6% në dimër, 23.3% në pranverë, 22.2% në verë dhe 19.4% në vjeshtë. Shihet qartë që erërat mbizotëruese janë erërat e veriut dhe ato të verilindjes. Shpejtësia e këtyre erërave luhetet në vlerat që shpesh shkojnë mbi 5m/sek, ku ato me shpejtësi 10 – 11m/sek hasen më shpesh në erërat veriore dhe verilindore. Maksimumi i shpejtësisë në zonë ka arritur deri në shpejtësi

maksimale të erës 40.5 m/sek. Zona karakterizohet nga disa erëra lokale si Voskopojarja, erë jug-perëndimore, Morava, Devollka etj. Era më e fortë dhe më e shpeshtë në rajon konsiderohet era me drejtim verior e quajtur Cangonjarja. Kjo vjen nga gryka e Cangonjit dhe përshkon fushën e Korçës, duke lëvizur paralel me Malin e Thatë. Energjia e kësaj ere mund të jetë potenciali kryesor për prodhimin e energjisë elektrike të pastër prej këtij burimi natyror.

b) Cilësia e ajrit dhe ndotja

Qyteti i Korçës në vitet e fundit Drejtoria Rajonale e Shëndetsisë ka shumë vjet që bën monitorimim e ajrit në qytetin e Korçës. Rezultatet në 5 vitet e fundit jepen në tabelën e mëposhtme. Në dy vitet e fundit 2011 dhe 2012 monitorimit të cilësisë së ajrit i janë shtuar edhe parametra të rinj si tolueni, benzeni etj.

Tabela 3- Cilësia e ajrit ndër vite në qytetin e Korçës									
Viti	LNP ($\mu\text{gr}/\text{m}^3$)	PM ₁₀ ($\mu\text{gr}/\text{m}^3$)	SO ₂ ($\mu\text{gr}/\text{m}^3$)	NO ₂ ($\mu\text{gr}/\text{m}^3$)	Pb ($\mu\text{gr}/\text{m}^3$)	O ₃ ($\mu\text{gr}/\text{m}^3$)	PM _{2,5} ($\mu\text{gr}/\text{m}^3$)	Toluene ppb	Benzen ppb
2008	224	87	5,2	39,2	9,4	41,3	x	x	x
2009	221	93	12	31	0,27	75	x	x	x
2010	183,6	79	16,13	26,84	0,19	76	x	x	x
2011	x	94	15,28	9,19		19,46	79,7	3,34	2,18
2012	x								
Norma AL	140	70	60	50	1	120			
Norma BE	80	50	50	40	0,5	110	25		15

LNP- Lënda e ngurtë pezull; PM₁₀-Pluhuri deri 10 μm ; O₃-Ozoni; SO₂-Anhidriti Sulfuror; NO₂-Dioksidi i azotit; Pb - Plumbi

Problematike për qytetin e Korçës kanë qenë dhe mbeten gazrat që çlirohen nga djegia e druve të zjarrit për ngrohje në sezonin fund vjeshte – pranvere. Të tillë gazra si gazi karbonik, monoksidi i karbonit, gazi metan, etj, do të monitorohen në vazhdim. Po ashtu edhe cilësia e karburanteve dhe e automjeteve ndikon për keq në cilësinë e ajrit në bashki.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet nje monitorim një ditor dhe dallohet se mjaft parametra janë jashtë normave të lejuara

Tabela 4-Disa vlera të gazeve të ndryshëm në Korçë										
Nr	Vendi	PM ₁ $\mu\text{g}/\text{m}^3$	PM _{2,5} $\mu\text{g}/\text{m}^3$	PM ₇ $\mu\text{g}/\text{m}^3$	PM ₁₀ $\mu\text{g}/\text{m}^3$	TSP $\mu\text{g}/\text{m}^3$	VOC ppm	CO ppm	2S ppm	LEL (%)
1	Kryqezimi i rruges para fab tullave	2	7	235	258	283	0.480	0	0.1	0.1
2	Ana perendimore 5m prej fab.tullave	0	4	49	67	92	0.484	0	<0.1	<0.1
3	Kryqezimi tek hyrja e Korçës	0	1	66	103	149	0.631	2	<0.1	<0.1
4	Agjensia kryqezimi me pazarin	0	3	17	36	84	0.650	1-2	<0.1	<0.1
5	Sheshi para hotel "Grand"	1	5	25	39	55	0.632	~1	<0.1	<0.1
6	Lendina e "Loteve"	0	3	23	33	45	0.610	0-1	<0.1	<0.1
7	Bashta "Themistokli Germenji"	1	4	34	55	73	0.550	<1	<0.1	<0.1
8	Sheshi i Mitropolitise	2	17	108	129	154	0.514	0.1-0.2	<0.1	<0.1
9	Tek "Ushtari i	0	3	41	68	91	0.700	1	<0.1	<0.1

	Panjohur									
10	Para bashkise	7	3	28	70	118	0.650	0-1	<0.1	<0.1
11	Kryqezimi rruges "28 Nentori"	7	103	415	502	588	0.615	<0.5	<0.1	<0.1
12	Kryqezimi tek Xhamia	1	8	26	71	167	0.560	0-1	<0.1	<0.1
13	Tek "trekendeshi"	1	2	179	491	779	0.560	0-1	<0.1	<0.1
	Norma e lejuar e KE		20		40	80	1	5	0.3	5

Grimcat totale TSP dhe ato të respirueshme të ashpra PM₁₀ janë kryesisht me origjine nga pluhuri i rrugëve që risuspensionohet nga levizja e makinave. Ulja e sasisë së ndotjes në qytet nga pluhurat PM₁₀ dhe PM_{2.5} do mund të bëhet ndër të tjera nga vënia në përdorim të mjeteve të teknologjisë bashkëkohore për pastrimin e qytetit. Grimcat e imta PM_{2.5} e PM₁ janë kryesisht grimca bloze të çliruara nga makinat me naftë. Grimcat 7.5 janë të përzjera. Përfundimisht mund të thuhet se niveli i grimcave është mbi norme kjo vjen kryesisht nga grimcat e ashpra të rrugëve.

Rol pozitiv luajnë erërat e shumta të cilat favorizojnë largimin e këtyre ndotësve nga zonat e banuara. Sidoqoftë duke qenë se disa nga ndotësit janë mbi normat e lejuara kombëtare dhe ndërkombëtare është i nevojshëm dhe i domosdoshëm monitorimi më i gjerë i ndotësve të ajrit në këtë zonë.

2.1.5 Menaxhimi i mbetjeve dhe struktura mjedisore

a) Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Bashkia Korçë sikurse edhe pjesa tjetër e vendit ndeshet me një problematikë mjaft shqetësuese për mbetjet në përgjithësi. Kjo problematikë lidhet ngushtë me mënyrën e grumbullimit të tyre në qytet, me ndërjegjen e banorëve si dhe me vendgrumbullimin e tyre. Gjendja e kontenierëve në qytet shpeshherë nuk është në nivelin bashkëkohor dhe nuk mundëson grumbullimin e diferencuar të tyre. Korça nuk kryen grumbullimin e diferencuar të mbetjeve gjë që nuk e favorizon riciklimin e mundshëm.

Vendgrumbullimi aktual i mbetjeve urbane të Bashkisë Korçë ndodhet vetëm 1.5 kilometer larg qendrës së qytetit. Shumë pranë kësaj hapësire gjendet një lagjeje ku jetojnë një numër i konsiderueshëm banorësh (rreth 150) të cilët jetojnë me një ajrër të rëndë, me insekte dhe shpendë. Gjatë sezonit të verës temperaturat e larta e rrisin edhe më shumë ndikimin e tyre negativ mbi mjedisin dhe shëndetin e popullatës jo vetëm në këtë lagje por në tërë qytetin.

Në fillim e verës së 2012 në këtë vendgrumbullim në kuadrin e një projekti prej 119 mijë eurosh të KFË, nisën punimet për përmirësimin e kushteve mjedisore dhe kushteve të punës në fushën ekzistuese të mbetjeve. Këto punime



Figura 7-Vendgrumbullimi i mbetjeve Korçë

vazhdojnë dhe kanë rehabilituar pjesërisht këtë hapësirë në gjysmën e saj deri në përfundimin e plotë në kthimin e një sipërfaqeje të gjelbër dhe rekreative.

Sidoqoftë mbetjet akoma të ekspozuara në vendgrumbullim tërheqin shpendët që ushqehen me to, shpesh tufa shpendësh që sic dihet përmbajnë shumë krimba zorrësh, një numër të madh baktere fekalesh koliform (*coliform*) dhe baktere kamfilobakter (*camphylobacter*), të cilat për një kohë të shkurtër mund të kontaminojnë burimet ujore. Evidencat sugjerojnë se shpendët, dhe jo ujërat e trajtuara të kanalizimeve, janë përgjegjëse për kamfilobakterin në ujin e pijshëm dhe ujin për larje. Gjithashtu ekziston rreziku i infektimit të njerëzve nga Gripi i Shpendëve (*CDC Avian Influenza*). Këto zona gjithashtu tërheqin kafshët parazitare që mbartin sëmundje, përfshi minjtë e kanaleve, të cilët janë në vetvete transmetues të sëmundjeve. Prandaj janë të domosdoshme masat për reduktimin e ndikimeve nga shpendët dhe kafshët parazitare dhe më në përgjithësi rehabilitimi i vendgrumbullimit të mbetjeve në Korcë.

Në nivel qarku po zbatohet projekti rajonal “Studimi i fizibilitetit për menaxhimi i mbeturinave të ngurta në Shqipërinë Juglindore” nga konsorciumi gjermano-shqiptar, IGIP/IU/HUK. Ky projekt financohet nga KFË me fonde të qeverisë federale gjermane, në kuadrin e bashkëpunimit financiar gjermano - shqiptar. Investimi total është rreth 15,8 milionë Euro (vlerësuar për 20 vjet) - fusha e mbeturinave është parashikuar për më shumë se 20 vjet dhe në të do të depozitohen më shumë se 1 milionë ton mbetje. Kjo nismë synon: i) të ngrejë një sistem modern mjedisor dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve në rajonin e Korçës; ii) të ngrejë fushën e parë sanitare të grumbullimit të mbetjeve në Shqipëri; iii) të zbatojë për herë të parë konceptin e menaxhimit të integruar të mbetjeve; iv) të japë shembullin e parë për qeverisjet vendore, që bashkëpunojnë në rrugë institucionale për menaxhimin e mbetjeve. Në Shoqatën e Aksionerëve për ndërtimin e fushës së re të grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane, ose siç quhet ndryshe Landfilli i Maliqit, janë aksionarë 5 bashki dhe 23 komuna të Qarkut të Korçës.

c) Mbetjet ujore dhe ujërat e zeza

Korça është një nga qytetet e pakta në Shqipëri që ka një sistem kanalizimesh të ujerave të zeza dhe urbane si dhe një impiant trajtimi të tyre. Ky sistem ka një gjatësi prej 80 km dhe mund të shërbejë për një popullsi rreth 102,000 banorësh, pra ka marrë parasysh edhe shtimin e popullatës në vitet në vijim nga rreth 70 000 banorë që ka Korca sot. Sidoqoftë mbetet akoma për tu bërë në lidhje më zonat informale dhe ato industriale si dhe me mbylljen e kanalizimeve të hapura në zonat periferike dhe futjen e tyre në tubacione. Kërkesa ndaj bizneseve për trajtimin paraprak të ujërave të tyre mbetet një sfidë për të ardhmen.




Figura 8-Vendonohja e impiantit të trajtimit ujërave

2.1.6 Zhurmat dhe Ndotja akustike

Monitorimi i zhurmave në Bashkinë Korçë tregon se edhe këtu si në cdo qytet të madh të Shqipërisë paraqitet shqetësues sidomos për periudhën e sezonit turistik.

Tabela 5- Monitorimi i zhurmave në Korçë

Vendi i matjes	Vlera Mes. Ditën	Vlera Mes Natën
Kryqëzimi i Hyrjes	70 dB	42 dB
Tregu i Shumicës	65 dB	44 dB
Tek Telekomi	69 dB	42 dB
Tek Spitali	66 dB	39 dB

Në tabelën e mësipërme shihen qartë vlerat e monitorimeve dhe që po të krahasohen në vite do të vërehet se janë të përafërta pa pësuar ndonjë rënie të ndjeshme krahasuar me vitin paraardhës si për kohën e ditës dhe atë të natës.

Kontributi kryesor është rritja e trafikut të automjeteve që u vu re nga specialistët të cilët kryen monitorimin. Ky fluks është rrjedhojë dhe e amullisë së krijuar në kryqëzime si nga sasia e madhe e automjeteve dhe nga mos funksionimi i sinjalistikës me shumicën e njeve. Faktor tjetër me një peshë shumë të konsiderueshme është lëvizja e mjeteve të rënda mbi 10 Ton, prania e tyre në nje të tilla problematike vështirëson shpejtësinë e lëvizjes, manovrimin dhe rrit në rreth 30 % nivelet e zhurmave.

Ndër arsytet të tjera përgjegjëse për këtë nivel zhurmash mund të përmendim dhe lëvizjet parazite të automjeteve, mungesa e vend-parkimeve të përkohshme apo të përhershme, mungesa e rrugëve dytësore apo të treta, të cilat do të ulnin ndjeshëm përqendrimin në akset kryesore sjell dhe mbingarkesën në këto akse dhe rrjedhimisht

rrit nivelin, gjendja motorike e automjeteve në qarkullim e cila lë shumë për të dëshiruar, mosha e vjetër e tyre sjell uljen e parametrave optimale të certifikatës teknike të automjetit, lidhur me emetimin e zhurmës.

Gjatë vitit të fundit në periudhën e verës gjatë sezonit turistik ka pasur mjaft ankesa edhe nga banorët lidhur me zhurmat që vijnë nga baret, klubet natës dhe restorantet si pasojë e muzikës përtej normave të lejuara.

Pas aktit normativ të qeverisë shqiptare për të ndaluar jashtë orarit të lejuar zhurmat në lokalet e natës, një aksion task-forcë ka nisur punën në qytetin e Korçës. Me gjithë masat e marra nga prefektura dhe bashkia përsëri fenomeni nuk është eliminuar. Zbatimi i ligjit përkatës nuk bëhet nga subjektet megjithëse rrezikojnë licencat e aktivitetit të tyre. Masat lidhen jo vetëm me nivelin e zhurmave mbi ato të lejuara por edhe për orarin që në bazë të ligjit është i ndryshëm për ditët e javës dhe për fundjavën.

2.2 Struktura Urbane

2.2.1 Përdorimi i tokës dhe struktura e zhvillimit

a. Përcaktimi i përgjithshëm i përdorimit të tokës

Qyteti i Korces eshte qendra kryesore ne Shqiperine Juglindore. Korca kufizohet nga Rrethi i Elbasanit ne Veriperendim, nga Rrethi i Beratit ne perendim. Nga Rrethi i Gjirokastrës ne Jugperendim, si dhe ndodhet ne kufi me Maqedonin ne verilindje dhe Greqin ne Juglindje.

Rajoni i Korçës përfshin katër nënprefektura; Korçën, Pogradecin, Devollin dhe Kolonjën. Thuhet se 75% e tokës së rajonit në total mbulohet me kodra dhe male. Megjithatë, cilësia kryesore e mjedisit natyror korçar është fusha e madhe e Korçës, që ndodhet në 850m mbi nivelin e detit. Kjo pllajë përbën sipërfaqen e dytë më të madhe bujqësore të Shqipërisë, ndërsa pjesa më e madhe e saj është një ish-kënetë, e bonifikuar mbas Luftës së Dytë Botërore. Përreth Korçës ka shumë pyje. Një prej kërcënimeve kryesore mjedisore është aktualisht degradimi i pyjeve si rrjedhim i prerjes masive të tyre për ngrohje shëpiake. Një perqindje e madhe e sipërfaqes bujqësore rreth Korces (20% ne rrethin e Korces) aktualisht nuk perdoret per shkak te mungeses se investimeve dhe emigracionit.

Emri	Sip. Totale (ha)	Siperf. e kultiv (ha)		Siperf. pyjore (ha)		kullota(ha)		Te tjera (ha)	
			%		%		%		%
Rrethi	366,024	86,108	24 %	132,075	36 %	53,732	14 %	94,109	26 %
Korca	172,478	44,207	26%	54,900	32%	23,604	13%	49,767	29%
Pogradeci	71,541	17,506	24%	27,330	38%	5,364	7%	21,341	31%
Devolli	41,542	13,148	32%	15,165	37%	3,022	7%	10,207	24%
Kolonja	80,463	11,247	14%	34,680	43%	21,742	27%	12,794	16%

Tabela 6: Shperndarja e perdorimit te tokes ne Qarkun e Korces (Burimi: Drejtoria e Bujqesise dhe Ushqimit)

Nje siperfaqe e konsiderueshme pyjore ndodhet rreth qytetit te Korces. Nje nga problemet shqetesuese eshte degradimi i kesaj siperfaqe gjate viteve te fundit, per shkak te prerjeve te pemeve per qellime ngrohje, nga kompani private dhe individ te palicensuar te cilet nuk bejne zevendesimin me fidane te rinj pyjor. Nje shembull negativ ne kete drejtim jane demtimet e shkaktuara ne malin e Moraves, gjate vitit 1990.

Struktura urbane e Korçës reflekton evolucionin e saj historik përgjatë dy shekujve të fundit. Tipologjitë e ndryshme urbane i referohen periudhave të ndryshme historike dhe që ende bashkëjetojnë, duke krijuar një mjedis ndërtimesh veçanërisht interesantë. Një cilësi kryesore e strukturës urbane të Korçës është natyra e saj kompakte. Pjesa kompakte është një zonë e projektuar rrethore (D=1.5-2.5km), e rrethuar nga Parku Rinia dhe Kompleksi Sportiv në veri, unaza në perëndim dhe jug dhe kodrat e Moravës në lindje. Zona ka një karakter të qartë urban dhe përfshin lagjet kryesore urbane dhe Qendrën e Qytetit, me të gjitha objektet publike kryesore.

Komponentet tematike të mëposhtme të strukturës urbane ndihmojnë për të krijuar një panoramë të qartë të sistemit urban, zhvillimit dhe funksionimit të tij:

Qyteti historik

- **Nukleusi tradicional**, i shekullit të 19^{te} dhe fillimit të shekullit 20^{te} është një zonë e lidhur, që përbën zemrën e qytetit dhe në ngjitje të Kodrave të Moravës. Ajo karakterizohet nga banesa një ose dykatëshe me kopështe, ngastra të vogla toke dhe rrugë të ngushta të shtruara me kalldrëm. Nukleusi tradicional është zhvilluar historikisht përreth dy poleve: Kishës Ortodokse dhe polit të Xhamisë dhe Pazarit.
- **Pazari** është një monument unik me vlerë të vecantë kulturore që ka vazhduar funksionin e tij në të njëjtin vend përgjatë kohës dhe është ende në operim si tregu kryesor i qytetit. Në veri, ndërtime tradicionale urbane të Pazarit ndërthuren me ndërtesat prej betoni, në të cilat ndodhet edhe supërmarketa e ushqimeve.

b. Qendra e Qytetit

- Qendra e Qytetit qëndron sot ndërmjet entiteteve tradicionale të spikatura. Ajo u ndërtua mbas vitit 1950 dhe karakterizohet nga rrugë dhe bulevarde të gjera, sheshe të hapura si edhe ndërtesa të kohës së socializmit të vendosura përgjatë akseve kryesore të rrugëve. Edhe qendra e qytetit shtrihet në nukleusin tradicional, përgjatë Bulevardit Republika.
- Korça është një **qytet tipik monocentrik**; pjesa më e madhe e objekteve tregtare, kulturore dhe argëtuese së bashku me ndërtesat administrative të qytetit janë të përqendruara në qendër të qytetit. Nuk ka nënqendra të tjera pavarësisht nga disa dyqane të vegjël për plotësim të nevojave të përditëshme dhe objekteve publike të shërbimit. Kjo mund të vërehet nga vëzhgimi i qytetit kompakt dhe bëhet më e qartë kur lëvizet në drejtim të periferisë.

c. Zonat Rezidenciale

Zonat rezidenciale janë të kategorizuara sipas tipologjive të mëposhtme:

- **Lagjet rezidenciale nga koha e socializmit**, me shtëpi teke me një kopësht, të ndërtuara mbas viteve 1950 përreth nukleusit tradicional. Kjo zonë është e karakterizuar nga ngastra të vogla, rrugë të drejta dhe të ngushta dhe pak hapësira të lira.
- Lagjet rezidenciale nga koha socialiste me **ndërtesa kolektive apartamentesh** janë kryesisht të lokalizuara në pjesën jugore të qytetit. Ato janë të karakterizuara nga blloqe të mëdha banimi (4-5 kate) të organizuara me hapësira të kufizuara, rrugë të gjera dhe hapësira të përbashkëta të gjera.

- Zonat rezidenciale nga periudha e fundit e socializmit (1980-90) janë të lokalizuara në pjesën verilindore të qytetit me **blloqe apartamentesh 6 katëshe të larta**. Me qëndrim të lirë.
- Periudha e pas-1990 karakterizohet nga ndërtimi i **ndërtesave shumëkatëshe dhe shumë-funksionale** (8-9 kate të lartë). Ato janë të lokalizuara kryesisht në zonën ish-industriale në hyrje të qytetit (pranë aksit rrugor në drejtim të Tiranës) si edhe përgjatë Shëtitores Fan S. Noli dhe Rrugës 28 Nëntori.
- Në përfundim, një entitet i veçantë është **zgjerimi i planifikuar i qytetit i aprovuar** pranë Varrezave, në pjesën juglindore të Korçës me banesa teke.
- Prej fillimit të viteve 1990, kolapsi i sistemit të centralizuar ekonomik çoi në ndërtimin e grumbujve të banesave informale në periferi të qytetit, kryesisht përgjatë rrugëve që çojnë në vendbanime të afërta (Voskopoja, Erseka, Polena). Rrjedhoja e zhvillimit informal është ndërtimi i një mjedisi me cilësi të ulët. Një përjashtim është zona e zhvilluar në lindje të Korçës në drejtim të fshatrave Barç dhe Mborje, si zona peri-urbane me ndërtime me cilësi rekativisht të lartë.

d. Zonat Tregtare dhe Industriale

Korça zotëron një zonë industriale të madhe të zhvilluar në periudhën e Regjimit Socialist në pjesën veriperëndimore të qytetit përgjatë aksit hyrës nga Tirana. Zona shtesë me aktivitete ekonomike janë zhvilluar përgjatë aksit rrugor të Bilishtit (verilindje), pas Varrezave (juglindje) dhe përgjatë rrugës së Polenës (jugperëndim). Prej vitit 1990, aktiviteti industrial ka degraduar shumë, duke lënë sipërfaqe të mëdha të tokës dhe objekte të braktisura.

Në të dy anët e aksit në drejtim të Tiranës, zona ish-industriale është degraduar dhe për rrjedhojë ka tërhequr zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me ndërtimet, si edhe aktivitete të tjera komerciale.

e. Shërbimet Publike

- **Arsimimi:** kopshtet e fëmijëve, shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme e mbulojnë nevojat lokale në një masë të konsiderueshme. Në nivel qyteti ekzistojnë 9 shkolla profesionale të cilat specializojnë të rinjtë në industri, teknologji, agrobiznes, ndërtim, gjuhë të huaja dhe muzikë. Universiteti ‘Fan S. Noli’ është qendra edukuese më e rëndësishme në Shqipërinë juglindore, duke pasur 4,000 studentë dhe duke ofruar diploma studimi në Arsim, Ekonomi, Agronomi dhe Infermieri. Një universitet privat operon në zonën fqinje të SMT.
- **Kujdesi Shëndetësor:** ekzistojnë 9 qendra shëndetësore në nivel lokal. Në nivel rajonal qyteti ofron një klinike materniteti, një poliklinikë dhe spitalin rajonal. Ndërtesa e Spitalit është rinovuar në vitin 2007 dhe ofron 550 shtretër.
- **Aktivitetet Sportive** në nivel lokal dhe rajonal janë përqendruar në Kompleksin Sportiv Skënderbeu.
- **Aktivitetet Kulturore** janë të përqendruara në Qendër të Qytetit; pesë muzeume, Librari, Qendra Kulturore, Teatri Çajupi dhe Kinemaja Majestik. Muzeumi i Ri i Periudhës Mesjetare është ndërtuar po në Parkun Shetro.
- **Ndërtesat fetare** janë relativisht të pakta. Kishat janë të përqendruara në pjesën veriore të qytetit ndërsa dy xhamitë janë të lokalizuara në jug.

			Arsimi			Shende tesia		Drejte sia		Kultura		Administrata		
			Shkolla tetevjecare	Shkolle e mesme	Universitet	Qender shendetesore	Spital	Gjykat e shkalles I	Gjykata shkalles II	Muze	Tjeter	Zyra Kombetare	Zyra Bashkie	Zyra Komune
Rrethi	Qarku	Pushteti Vendor												
Korca	Korca	Bashkia Korca	15	13	1	4	1	1	1	4	1	1	1	
		Bashkia Maliq	3	1		1							1	
		14 Komuna	95	10		14								14
	Pogradec	Bashkia Pogradec	6	4		1	1	1					1	
		7 Komuna	61	11		7					2			7
	Kolonja	Bashkia Erseka	1	1		1	1						1	
		Bashkia Leskovik	4	1		1							1	
		6 Komuna	31	2		5								6
	Devoll	Bashkia Billisht	2	1		1	1						1	
		4 Komuna	35	4		4								4

Tabela 7: Shperndarja e fasiliteve te publike ne Qarkun e Korces (Burimi:Qarku Korce)

f. Parqet dhe Hapësirat e Hapura

Në qytetin e Korçës ka një kërkesë të fortë lokale për përmirësimin e hapësirave të ndryshme publike. Bashkia është shumë e përgjegjshme për rëndësinë e hapësirave të lira të mirëmbajtura dhe gjatë viteve të fundit, janë realizuar shumë projekte reabilitimi në kuadrin e projektit “Rigjenerimi i Hapësirave të Gjelbërta”. Sot në Korçë ekziston një mori hapësirash të lira me përmasa të ndryshme dhe e përdorur për qëllime të ndryshme: Më specifiku ato janë:

Rrugë dhe sheshe: shumë rrugë, shëtitore dhe bulevarde në Korçë të cilat karakterizohen nga një bimësi e lartë e pemëve të reja dhe të rritura.

Parqet e lagjeve dhe “kopshtet xhepa” janë hapësira të gjelbërta të madhësisë së vogël dhe mesatare me distanca të afërta me zonat e banimit.

Parqet e bashkisë janë të vendosur në pjesën periferike më veriore urbane të qytetit, duke ofruar një larmi aktivitete për banorët e zonës:

- Parku ‘Rinia’ është parku urban më i madh i qytetit, i përdorur gjerësisht nga banorët për shëtitje dhe argëtim. Parku është i vendosur pranë hyrjes veriore të qytetit dhe ndodhet pranë Universitetit Fan S. Noli dhe Kompleksit Sportiv Skënderbeu.
- Hapësirat e lira përreth Kompleksit Sportiv Skënderbeu përbëjnë një park urban intensiv me fokus në sportet e ndryshme.
- **Kodrat e Moravës:** Kodrat, shkëmbinjte dhe vendet e pjerrëta të Moravës rrëzë së cilës shtrihet qyteti, në të kaluarën kanë qenë publike dhe të pyllëzuara.

2.2.2 Aksesueshmeria dhe Rrjeti i Transportit

a. Rrjeti Rrugor Kombëtar dhe Rajonal

Qyteti i Korces shtrihet ne Juglindje te Shqiperise, afersisht 35 km larg nga kufiri me shtetin Grek(Kristalopogji) dhe afer (afersisht 100 km) nga Korridori i VIII dhe Rrjeti Pan –

European i Transportit. Transporti kryesor qe udheheq Korca eshte dega jugore e Korridorit kombetar Lindje – Perendim i cili fillon nga Tirana ne Elbasan, Pogradec, Korce dhe Greqi. Seksioni Pogradec- Korce tashme ka perfunduar dhe shkurton kohen e udhetimit prej kryeqytetit afersisht rreth 1 ore. Ka gjithashtu plane per ndertimin e nje rruge malore e cila lidh Korcen me Elbasanin duke kaluar Pogradecin, akoma informacioni mbi karakteristikat dhe kohen e ndertimit te saj nuk jeshite siguruar.

Dy rruge te tjera te rendesishme qe lidhin Rajonin jane:

- Superstrada ne pjesen verilindore te qytetit te Korces i cili kalon Malin e Moraves dhe lidh Bilishtin me shtetin Grek. Kjo rruge eshte ne kushte te mira me nje korsi ne secilin drejtim.
- Rruga rajonale nga Korca ne drejtim te jugut i cili lidh qytetin me Gjirokastrin me qytete te tjera si Erseka e Permeti. Kjo rruge eshte ne kushte te mira me gjeresi 6 metra dhe ka nje korsi ne secilin drejtim me nje shpejtesi mesatare rreth 40km/ore.

Rrjeti hekurudhor lidh Tiranen me Pogradecin.

Duke ndjekur tendencen kombetare, kjo vije hekurudhore eshte se tepermi e paperdorshme dhe ne kushte te keqija, prandaj planifikimi per shtrirje te saj drejt Korces nuk ka qene zbatuar. Megjithate, pershirja e kesaj dege ne Studimin e Pare te Fizibilitetit per Korridorin e 8-te, le hapesia per ndertim ne te ardhmen mbi baze te iniciativave te perbashketa Shqiperi-Greqi. Ekzistenca e nje aeroporti ne qytet, lokalizuar rreth 3 km larg ne rrugen nacionale nuk eshte aktiv dhe aktualisht eshte nje vend me grumbullime inerte. Nje studim fizibiliteti per te operuar si aeroport per fluturime te brendeshme eshte pregatitur, dhe Bashkia ka shprehur interes mbi kete zhvillim, kryesisht ne pikpamje te rritjes se aktivitetit turistik ne qytet, megjithate afersia me aeroportet e Kosturit ne Greqi dhe Ohrit ne FYROM, ashtu si dhe vemendja e MPPT per zhvillimin e nje aeroporti nderkombetar ne Sarande , le me shume hapersire per diskutim ne lidhje me nevojat aktuale per te tilla investime.

b. Sistemi Rrugor Ekzistues Bashkiak

Rrjeti i rrugëve ne Korce ka qene se tepermi i influencuar prej zhvillimit te qytetit qysh ne shekullin e 15-te. Zhvillimi i sistemit te rrugëve ne te gjitha periudhat ishte qenderzuar ne tregun e qytetit i cili akoma luan nje rol te rendesishem ne jeten social ekonomike te qytetit. Rrjeti i ngushte dhe i pa rregullt u zhvillua midis shekullit te 15-17-te i cili perbehej prej 2-5 meter gjeresi , rruge me kalldrem, qe direkt reflektonin zhvillimin e modeleve urbane te mesjetes.

Rrjeti i rrugëve i cili u zhvillua gjate shekullit te 19-te , ne anen tjeter , reflekton nje zhvillim te shpejte te qytetit ne ate kohe, e ndjekur nga nje forme e rregullt gjeometrike Brenda nje gjeresie uniforme 4-6metra. Keto rruge jane paralel duke filluar nga kodrat e qytetit ne drejtim te rruges kryesore te qytetit dhe jane kryesisht te ndertuara me kalldrem me trotuare. Ato jane nderprere ne menyre terthore nga rruge te tjera duke krijuar nje lidhje simbiotike midis qytetit dhe pjeses se kodrave te tij. Gjate periudhes socialiste , nje forme e re e rrjetit te rrugëve filloit te ndertohej si pjese e nje fenomeni te ri te ndertesave rezidenciale kolektive

ose ndertesa apartament. Keto ndertesa ishin ndertuar pergjate rruges kryesore te asfaltuar me gjeresi rreth 7 meter dhe trotuar me gjeresi rreth 2 meter me ndricim rruges dhe foliage. Pjesa e brendeshme e ketyre lagjeve te reja pershkohet prej trotuareve me gjeresi 3-3.5 meter e cila perdoret kryesisht prej kembesoreve dhe mjetet e emergjences.

Periudha post socialiste tregoi zhvillimin e dy tipeve te rrjetit rrugor. Planifikimi me i ri i lagjeve zhvilloi nje rrjet ku modeli kaotik i zhvillimeve informale krijoi varferi rruge jo te rregullta dhe patrotuare.

Rrjeti rrugor ne Bashkine e Korces konsiston:

- | | | |
|------|---------------------------------|--------------------------------|
| i) | Rruge te asfaltuara: | 340,000 m ² ose 49% |
| ii) | Rruge me kalldrem: | 60,000 m ² ose 37% |
| iii) | Rruge te ndotura dhe pa trotuar | 90,000 m ² ose 14%. |

c. Transporti Publik

Transporti publik ne qytet kryhet nga autobuze te cilat operojne nga kompanite private dhe mbeshtetet nga Bashkia. Aktualisht operojne dy linja.

- Linja rrethore e cila lidh lagjet me veriore dhe pjesen me te madhe rekreative, sportive dhe te edukimit me qendren e qytetit dhe lagjet Juglindore qe shumica e pasagjereve te saj e perdorin kete sherbim sipas vleresimeve te perfaqesuesve te Bashkise. Autobuzet ecin rreth 15 minuta.
- Linja e drejte apo lineare ne te cilen ecin ne pergjithesi drejtimi Juglindor dhe Veri perendimor afersisht 20 minuta, ka nje numer me te vogel pasagjeresh qe e perdorin , ne fakt ajo i sherben lagjeve me dendesi me te madhe te qytetit.

Eshte karakteristike qe asnje autobuz nuk rrotullohet pergjate Bulevard Republika , por vetem ne zonen karakteristike tregtare dhe lokalizimi qendror ne zemer te qytetit te vjeter. Sipas perfaqesuesve te Bashkise rruga e autobuzese eshte rregulluar ne kete menyre sepse mendohet qe mund te shkaktonte nje mbipopullim (nje hapesine jo e pershtashme per stacionet e autobuzeve ne ane te rrugeve). Kjo zgjedhje, megjithate ka lene mbrapa traditen e Korces pa sherbim transporti publik, duke bere te rritet nevoja per mjete transporti private keshtu duke bere qe te acarohet me tej trafiku ekzistues dhe problemet e parkingut ne kete zone.

30 autobuze interurbane lidhin Korcen me zonat perreth saj si dhe me destinacione te tjera te Shqiperise. Stacioni qendror eshte lokalizuar ne zonen e Pazarit ; prane me stacionin e autobuzeve, ndodhet ai Furgoneve (miniautobuza qe sherbejne per destinacione lokale) ; vendosja e tyre ne hyrje te pazarit eshte duke shkaktuar probleme ne trafik dhe ndotje, prandaj Bashkia po punon per te vendosur ate ne ish zonen industriale , pergjate rruges se unazes se brendeshme. Bashkia rregullon ndalimin dhe rrotullimin e autobuzeve interurbane ne rruget e qendres, ne perpjekje per te evituar mbipopullimin e ketyre rruges.

2.2.3 Energjia dhe Telekomunikacioni

a. Furnizimi me Energji

Elektriciteti ne qytetin e Korces realizohet me ane te furnizimit nga OSSH. Kompania furnizon qytetin me energji elektrike ne linja 20, 10 dhe 0.4KV. Rrjeti eshte i bazuar ne nje nenstacion te vetem 110KV dhe eshte ndertuar ne vitin 2005, ndersa nje sistem shperndarje i

ri 20, 10 dhe 0.4KV është kompletuar kohët e fundit. Rrjeti i ri i ndërtuar me voltazh të mesëm dhe nënstacioni elektrik plotësojnë kërkesat për energji elektrike. Rrjeti i ri elektrik i bashkisë është nëntokësor dhe përfshin afërsisht 150 qeliza të reja dhe bifurkime, ndërsa linja ajrore me voltazh të ulët që lidhin konsumatorët janë të vjetra. Rrjeti ka qenë i shtrirë në të gjithë qytetin ku përfshihen edhe zonat informale, ai mund të përballojë një numër banorësh rezidentë 3 herë më të lartë se numri aktual i banorëve.

Në këtë moment, në qytetin e Korçës ngrohja realizohet duke përdorur drurin dhe nuk ka një sistem elektrik rezidencial të përshtatshëm. Në të ardhmen del si detyrë që të hartohen plane për ngrohjen e banesave me anë të sistemeve elektrike, duhet që të zgjerohen sistemi elektrik ekzistues njëkohësisht në terma prodhimi dhe transmetimi.

b. Telekomunikacioni

Sipas të dhenave të ofruara nga përfaqësues të bashkisë, kompania përgjegjëse është ALB-Telecomi, e cila perbalon gjithë popullsinë e qytetit pa asnjë problem. Kompania lidh edhe banoret e zonave informale. Sipas të dhenave të paraqitura nga konsulenti, rreth 15,000 shtëpi kane kontrata me kompaninë (rreth 60,000 banorë), një shqifer e perafert me numrin e popullsisë të qytetit. Shume pak konsumatore kane një linje sekondare dhe është e mundur që keto linjat janë të rezervuara për bizneset, shërbimet, industritë dhe tregëtisë. Numri i regjistrimeve në internet është i vogël, rreth 200 kliente.

Rrjeti kombëtar është i ndërtuar me fije optike dhe rrjeti bashkiak është me fije kabli të bakrit. Është e nevojshme një studim më të thellë të kushteve të rrjetit ekzistues me qëllim zëvendësimin e linjave të vjetra me fije optike.

2.3 Peizazhi Urban dhe Trashëgimia Kulturore

Historia e qytetit modern fillon në shekullin e 15^{te}. Korça u rrit dhe u bë qendër kulturore, ekonomike dhe tregtie me rëndësi në shekujt 18^{te} dhe 19^{te} në Ballkan, në kuadrin e Perandorisë Osmane. Në fillim të shekullit të 19^{te} qyteti u përhap përreth Pazarit dhe u nda nga lumi në dy pjesë - në komunitetin Kristian dhe atë Mysliman. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 19^{te} dhe fillimit të shekullit të 20^{te}, qyteti u shtri në veri. Bulevardi Republika është një shembull tipik i kësaj periudhe, i karakterizuar nga vilat urbane të stilit neoklasik dhe eklektik. Këto zona, bashkë me Zonën e Pazarit, përfaqësojnë trashëgiminë kulturore më me vlerë të Korçës.

Një numër i konsiderueshëm pasurisë natyrore dhe mjedisore janë në territorin e Korçës, siç Parku Natyror i Liqenit të Prespes, i cili është Park Kombëtar dhe Zona e Mbrojtur Nderkufitare, Parku Kombëtar i Drenoves, në kreshten e malit të Moraves dhe Liqeni i Ohrit. Objektet e mësipërme së bashku me lumin, pyjet dhe liqenet e vegjël me faunë dhe florë të pasur ofrojnë një potencial të madh për zhvillimin e turizmit dhe turizmit ambjental. Zonat e mbrojtura të Rrethit të Korçës paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Zona	Kategoria	Tipi i zones	Sip. (ha)	viti
Kreshta e Drenoves	II	Parku Kombëtar i Korçës	1,380	1966
Liqeni i Prespes	II	Parku Kombëtar i Korçës	27,750	1999

Maliq	IV	Menaxhimi i Burimeve Natyrore Korce	50	1961
Shelegu	IV	Menaxhimi i Burimeve Natyrore Kolonja	430	1996
Cangonj	IV	Menaxhimi i Burimeve Natyrore Devoll	250	1960
Krastafillak	IV	Menaxhimi i Burimeve Natyrore Korca	250	1977
Nikolica	V	Pamja Konservative Devoll	510	1996
Liqeni i Ohrit	V	Pamje Konservative Pogradec	27,323	1999
Piskal-Shqeri	VI	Menaxhimi i Burimeve Natyrore Kolonja	5,400	1996
Guri i Nikes	VI	Menaxhimi i Burimeve Natyrore Pogradec	2,200	1996

Tabela 8 : Zona e Mbrojtur ne Qarkun e Korces (Burimi: Qarku i Korce)

Gjithashtu, Korca mbetet nje qender e rendesishme kulturore per gjithe zonen e jugelindjes se Shqiperise, qe ndjek traditen e vjeter si qender kulture dhe arti. Pasuri natyrore te vecant ndodhen ne rrethinat e qytetit (harta 1). Ndermjet tyre mund te permendim Voskopojen dhe Dardhen. Voskopoja ka qene qender e rendesishme kulturore dhe tregetare ne shekujt e 17 dhe 18 dhe ruan nje sere munumentesh Bizantine. Dardha eshte nje vendbanim tradicional malor qe ofron nje natyre mjedise kulturore si dhe mundeis per sporte dimerore. Nje seri vendbanimesh, sic jane Vithkuqi, Mborja dhe Boboshtica gjithashtu ofrojne nje mjedise tradicional me shtepi me gure, me kopeshte/bace dhe rrugica me kalldrem, si dhe monumete me vlere te vecanta. Mborja per shembull eshte vendodhja e Kishes se Shen Ristoze, monumeti I vetem Bizantine I shekullit te 14. Gjithashtu rrethi I Korces eshte I njohur per prodhimin e produkteve te ndryshme locale si “raki” mani karakteristike per zonen e Boboshtices, etj. Se fundi Korca eshte vendi I disa zonave arkeologjike, sic jane Kodra e Kamenices, prane fshatit mollaj, qe daton qe nga moshja e bronxit.

2.4 Profili socio-ekonomik

2.4.1 Profili social dhe demografik

Popullsia e regjistruar e qytetit të Korçës i kalon 86,000 banorë. Një vlerësim i kësaj shpërndarje merr në konsideratë efektin e qytetarëve që nuk janë banorë të përhershëm, të konsideruar emigrantë të cilët jetojnë jashtë shtetit. Në një përpjekje për të vlerësuar numrin e rezidentëve në qytetin e Korçës, është e nevojshme të kontrollohen dokumentat e bashkisë dhe të shqyrtohet informacion verbal që është i lidhur me sasinë e konsumit të ujit, vëllimi i ujërave të zeza, lidhjet telefonike, konsumi elektrik, dhe grumbullimi i taskave. Një interpretim jozyrtar i informacionit të disponueshëm sugjeron se popullsia rezidente e përhershme në qytetin e Korçës, në periudhën 2008/9, përllogaritet në 68,000 banorë.

Burimi i informacionit	Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë	Dokumenta të bashkisë	Një përafrim i mundshëm
Viti	2001	2008/9	2008/9
Banorë	74,000	87,000	68,000

Tabela 9: Popullsia e qytetit të Korçës, 2001 – 2008/9

Korça: Popullsia sipas gjinisë		
Meshkuj	Ferma	Totali
41,500	44,900	86,400

Tabela 10: Popullsia e regjistruar në qytetin e Korçës në vitin 2008 sipas gjinisë (Burimi: Bashkia e Korçës, Buletini Statistikor, 2008)

Korça: Popullsia sipas grupmoshave	
Grupmosha	Përqindja %
0 - 18	32 %
18 - 65	58 %
65 +	10 %

Tabela 11: Popullsia e regjistruar në qytetin e Korçës në vitin 2008 sipas grupmoshave (Burimi: Bashkia e Korçës, Buletini Statistikor, 2008)

Ne vleresimin e kesaj shperndarjeje duhet te merren ne konsierate efektet e mundeshme te banoreve qe nuk jane present, disa prej te cileve jetojne jashte kufijve ndersa familjet e tyre jetojne ne Korce.

Ndryshimet e rregjistruara ne popullsi ne Korces per 2008 ishin:

Lindje	Vdekje	Te ardhur	Te larguar	Ndryshimi total
+476	-524	+524	-614	-138

Tabela 12: Ndryshimi i popullsi ne Korce, 2008 (Burimi: Bashkia e Korces, Buletini Statistikor, 2008)

Me fjale te tjera raporti i rritjes se popullsi se rregjistruar ne Korce, praktikisht eshte zero, e krahasuar me nivelin pozitiv prej +0.5 ne +0.55% te popullsi rezidente treguar ne rang kombetar. Diferenca midis popullsi aktuale rezidente dhe asaj te rregjistruar parandalon nje krahasim naiv te nivelit bashkiak dhe kombetar. Akoma duket e arsyeshme qe niveli i emigracionit ne Korce akoma perben nje vezhgim ne rang kombetar. Ky nocion eshte konsistent me vleresimin e sugjeruar qe rreth 20-25,000 qytetare te rregjistruar jane, ne fakt ne emigracion.

2.4.2 Profili ekonomik

Korca eshte nje pike ne thellesi te vendit qe ndodhet 181km larg nga kryeqyteti, Tirana, dhe aeroporti nderkombetar dhe 200 km nga porti detar i Durresit (krahasuar me 250km nga porti detar i Selanikut, Greqi.). Si rregull , zhvillimi ekonomik , gjenerohet ne akset metropolitane te vendit si Tirana e Durresi dhe nuk penetron ne zonat rurale te Shqiperise. Korca eshte

konsideruar nje perjashtim nga rregulli, duke mbajtur vitalitetin sipermarres rajonal. Sipas te referimit te te dhenave ne Korce, pothuajse 18,500 (11,000 meshkuj dhe 7,500 femra) jane te punesuar.

Tre tregje te medha orientojne industrite dhe ekonomine e rajonit dhe qytetit te Korces.

- Bujqesia dhe agrobiznesi;
- Industria e prodhimit te veshjeve
- Industria e turizmit.

Tjeter industri e lidhur me shkembimin nderkombetar eshte ndertimi, i cili eshte financuar dhe zgjeruar prej te ardhurave ta fituara nga puna e shqiptareve pertej kufijve.

Sektoret	Punesimi (%)
Prodhim ne veshje	25%
Agro perpunimi	5%
Industrite e tjera	10%
Ndertimi	10%
Turizmi	20%
Sherbime te tjera te sektorit privat	25%
Sherbime te sektorit publik	25%
	100%

Tabela 13 : Punesimi ne sektore primare e sekondare Korca, 2009
(shifra te peraferta te siguruara prej zyrave publike ne Korce)

Nje numer rreth 20,000 ose me teper qytetare te Korces, kontribuojne ne jeten ekonomike te qytetit nepermjet remitancave. Nga nje informacion mbi transfertat e emigranteve ne Greqi, rezulton se rreth 13% e tyre jane me origjine nga Korca. Ne te njejten kohe rreth 6.5% e shumes se derguar nga Greqia ne Shqiperi eshte e drejtuar ne Korce duke treguar qe emigrantet preferojne Tiranen si nje vend per te investuar of the amount remitted from Greece to Albania is directed to Korca, indicating that emigrants prefer Tirana as an investment target to their native Korca. Kjo perqindje e ulet (6.5%) perfaqeson nje shume qe zyrtaret e Bashkise vleresojne qe depozitat aktuale te emigranteve shqiptare jane duke pritur mundesite te investojne ne Korce nje shume rreth 225 milion US\$.

Qyteti i Korces eshte nje pike e rendesishme e disa sherbimeve per te plotesuar nevojat e familjeve dhe bizneseve ne Korce dhe rreth saj. Keto perfshijne sherbimet financiare dhe tregtare, sherbime publike, te tilla si shkolla dhe klinika te sektorit publik.

2.4.3 Aktivitetet primare të sektorit dhe rezultatet

Bujqesia

Zona rreth qytetit te Korces eshte nje rajon ku mbizoteron prodhimi i drithrave dhe fermat jane prezente ne zonen rurale. Shifrat me te fundit tregojne qe prodhimi bujqesor ze rreth 32% te ekonomise se Rajonit. Megjithate fushat ne sektorin e fermave ne nivel rajonal jane ne nivel te moderuar, me potencial te ulet agro teknologjik, varietet dhe intensitet te ulet ne aplikimin e agro-kimikateve (duke e konsideruar ne nivel pozitiv nga pikpamja mjedisore).

Kjo eshte e lidhur me fragmentimin e tokes, mungesen e bashkimit te fermave ose kreditimin dhe lehtesite e marketingut ashtu si dhe mungesa e burimeve financiare, gjetja e veshitresive per te investuar, konsoliduar dhe modernizuar duke mos garantuar stabilitet. Ne kete kontekst, furnizimi rajonal me produkte te fermes bie dhe per rrjedhoje dhe kerkesat e banoreve te qytetit te Korces shtrihen ne tregun nderrajonal apo importet e produkteve bujqesore.

Korca eshte nje qender e rendesishme perpunimi, duke konsideruar numrin e madh te biuzneseve. Eshte perqendrimi i trete me i madh i agroperpunimit te vendit (pas Tiranës e Fierit). Asortimentet e perpunuara produkteve te fermes perfshijne drithera, vaj, mish, qumesht, rrush molle , fruta te tjera, perime dhe lule, produktet e perpunuara jane miell, produkte mishi, pije te buta dhe alkalike dhe konservim frutash. Me gjithë furnizimin direkt me produkte, industria e agro-perpunimit ne Korce ashtu si dhe ne vende te tjera ne Shqiperi, eshte e varur nga importi i materialeve te paperpunuara. Eshte sugjeruar qe agrobiznesi eshte nje” drejtues i se ardhmes i ekonomise lokale” ne qytete si Korca, Berati, nje proces i cili kerkon modernizimin e praktikave bujqesore te fermave, terheqjen e investimeve dhe reformat strukture ne drejtim te integritimit vertikal te prodhimit (duke kominuar prodhimin, perpunimin dhe krijimin e lehtesive). Sjellim ne vemendje ceshtjen qe Guvernatori i Bankes se Shqiperise thekson nevojën qe “remitancat te kalojne ne kanale formale” ne rastin e Korces, zhvillimi i integruar i skemave te agroperpunimit mund te terheqe nje sasi te ketyre fondeve te cilat sot jane drejtuar drejt sektorit te ndertimit.

Industria e veshjeve

40 ndermarrje te prodhimit te veshjeve operojne sot ne Korce duke numeruar rreth 4500 te punesuar qe perfaqeson ¼ e te punesuarve totale dhe me shume se gjysmen e punesimit local te femrave. Kjo industri intensive e punes , ku ndermarrjet shqiptare punojne si nenkontraktor (prerje, qepje dhe perfundim) per partnere te huaj kryesisht greke (te cilet sigurojne importin e lendes se pare dhe marrin produktin e gatshem te destinuar per tregjet nderkombetar).pritet te pesoje renie qysh prej rritjes graduale te pages mesatare ne Shqiperi e cila mund te detyroje kontraktoret te kerkojne nenkontraktore me cmim me te lire kryesisht ne vendet e Lindjes se Larget etj. Reformat strukture ne drejtim te integritimit bashkepunimeve midis prodhuesve dhe marketingut mund te kene efekt ne zgjerimin e aktivitetit dhe te mbajen kete industri ne qytetin e Korces. Megjithate duket e veshtire qe kjo industri te ruaje rolin aktul si lider ne punesim.

Turizmi

Me gjithë pozicionin e larget dhe lidhjet e varfera , Korca perfaqeson nje industri turizmi i cili siguron nje burim per aktivitetin ekonomik dhe te ardhurat. Pasurite natyrore dhe ato te trashegimise kulturore te qytetit (qytet i vjeter, numer muzesh duke perfshire Muzeun e Artit Mesjetar, nje nga me te miret ne Europe) dhe nje zone me e gjere (vendet tradicionale si Voskopoja e Dardha, parqet kombetare Drenova e Prespa etj) e gershetuar me organizime dhe atraksione moderne si dhe ngjarje te rendesishme kulturore (festa e birres, ekspozita e artit kontemporan, konferenca nderkombetare etj) terheqin nje numer te madh vizituesh duke e bere turizmin nje aktivitet dinamik ekonomik dhe nje potencial per te ardhmen. Sot Korca ofron rreth 400 dhoma ne 12 Hotele dhe rreth 500 dhoma ofrohen ne qytetet fqinje.

Ndertimi

Rreth 30 firma te bashkuara kane punesuar rreth 2000 punetore ose te vetepunesuar , mbarin sektorin formal te ndertimit ne dhe rreth qytetit te Korces ; rreth 15 firma prodhojne materiale ndertimi. Firmat e ndertimit plotesojne kerkesat e familjeve ne konstruksionin e shtepive private dhe ndertimin e apartamenteve te banimit ne sektorin privat formal ne nje proces te gjere te remitancave te emigranteve. Ata u pergjigjen dhe kerkesave te sektorit privat. Punet publike jane gjithashtu nje sektor i rendesishem te cilet jane te varur nga fondet e donatoreve nderkombetare ashtu si dhe finacime bashkiake te cilat jane te limituara. Keshtu frymezohen firmat e ndertimit dhe te prodhimit te materialeve te ndertimit per te kerkuar menyra dhe rruge te penetrojne ne tregun kombetar per te vendosur marredhenie me interesat e ndertuesve nderkombetare. Natyrisht nje pjese e vogel e bizneseve te ketij sektori i perkasin biznesit informal. Ne rastin e Korces pesha relative e ketij sektori eshte e vogel dhe pritet te ulet pergjate zhvillimit gradual te formalizimit te banesave.

Edukimi dhe kerkimi

Ndermarrjet ekzistuese dhe nje e ardhme e shpejte nuk jane akoma ne teknologji intensive. Megjithate qyteti manifeston vemendjen dhe mobilizimin e kapaciteteve , investimin e kapitalit njerezor permes limiteve aktuale industriale e teknologjike. Investimi ne edukim nuk eshte i ri per qytetin e Korces. Zhvillimi me i fundit ne kete fushe dhe me me teper kuptim, eshte "Universiteti" Fan.S.Noli" I cili ofron diploma ne Edukim, Ekonomi, Bujqesi dhe Infermieri. Shumica e rreth 4000 studenteve vijne nga zonat perreth Korces akoma nje infrastrukture adekuate (zgjerim kampusesh, konvikte me rreth 1000 shtreter etj) dhe te tjera ndryshime ne qytet mund te forcojne rolin nderrajonal ne te ardhmen. Gjithashtu Korca eshte duke planifikuar nje Universitet ne gjuhen angleze per studente te huaj dhe ata vendas. Ky ne fakt eshte nje zhvillim per te ardhmen me qellim te dyfishte ne njerin ane te ndertoje nje eksport te investimesh te orientuara per vehten e vet dhe nga ana tjeter ajo perben nje projekt qe zhvillon teknologjine intensive ne Korce.

Rezultatet

Ekonomia e Korces eshte bazuar ne tre sektore (bujqesia, prodhimi dhe ndertimi, sherbimet), te cilat perbejne nje perzjerje positive te aktiviteti ekonomik, megjithate shkalla e emigracionit te pergjithshem dhe niveli i emigranteve te punes me numrin total te banoreve nxjerr mesataren kombetare , duke treguar nje mungese te mundesive te punesimit dhe tregun e punes jo dinamik. Shtojme qe sektoret udheheqes te punesimit jane subjekt i ndryshimeve strukture te cilat mund te shkaktojne rritjen e papunesise dhe afektojne kohezion social, shumica shenohet ne industrine e prodhimit te veshjeve ne te cilen eshte punesuar rreth ¼ e forcave active te punes , kryesisht femra , qe pritet te ulet me rritjen e koston te punes.

- MT4 – Sigurimi i të dhënave për menaxhimin e tokës

Më poshtë është tabela e qëllimeve dhe masave kryesore me qëllim përmbushjen e tyre:

Tabela 3.3.1 -c Objektivat për Mbrojtjen e Tokës		
Objektiva	Përshkrimi i objektivave	Masat kryesore përparësore publike
MT1	Reduktimi i niveleve të erozionit të tokës dhe dëmeve të shkaktuara	Futja e një sistemi të thjeshtuar të Pylltarisë përparësore dhe Planet e Menaxhimit të kullotave malore (ForMP) për të lejuar zbatimin e shpejtë të ri-mbjelljes dhe masat emergjente për trajtimin e zonat më të prekura të përfshira (2009); Ulja e erozionit të ultësirës përmes zbatimit të masave për të minimizuar erozionin e tokës në Kodin e Praktikës së Mirë Bujqësore (2009)
MT2	Ruajtja e tokave bujqësore në gjendje të mirë mjedisore dhe bujqësore	Zbatimi i riciklimit dhe zbatimi i dispozitave të riciklimit për përdorimin e mbeturinave joorganike (urbane, ujërave të zeza, bujqësore, industriale) si pasurues të tokës në zonat me vlera të ulëta të lëndëve organike - projektet duhet të jenë të identifikuara në kuadër të menaxhimit të planifikuar të mbeturinave ; Kufizimet në nivelet e lejuara të marrjes së ujit për ujë në zonat e prekura, në mënyrë për të promovuar efikasitetin e ujitjes - kjo do të kërkojë veprim të koordinuar nga shërbimi këshillimor dhe autoritetet e autorizuar si pjesë e procesit të shqyrtimit të lejes për ujë (2010)

MT3	Reduktimi i ndotjes së tokës	Zbatimi i CGAP gjithashtu do të mbulojnë çështjet e mirëmbajtjes së tokës dhe përdorimin agro-kimik
MT4	Sigurimi i disponueshmerisë së të dhënave të menaxhimit të tokës	

Në arritjen e këtyre qëllimeve, ka edhe një numër masash që referohen në Strategji në seksionet e tjera. Në mënyrë të veçantë masat në lidhje me cilësinë e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve që duhet të ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së tokës. Lidhja midis mbrojtjes së tokës dhe menaxhimit të burimeve ujore është më direkte, në mënyrë të veçantë në lidhje me praktikën e ujitjes. Në një afat të gjatë kohor, nevojat për ujitje duhet të balancohen me objektivat e vendosura për Planin e Menaxhimit të Shtretërve të Lumenjve.

Në veçanti këto plane do të duhet të rregullojnë:

- Prerjen ilegale të pemëve për qëllime tregtie – kjo do të bëhet e mundur përmes mbikëqyrjes dhe forcimit të teknikave siç përshkruhen në ato në lidhje me gjuetinë ilegale.
- Prerja e drunjve për zjarr – kjo praktike duhet të minimizohet. Plani duhet të identifikojë burime të tjera alternative që të mund të ndihmojë autoritetet lokale për ta ndaluar këtë praktikë.
- Duhet të identifikohen në plan projektet për të stabilizuar rrëshqitjet e dheut dhe projekte për ri-mbjellje – kjo do të mundësohet përmes një procesi të shpejtë që është i përfshirë tek Fondi i Mjedisit

Në tokat e ulëta bujqësore duhet të futet dhe të promovohet praktika e Kodit të Bujqësisë së Mirë, me qëllim zvogëlimin e erozionit.

d) Cilësia e Ajrit

Përmirësimi i cilësisë së ajrit në mbarë Shqipërinë në përputhje me nivelet e standardeve të BE dhe OBSH.

Objektivi i përgjithshëm është përmirësimi i cilësisë së ajrit, në mënyrë të veçantë në zonat urbane dhe përreth zonave industriale me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik, përputhjen me direktivat e BE dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të njohura në lidhje me cilësinë e ajrit dhe kontrollin e çlirimit të gazeve. Çështjet dhe tendencat kryesore që duhen adresuar për të arritur këto objektiva janë:

- Shkarkimi i gazeve i lidhur me transportin varet nga një numër faktorësh: lloji i karburantit që përdoret nga automjetet private/tregtare, numri i automjeteve, kilometrat e përshkuar, vjetërsia dhe lloji i motorit, mirëmbajtja dhe cilësia e tyre si dhe nga alternativat e transportit. Përveç automjeteve mund të shtojmë cilësinë e rrugëve që kontribuon në rritjen e sasisë së grimcave të pluhurit si dhe ato të automjeteve. Numri i automjeteve është rritur shumë gjatë këtyre 10 vjetëve dhe do rritet edhe më tej me rritjen ekonomike.
- Grimcat e pluhurit nga aktiviteti i ndërtimit dhe nga rrugët e pashtruara. Të dyja si ndërtimi edhe transporti priten të rriten me rritjen ekonomike.
- Shkarkimi i gazeve nga industria në përgjithësi ka rënë pasi pjesa më e madhe e industrive janë mbyllur, çlirimi i gazeve do mund të rritet përsëri me rritjen e ekonomisë, prodhimit industrial, dhe kërkesave për energji.
- Shkarkimi i gazeve rritet edhe si pasojë e djegieve të mbeturinave dhe përdorimit të djegësve për qëllime shtëpiake. Gjithashtu ka mungesë informacioni mbi cilësinë e ajrit gjë e cila duhet të rregullohet me rritjen e monitorimit.

Përfitimet nga aktiviteti për të kontrolluar ndotjen e ajrit përfshin në mënyrë të veçantë reduktimin e rreziqeve për shëndetin publik nëpërmjet përputhjes së niveleve të çlirimit të gazeve me parametrat e direktivave dhe standardeve të BE.

Implementimi i plotë i legjislacionit të BE në këtë fushë nuk është e mundur brenda një kohe të shkurtër. Strategjia e adoptuar këtu ka për qëllim:

- Uljen e nivelit të çlirimit të gazeve nga burimet lëvizëse dhe ato fikse në nivelin e legjislacionit të BE.
- Përmirësimin e monitorimit për të siguruar informacion për të lehtësuar planet e menaxhimit të cilësisë së ajrit.
- Vendosjen e sistemit të planifikimit për menaxhimin e cilësisë së ajrit i cili do të përcaktojë dhe të verë në zbatim masat e nevojshme për të arritur standardet e cilësisë së ajrit.

Janë identifikuar pesë objektiva të përkohshme si të nevojshme për të arritur këtë objektivë të përgjithshëm. Për secilin prej tyre janë identifikuar një numër masash. Indikatorin kryesor të efektivitetit të këtyre synimeve do të jetë përmirësimi i cilësisë së ajrit i vlerësuar mbi bazën e rrjetit të monitorimeve.

Tabela 3.3.1- d/1 Cilësia e Ajrit		
Masa	Përshkrimi	Masat kryesore përparësore publike
CA1	Monitorimi i cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e KE-së	Monitorimin e ajrit në të gjitha zonat urbane dhe industriale brenda 2014;
CA 2	Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga automjetet me motor	Rregulloret e reja të karburantit të përdorur ne makina dhe marketingu; masa fiskale për të inkurajuar automjete të reja, zhvillimin e transportit publik, përmirësimin e menaxhimit të trafikut, ulja e kërkesës së transportit
CA 3	Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve nga instalimet industriale	Të rishikohen lejet e industrive të mëdha në lidhje me shkarkimet; negociata për reduktimin e emetimit duke zbatuar plotësisht dispozitat e Direktivës IPPC (96/61/EEC)
CA 4	Kontrolli dhe reduktimi i emetimeve te pluhurit nga ndërtimet	Kontrollin dhe monitorimin e pluhurit, zhvillimin e një kodi të praktikave për industrinë e ndërtimit
CA 5	Reduktimi i emetimeve të pluhurit nga burime të tjera duke përfshirë rrugët e pa asfaltuara, godinave jo industriale dhe zjarret e hapura	Plani për përmirësimin e infrastrukturës rrugore janë mbështetëse, përmirësimi i izolimit të ndërtesave, masat për efijencën e energjisë

Nivelet shqiptare kombëtare për disa nga ndotësit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabele 3.3.1 - d/2 Nivelet normale Kombëtare të elementeve të cilësisë së ajrit		
Parametrat mjedisore	Elementet	Niveli normal kombëtar (µg/m³)
Cilësia e Ajrit	pluhur	140
	PM ₁₀	70
	SO ₂	60
	NO ₂	60
	Ozoni	120
	Pb	1

e) Ndryshimet Klimaterike

Reduktimi i gazeve të efektit serë dhe ato të hollimit të shtresës së Ozonit duke kontribuar në parandalimin e ndryshimeve klimaterike

Shkarkimi i gazeve të efektit serë ndodh si rezultat i disa aktiviteteve. Mjeti më i fuqishëm për reduktimin e këtij efekti mbetet reduktimi i shkarkimeve të këtyre gazeve, për këtë arsye duhet adresuar problemi i reduktimit të shkarkimeve duke e integruar objektivat dhe procesin e vendimmarrjes në një numër nivelesh:

- Qeverisje – në mënyrë të veçantë në strategjitë për energjinë, ekonominë dhe transportet për të përfshirë hapa për kufizimin e shkarkimeve.
- Industri dhe tregti – të inkurajohen për të qenë efektive në energji dhe në reduktimin e shkarkimeve.
- Individët- të inkurajohen për ta konsideruar si kriter në veprimet dhe blerjet e tyre çështjen e efektivitetit të energjisë.

Masat që duhen të ndërmerren do të duhet të shoqërohen nga instrumente ekonomike nëse janë efektive. Në mënyrë të veçantë janë të specifikuar masat e mëposhtme:

- Futja e taksës së Karbonit, të ardhurat e së cilës do të futen në Fondin e Mjedisit
- Fushata të vazhdueshme për reduktimin e numrit të lidhjeve të paautorizuara në rrjetin elektrik (nëse konsumatori nuk paguajnë atëherë nuk mund të ketë stimuj për reduktimin e përdorimit të energjisë).
- Zhvillimi dhe publikimi i Strategjisë afatgjate të Çmimeve të Energjisë, duke treguar tendencën e çmimeve të energjisë në një afat të mesëm- kjo do të publikohet që konsumatorët të kuptojnë përfitimet e investimeve në pajisje dhe në aktivitete duke hequr subvencionimet që ekzistojnë midis sektorëve shtëpiakë dhe jo shtëpiakë
- Fondi i Efiçencës Energjetike- ky do të jetë një grant program i një madhësi të vogël e të mesme që do të përdorë të ardhurat nga Taksa e Karbonit tek projektet e Fondit të Mjedisit- nga këshillat e Qendrës për Efiçencë në Energji.
- Ka një mori masash specifike, si ato për të specifikuar kufizimin në ambient të ndotjes së ajrit, që do të kontribuojnë në objektivin për reduktimin e emetimeve të gazeve. Këto janë masat që iu referuam më

sipër:

Tabela 3.3.1- e Ndryshimi i Klimës	
Masa	Përshkrimi
NK1	Minimizimi i emetimeve të gazeve të efektit serrë
NK2	Menaxhimi dhe reduktimi i emetimeve të substancave të shtresës së ozonit në përputhje me dispozitat e Konventës së Vjenës dhe instrumentet e lidhur me të

f) Menaxhimi mbetjeve

Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve aq sa të reduktohen rreziqet për shëndetin publik, mjedisin, dhe tregtinë në përputhje me kërkesat e BE.

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri është në një nivel të ulët. Pavarësisht se prodhimet e mbetjeve janë nën nivelin mesatar, sistemet e grumbullimit dhe të depozitimit janë të varfër dhe për këtë arsye niveli i dëmit në mjedis është relativisht i lartë. Niveli i riciklimit aktual është shumë i ulët.

Duke pasur si qëllim arritjen e nivelit të standardeve të BE dhe punën që nevojitet, planifikimi i procesit është ndarë në dy faza. **Faza e parë** kërkon përgatitjen e një plani lokal dhe rajonal për të adresuar nevojat afatshkurtër dhe afatmesëm. Përputhja e plotë me legjislacionin e BE nuk do mund të arrihet në fazën e parë. Faza e parë do të sigurojë të dhënat e nevojshme dhe informacionin për **fazën e dytë** që do të fillojë me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Ky Plan do të do të ngrejë kuadrin për një përtëritje të planeve lokale dhe rajonale.

Në tabelën e mëposhtme janë objektivat që janë përmbushur pjesërisht:

Tabela 3.3.1 -f Objektivat Kombëtare në Menaxhimin e Mbeturinave		
Masat	Përshkrimi	Masat kryesore përparësore publike
MM1	Përcaktimi i praktikave më të mira për menaxhimin e mbeturinave në periudhën afatmesme	Udhëzime për përgatitjen e planeve të menaxhimit të mbeturinave nga autoritetet lokale dhe rajonale dhe në standardet që do të aplikohen në përgatitjen e projekteve për menaxhimin e mbeturinave
MM2	Sistemi i planifikimit për menaxhimin e mbeturinave në vend në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar	Vendosja i një legjislacioni të një sistemi të planifikimit të menaxhimit të mbeturinave lokale; Përgatitje e menaxhimit të mbeturinave lokale, rajonale, kombëtare duke përfshirë edhe identifikimin e investimeve përparësore në mbledhjen, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave të ngurta bashkiake në përputhje me udhëzimin e përmendur në MM 1
MM3	Zbatimi i projekteve përparësore për menaxhimin e mbeturinave – Faza I	Marrja e fondeve dhe zbatimi i projekteve përparësore mjedisore të investimeve për projektet e vendgrumbullimit të mbeturinave në Elbasan, Shkodër, Laç, Ballsh, Vlora, Saranda dhe Tirane – Durrës Marrja e fondeve dhe zbatimi i projekteve përparësore mjedisore të investimeve për projektet e riciklimit të mbeturinave – Faza I
MM4	Zbatimi i projekteve përparësore për menaxhimin e mbeturinave Faza II dhe III	Marrja e fondeve dhe zbatimi i projekteve përparësore mjedisore të investimeve për projektet e vend grumbullimit të mbeturinave- Faza II
MM5	Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme	Studimi i fizibilitetit dhe projekti i dizenjimit për krijimin, kontrollin e objekteve në Fier, Vlorë, Elbasan, Durrës dhe Laç dhe menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme dhe zbatimi i fazës së parë të rregulloreve të reja; Plani kombëtar i menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme.
MM6	Plotësimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e mbeturinave	Ligji i Menaxhimit të Mbeturinave 2011
MM7	Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e mbeturinave në mënyrë që të nxisë sjellje të përgjegjshme	Fushata për të nxitur përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave – faza e parë -2011-12

g) Ndotja Akustike

Kontrolli i niveleve të zhurmës për sigurinë e popullatës nga to

Nivelet e zhurmës janë të përfshira tek indikatorët që ndiqen nga Programi Kombëtar i Monitorimit (Vendimi No.103, datë 31/03/2003). Niveli i zhurmave është monitoruar dhe rezulton në përgjithësi nën nivelin që mund të dëmtojë shëndetin. Sidoqoftë, gjatë ditës në shumë qytete pragu normal tejkalohet, ndërsa gjatë natës në përgjithësi është poshtë këtij pragu, me përjashtim të Tiranës.

Niveli i zhurmave në ndërtesa është në përputhje me cilësitë strukturore të tyre. Ulja dhe reduktimi i zhurmave nuk janë objekt i projektimit në ndërtesat tona. Deri më sot shumë pak është bërë për të adresuar çështjet e lidhura me nivelin e zhurmave. Standardet e zhurmave nuk janë vendosur për një aktivitet apo pajisje specifike, me përjashtim të aviacionit.

Duke qenë se nivelet aktuale të zhurmave nuk janë aq akute për shëndetin publik si faktorët e tjerë, kjo çështje nuk është konsideruar si përparësore në një periudhë afatshkurtër. Pavarësisht, hapave për të kontrolluar zhurmat që do të ndërmerren në të ardhmen si në rastin e automjeteve që kalojnë në rrugë, si pjesë e masave për cilësinë e ajrit.

Sistemet dhe legjislacioni për të kontrolluar zhurmat nga burimet, janë të nevojshme për tu adresuar për një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme. Përpara se legjislacioni të implementohet, janë të nevojshme kapacitetet administrative në vend.

Në një periudhë afatshkurtër, do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Hartimi i Aktit "Mbi Nivelet e pranueshmërisë të zhurmave urbane"(të shkaktuara nga automjetet, motorët apo trenat)
- Vazhdimi i monitorimit të qyteteve që do kryhet nga institucionet kombëtare
- Punësimi i një specialisti shtesë për zhurmat

Në një afat të mesëm kohor, prioritet për këtë nën sektor janë:

- Hartimi i një Draft Ligji "Mbi Menaxhimin dhe Vlerësimin e Zhurmave"
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Drejtorisë përkatëse
- Te caktohen autoritetet kompetente për zhurmat dhe automjetet

Në një afat më të gjatë, do të merren masat për të bërë përshtatjen e plotë të legjislacionit të BE në fushën e menaxhimit të zhurmave.

Legjislacioni për zhurmat duhet të adresohet për:

- Niveleve zanore te shkarkimit të motorëve të automjeteve dhe sistemeve.
- Sistemet teknike te inspektimit për kontrollin e zhurmave nga automjetet e rrugëve duke përfshirë mjetet dhe metodat e testimeve për inspektimin e rrugëve – kjo do të përfshihet me masat e vendosura në objektivat për testimin e automjeteve për ndotjen e ajrit, CA2.
- Integrimi i konsideratave për zhurmat në pozicionin dhe vendosjen e rrugëve duke përfshirë edhe masat për reduktimin e tyre.
- Kufizimin e zhurmave prej pajisjeve te vendosura jashtë.
- Implementimi i masave për kontrollin e zhurmave nga pajisjet e jashtme duke përfshirë këtu monitorimin dhe regjimet e përforcuara.
- Zhurmat nga pajisjet shtëpiake

Në elementet kyç të njohjes dhe që duhen adresuar përfshihen:

- Direktiva 2000/14/EC e PE dhe e Këshillit, amenduar nga Direktiva 2005/88/EC, që përcakton kufirin e zhurmave edhe etiketimin e një numri pajisjesh për përdorim të jashtëm.
- Avioni Subsonik- 80/51/EEC, avionë Jet Subsonik- 89/629/EEC, Kufizimet operative të avionëve - 92/14/EEC, Kufizimet operative në aeroportet komunitare-2002/30/EC, Direktiva 2002/49/ EC mbi zhurmat në mjedis.
- Direktiva 1986/594 mbi zhurmat në ajër të pajisjeve shtëpiake.

Objektivat e ndotjes e akustike për mjedisin e qytetit dhe brenda kapacitet të zbatuar të administratës te qytetit mund të përmbliidhen në sa vijon:

- NA- Reduktimi i ndotjes nga zhurmat ne ndërtimin e ndërtesave
- NA - Reduktimi i ndotjes nga zhurmat nga automjetet me motor
- NA - Reduktimi i ndotjes nga zhurmat nga aktivitetet e biznesit

3.2 Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar

a. Politikat Ndërkombëtare

Shqipëria, duke qenë se është anëtare e organizatave ndërkombëtare dhe merr pjesë në konferenca shumëpalëshe, ajo vepron me synimin për të përmirësuar në nivel lokal e rajonal zhvillimin e mjedisit si dhe gjendjen e mjedisit në nivel global. Objektivat kryesore që Shqipëria kërkon të arrijë në këtë nivel janë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), të pranuar nga përfaqësuesit e 189 vendeve në Konferencën e OKB-së vitit 2000, dhe detyrave të përcaktuara në Samitin Botëror të vitit 2002 për Zhvillimin e Qëndrueshëm (WSSD) në Johaneshburg.

Tetë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, për t'u arritur me 2015, përbëjnë sfidat më të mëdha që ka bota sot. Ato janë:

1. Reduktimi i urisë dhe varfërisë ekstreme;
2. Mundësit për të gjithë fëmijët për arsimin fillor;
3. Mbështetje të barazisë gjinore dhe emancipimin e femrës;
4. Reduktimin e përqindjes së vdekshmërisë të fëmijëve;
5. Reduktimi i përqindjes së vdekshmërisë në lindje;
6. Luftimin e HIV / AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera;
7. Sigurimin e një mjedisi të qëndrueshëm; dhe
8. Krijimin e një rrjeti të partneritetit global për zhvillimin.

Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Johaneshburg, 2002) ishte kulmi i një serie konferencash, duke përfshirë dhe Konferencën e Stokholmit mbi Mjedisin në vitin 1972 dhe Konferencën e Rio mbi Mjedisin dhe Zhvillimin në vitin 1992 - i cili paraqiti parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Angazhimi i parë ngriti shqetësimin e kanalizimeve, ku u vendos të merren masa për të siguruar që deri në vitin 2015 kjo mungesë e rëndësishme të reduktohet deri në 50% të niveleve aktuale. Angazhimi i dytë ishte që të ndërmerreshin masa për të rritur rezervat e peshkut në oqeanë deri në vitin 2015, ndërsa një rrjet global për mbrojtjen e zonave bregdetare duhet të jetë ngritur tre vjet më parë. Nuk janë bere vendime të detyrueshme, megjithatë për pjesën tjetër të çështjeve (demografike, varfërisë, mbishfrytëzimit të burimeve, të klimës, shpyllëzimi, ozonit, ujit, specieve të rrezikuara, erozionit të tokës dhe pakësimit të pasurive detare).

b. Politikat në nivel Evropian

Politika mjedisore e BE-së udhëhiqet nga parimi i parandalimit dhe parimi "ndotësi paguan", duke siguruar shumë instrumente institucionale, financiare dhe menaxheriale për të siguruar zbatimin efektiv të tyre. Pjesëmarrja qytetare është gjithashtu një element kyç dhe një prioritet i kësaj politike.

Plan i Veprimit Mjedisore 6-të, adaptuar nga Vendimi 1600/2002/EC të Parlamentit Evropian, Këshilli i Evropës së 22 Korrikut 2002, është korniza bazë e politikave mjedisore në UE. Katër prioritetet deri më 2012 janë:

- Adresimin e ndryshimeve klimatike;
- Mbrojtjen dhe rruajtjen e mjedisit natyror dhe biodiversitetit;
- Integrimin e mbrojtjes mjedisore dhe shëndetit publik;
- Përdorim i qëndrueshëm të pasurive natyrore, nëpërmjet zërthimit të formës së përdorimit të tyre në rritjen ekonomike dhe parandalimin e shtimit të mbetjeve.

Sipas Marrëveshjes së Planit të Veprimit Mjedisor 6-të, Këshilli i Evropës është mbledhur për të përgatitur shtatë tematika strategjike, në mënyrë që të specifikojë objektivat dhe mjete e zbatimit në çdo zonë përparësore; këto strategji prezantojnë në mënyrë esenciale gjeneratën e re të politikës mjedisore në Evrope.

1. Strategjia për ndotjen e ajrit vendos objektivat afat gjatë, duke synuar të reduktojë me 2020 (nivelin e vitit 2000):

- Me 47% zvogëlimin normës së jetëgjatësisë influencuar nga ekspozimi ndaj grimcave;
- Me 10% rastet e vdekshmërisë akute nga efekti i ozonit;
- Përqendrimin e depozitimit të acidit me 74% në zonat pyjore dhe me 39% në ujërat sipërfaqësore;
- Me 43% zonat e ekosistemeve ku shfaqet eutrofikimi

→ Realizimi i këtyre objektivave kërkon një reduktim të shkarkimeve të SO₂ me 82%, NO_x (oksidit të nitrogenit) me 60%, VOCs (komponenteve organik volatile) me 51%, amonit me 27% dhe PM_{2,5} fillestar (grimce e shkarkuar direkt në ajër) me 59%, krahasuar me normat e vitit 2000.

2. Strategjia për parandalimin e mbeturinave dhe riciklimin synon të reduktojë impaktin negativ mjedisor të mbetjeve gjatë të gjithë ciklit të jetës së tyre, nga prodhimi në depozitimin e tyre përfundimtar, nëpërmjet riciklimit. Kjo qasje lejon trajtimin e çdo lloj mbeturine jo vetëm si një burim i ndotjes e cila duhet të

reduktohet, por edhe si një burim potencial i mundshëm për shfrytëzim. Objektivat e Komunitetit Evropian (vendosur përpara miratimit të kësaj strategjie) për zvogëlimin e mbeturinave, promovimin, ripërdorimin dhe riciklimin, janë ende të vlefshme. Një theks i veçantë i është kushtuar mbeturinave bio-degraduese, dy të tretat e të cilave duhet t'i nënshtrohen formave të tjera të trajtimit, të tjera nga depozitimi, në përputhje me Direktivën 1999/31/EC. Strategjia parashikon veçanërisht dhënien e udhëzimeve përkatëse nga Komisioni, adaptimin e strategjive të menaxhimit nga ana e shteteve anëtare dhe përfshirjen e kësaj çështjeje në rishikimin e Direktivës IPPC dhe Direktivës për përdorimin e llumrave të ujërave të zeza në bujqësi.

3. Strategjia për mbrojtjen dhe konservimin e ambientit detar është përshkruar në Direktivën 2008/56/EC. Direktiva përcakton objektiva të përbashkëta mbi bazën e të cilave shtetet anëtare duhet të formulojnë strategjitë e tyre në bashkëpunim me shtetet e tjera anëtare dhe vendeve të treta, në mënyrë që të arrijnë një status të mirë ekologjik në ujërat detare nën juridiksionin e tyre. Për të arritur këto objektiva, shtetet anëtare duhet të bëjnë një vlerësim të gjendjes ekologjike të ujërave detare dhe ndikimin e veprimtarive njerëzore, duke përfshirë:

- Analizimin e karakteristikave bazë të ujit (karakteristikat natyrore dhe kimike, tipet e habitateve, specie e faunës dhe florës, etj);
 - Analizimin e impaktit të aktivitetit njerëzor në karakteristikat e ujit (ndotjen nga produktet toksike, eutrofikimin, fragmentimin e habitateve, shkaktuar nga ndërtimi, futjen e specieve të reja, dëmtimet e shkaktuara nga ankorimi i anijeve, etj);
 - Analizat ekonomike dhe sociale të ujit të përdoruar, dhe analiza e kostos së degradimit të mjedisit detar.
- Në bazë të këtij vlerësimi, shtetet anëtare duhet të identifikojnë "status të mirë ekologjik" të ujërave detare (p.sh duke marrë në konsideratë shumëllojshmërinë biologjike, praninë e llojeve jo-autoktone, statusin shëndetësor të rezervave, eutrofikimin, përqendrimet e ndotësve, etj) dhe të vendosin objektivat dhe treguesit për të arritur këtë status. Këto objektiva duhet të jenë të matshme, dhe të shoqërohen nga afate të zbatimit, pastaj duhet të formulohet një program i masave konkrete për të arritur këto objektiva, duke marrë veçanërisht parasysh ndikimet socio-ekonomike të çdo mase të propozuar (nëpërmjet studimeve, VNM dhe me analizë kosto / përfitim).

4. Strategjia për mbrojtjen e tokës vlerëson rëndësinë e ruajtjes së kualitetit të tokës dhe funksionet ekologjike të saj si një faktor kyç për të luftuar ndryshimin e klimës dhe për të parandaluar fenomenet e shkretëtirës që paraqesin një kërcënim të rëndë në të gjitha vendet e Mesdheut. Në këtë kontekst, strategjia e BE-së për mbrojtjen e tokës synon të parandalojë korrozionin, degradimin, ndotjen dhe shkretëtirëzimin. Kërcënimet kryesore të identifikuar janë:

- Erozioni, i cili shkaktohet nga një kombinim i faktorëve të tillë si shpatet e pjerrëta, klima, përdorimi i papërshtatshëm i tokës, llojet e bimësisë dhe katastrofat ekologjike;
- Reduktimi i materialit organik, për shkak të praktikave bujqësore dhe pyjore;
- Ndotja, nga lokalizimi (p.sh. minierat, venddepozitimet e mbetjeve, industria, etj) dhe efektet (depozitimet atmosferike, të praktikave bujqësore, të riciklimit të papërshtatshme dhe trajtimin e ujit dhe ujërave të zeza, etj);
- Përdorimi i tokës, p.sh. toka për qëllime banimi, rrugë dhe aktivitete të tjera njerëzore të përcaktuara në kuadrin e planifikimit hapësinor;
- Kompaktësia e tokës, dmth presionin mekanik ushtruar në tokë nga trafiku i rëndë, mbi kullotja si dhe formave të caktuara të turizmit (të tilla si ski);
- Ulja e biodiversitetit të tokës, e shkaktuar nga ulja e materies organike dhe përdorimi i disa praktikave bujqësore (të tilla si përdorim i gjerë i pesticideve);
- Kripëzimi, i cili është zakonisht i lidhur me praktikën e ujitjes dhe përbën një shkak të rëndësishëm për shkretëtirëzimin;
- Përmbytjet dhe rrëshqitjet, të shoqëruara direkt me pedologjinë dhe menaxhimin e tokës.

Sipas tematikave të strategjisë, mbrojtja efektive e dherave si një koncept i integruar dhe një rregullim dhe përmirësim i politikave aktuale. Në këtë kontekst, veprime për të adresuar rreziqet duhet të përfshijë:

- zhvillimin e një politike të përshtatshme mjedisore nëpërmjet zbatimit të Direktivave të UE (Direktivat për ndotjen nga Nitratet, Ujin, depozitimn e mbetjeve Spitalore, Mbrojtjen nga zjarret të pyjeve, etj);
- Zbatimin e një plani të qëndrueshëm territorial dhe praktikash të menaxhimit të tokës, sugjerimin në se është e nevojshme kufizimi i përdorimit të tokës;
- Politika të Përbashkëta Bujqësore (PPB), të cilat të sigurojnë mundësi për të përdorur praktika të qëndrueshme siç janë mbjelljet organike, mirëmbajtja e tarracave, menaxhimi i integruar i kulturave, etj;
- Monitorimin e gjendjes së tokës dhe vlerësimin e faktorëve që formojnë rrezikshmërinë më të madhe për degradimin e dherave.

5. Strategjia në përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve krijuar në kuadër të strategjisë për mbrojtjen e tokës dhe ndjekja një politike koherente në përdorimin e pesticideve, duke ndihmuar në:

- Minimizimin e rrezikut shëndetësor dhe mjedisor nga përdorimi i pesticideve;
- Përmirëson kontrollin në përdorimin dhe shpërndarjen e pesticideve;
- Redukton sasinë e dëmeve të substancave të rrezikshme, veçanërisht me zëvendësimin e me të rrezikshmeve me alternativa ma ta sigurta;
- Inkurajon praktikat fermere me pak ose aspak përdorim pesticidesh;
- Realizon një sistem transparent për raportim dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së objektivave strategjike.

6. Strategjia për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve, synon të promovojë një përdorim më efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre. Objektivi kryesor është për të zbutur ndikimin mjedisor të përdorimit të burimeve natyrore (mbarimi i burimeve dhe ndotja), pa kompromentuar objektivat e strategjisë së Lisbonës për zhvillimin ekonomik dhe punësimin. Për këtë qëllim, strategjia synon të përmirësojë efikasitetin e burimeve, zbutjen e ndikimeve mjedisore të lidhura me të dhe të zëvendësojë ndotësit e rëndë të burime me alternativa të tjera por edhe propozon krijimin e një Qendre të Dhënash për burimet natyrore (të menaxhuara nga Komisioni), në mënyrë që të forcojnë njohuritë në lidhje me përdorimin e burimeve dhe ndikimin e tyre mjedisor dhe të lehtësojnë shkëmbimin dhe shpërndarjen e informacionit për hartuesit e politikave.

7. Strategjia për mjedisin urban, i cili është direkt i lidhur me qëllimin e Planit Lokal të Durrëss, ndihmon në kontributin për përmirësimet të përgjithshme të performancës mjedisore të një qyteti Evropian, nëpërmjet reduktimit të burokracisë, rritjen e eficiencës në zbatimin e politikave mjedisore dhe inkurajimin afat gjatë të planifikimit mjedisor. Duke pranuar që qytetet dhe planifikimet e përshtatshme të qyteteve kane një rol të rëndësishëm në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, zbutjen e lëshimit të gazeve serrë, ruajtjen e hapësirës sub-urbane dhe habitateve natyrore, përdorimi i mençur e burimeve natyrore, përmirësimin e shëndetit publik dhe cilësisë së jetës, etj, janë propozuar një sërë masash për të cilat Komuniteti duhet të ofrojë udhëzime,

- Menaxhim i Integruar i Mjedisit, duke u përqendruar në objektivat e përcaktuara qartë, pranimin e përgjegjësisë, procedurat për monitorimin e progresit, për

konsultimin publik, si dhe për rishikimin, auditimin dhe raportimin; rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe mbështetjen e shkëmbimit të praktikave më të mira në Evropë;

- Plane të qëndrueshme të transportit urban; zbatimi i gjerë i planeve të tilla, së bashku me masat specifike për nxitjen e energjisë-efikase tek automjetet me emetime të ulëta të CO₂, do të ndihmojë për të ulur emetimet e gazit serrë në nivel lokal, për më tepër, këto plane do të ndihmojë në uljen e ndotjes së ajrit dhe zhurmave duke inkurajuar përdorimin e biçikletave dhe ecjeve në këmbë, duke përmirësuar shëndetin dhe reduktuar shëndoshjen e tepërt;
- Ndërtimin e metodave të qëndrueshme - bioklimatike, për të përmirësuar efikasitetin e energjisë dhe për të zvogëluar emetimet e CO₂, nxitjen e komoditetit, sigurinë, aksesibilitetin dhe për të zvogëluar ndikimin në shëndet të ajrit të ndotur brenda dhe jashtë ndërtesave (sidomos nga grimcat e emetuara nga sistemet e ngrohjes);
- Zhvillim urban të qëndrueshëm dhe planifikim i përdorimit të tokës; parandalimi i shtrirjes urbane (dmth nëpërmjet densitetit të lartë dhe ndërtesave të përdorimit të përziera në zonat urbane), ofron një sërë avantazhesh mjedisore si një faktor kyç për mbrojtjen e habitatit natyral dhe biodiversitetin (ruajtjen e zonave sub-urbane) dhe për mbrojtjen e tokës (reduktimin e kripëzimit), si dhe kontribuon në përdorimin në mënyrë të konsiderueshme më pak të burimeve natyrore për banor (në aspektin e rrjeteve të infrastrukturës, ofrimin e shërbimeve, transportit, ngrohjes, etj);
- Menaxhimi i përgjithshëm urban dhe masat politike mjedisore, duke përfshire ruajtjen dhe nxitjen e biodiversitetit urban, zbutjen e efekteve të energjisë dhe konsumin e ujit, promovimin e një skeme masash paraprake për mbetjet lokale.

Pavarësisht nga politikat dhe masat e marra në Planin e 6 të Veprimit të Mjedisit, për mbrojtjen mjedisore dhe politikat për zhvillimin e qëndrueshëm të UE-së, të cilat janë promovuar nëpërmjet një serie tematikash strategjike dhe dokumentesh. Dokumenti i cili ndikon direkt në qëllimin e vlerësimeve aktuale janë përshkruar shkurtimisht më poshtë

Politikat e BE për ndryshimet klimatike synojnë stabilizimin e përqendrimeve të gazeve të efektit serë në atmosferë në nivele që do të parandalojnë ndikimet e rrezikshme humane në sistemet klimatike; rritja e temperaturës mesatare së përgjithshme vjetore të tokës nuk duhet të kalojë 2 ° C, krahasuar me nivelet para-industrisë. Kjo politikë është përshkruar si politika **20 - 20 - 20**, meqenëse ajo në të njëjtën kohë synon:

- Reduktimin e gazit të efektit serrë në të paktën 20% në vitin 2020 në nivelin e vitit 1990;

- Në vitin 2020 20% e energjisë së BE duhet të vijë nga burime të rinovueshme të energjisë;
- Reduktimin e energjisë primare me 20% në vitin 2020 krahasuar me nivelin e projekteve, (nëpërmjet përmirësimit të eficiencës së energjisë).

Strategjia e BE për biodiversitetin vendos një sërë objektivash të cilat mund të arritjen nëpërmjet një numri politikash sektoriale dhe aktiviteteve. Objektivat e strategjive për sektor / tipet e aktiviteteve janë:

- **Rruajtja e burimeve natyrore:** Krijimi dhe funksionimi i rrjetit “Natura 2000”; mbrojtjen e disa specieve në rrezik zhdukjeje; aplikimin e instrumenteve ligjore siç është Model Direktiva për Ujin (2000/60/EC); trajtimin e ndryshimeve klimatike;
- **Bujqësia:** mirë ruajtjen e burimeve gjenetike me vlerë të lartë ushqyese; promovimin e praktikave të mira bujqësore që kontribuojnë në ruajtjen e shumëllojshmërisë gjenetike dhe uljen e ndotjes (arritjen e disa kritereve gjenetike të caktuara ekologjike është vendosur si kusht për dhënien e subvencioneve bujqësore); forcimin e masave agro-mjedisore; nxitjen e politikave tregtare të cilat janë në përputhje me mbrojtjen e biodiversitetit;
- **Peshkimi:** praktika promovuese që lehtësojnë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të sasisë së peshkut dhe që kanë një impakt të kufizuar në ekosistemet marine dhe bregdetare; një rritje të mbrojtjes së trupave ujore të një rëndësie të veçantë ekologjike;
- **Politikat rajonale dhe planifikimi hapësinor:** promovimin e masave planifikuese të cilat mund të kontribuojnë në mbrojtjen e biodiversitetit, në veçanti në korridoret midis zonave të mbrojtura, në zonat rurale dhe në zonat e ndjeshme të pa mbrojtura, duke marrë parasysh konsideratat mjedisore për projektet e financimit nga Fondet Strukturore;
- **Pyjet:** siguron që menaxhimi i pyjeve nuk do të ndikojë në biodiversitetin ose cilësinë ekologjike të pyjeve; marrjen e masave për ripyllëzim, nxitjen e hulumtimeve dhe vlerësimit të ndikimit;
- **Energjia dhe Transporti:** Marrjen e masave kundër acidifikimit dhe ndryshimit të klimës, zvogëlimin e ndikimeve negative të zhvillimit të infrastrukturës, kërkimi i burimeve të përshtatshme të energjisë;
- **Turizmi:** promovimin e turizmit të qëndrueshëm, përcaktimin e poleve për tërheqjen turistike që lidhet me mjedisin dhe biodiversitetin;
- **Zhvillimi i ndihmës dhe bashkëpunimit ekonomik:** integrimin e objektivave të biodiversitetit në mekanizma të ndihmës për zhvillim dhe bashkëpunimit ekonomik, duke mbështetur përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në vendet në zhvillim, duke siguruar koordinimin dhe plotësimin e masave të marra

në nivel kombëtar (duke përfshirë edhe vendet e treta), BE dhe nivelet ndërkombëtare.

Strategjia e BE për zhvillimin e qëndrueshëm u miratua fillimisht në Këshillin Evropian të Goteborgut në vitin 2001 dhe është rishikuar në vitin 2005, plotësuar nga parimi i integritimit të dimensionit mjedisor në të gjitha politikat e BE-së. Strategjia e rishikuar përmban katër objektiva kryesore:

1. Mbrojtjen Mjedisore;
2. Drejtësi sociale dhe ndërveprim;
3. Prosperitet ekonomik;
4. Pranimin e përgjegjësive tona ndërkombëtare.

Paralelisht, shtatë sfidat kryesore janë evidentuar, për të cilat një seri objektivash respektive të përgjithshme, objektiva funksional dhe veprimesh janë propozuar:

- Ndryshimet klimatike dhe energji e pastër: Objektivi i përgjithshëm është për të zbutur ndryshimet klimatike dhe shpenzimet e lidhura me të, si dhe impaktet negative sociale dhe mjedisore.
- Transport të qëndrueshëm: Objektivi i përgjithshëm është që të sigurohet se sistemet e transportit plotësojnë nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të shoqërisë duke minimizuar ndikimet negative në shoqëri, ekonomi dhe mjedis.
- Konsum dhe prodhim të qëndrueshëm: objektivi i përgjithshëm është të promovojë metodat e një konsumi dhe prodhimi të përgjithshëm.
- Konservimi dhe menaxhimi i pasurive natyrore: Objektivi i përgjithshëm është të përmirësojë menaxhimin dhe të shmangë mbishfrytëzimin e burimeve natyrore, duke njohur vlerën e shërbimit të ekosistemit.
- Shëndeti publik: objektivi i përgjithshëm është promovimi i një shëndeti të mirë publik dhe përmirësimin e mbrojtjes ndaj rreziqeve të shëndetit.
- Përfshirja sociale, demografike dhe emigracioni: Objektivi i përgjithshëm është që të krijojë një shoqëri gjithëpërfshirëse shoqërore, duke marrë në konsideratë solidaritetin midis dhe ndërmjet brezave dhe sigurimin / përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve si parakusht për mirëqenie individuale të vazhdueshme.
- Varfëria globale dhe sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm: Objektivi i përgjithshëm është që të promovojë në mënyrë aktive në mbarë botën zhvillimin e qëndrueshëm dhe të sigurojë që politikat e brendshme dhe të jashtme të UE-në janë në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm global dhe angazhimet e saj ndërkombëtare.

Karta e Laipzigut për qytetet e qëndrueshme Evropiane, detyron shtetet anëtare të BE të përdorin konsultimin publik për integrimin e parimeve dhe strategjive të “zhvillimit të integruar urban” në politikat e zhvillimeve kombëtare, rajonale dhe ato lokale. Ajo ka nevojë për krijimin e qeverisjeve të vetëdijshme dhe marrjen e masave zbatuese për promovimin e organizimit të balancuar territorial të bazuar në një strukturë evropiane policentrike urbane. Parimet udhëzuese të Kartës së për zhvillimin e qëndrueshëm urban janë

- Promovimin e politikave "të zhvillimit të integruar urban":
 - Analizimi i situatës aktuale, përshkuan problemet dhe mundësitë;
 - Identifikon qëllimet e zhvillimeve aktuale për çdo zonë dhe i zhvillon ato në përputhje me vizionin e përgjithshëm të qytetit;
 - Koordinon planet teknike dhe politikat sektoriale duke siguruar kontributin e investimeve të planifikuara për të krijuar një zhvillim të balancuar për çdo zone;
 - Koordinon burimet publike dhe private dhe përqendrimin e tyre hapësinor;
 - Koordinon planin në nivel lokal dhe në nivel qyteti - rajoni;
 - Përfshirjen e shoqërisë civile dhe të partnerëve të tjerë të cilët mund të kontribuojnë ndjeshëm në formimin e ekonomisë së ardhme, në karakterin social, kulturore dhe mjedisor të çdo zone në procesin e planifikimit.
- Krijimin e një hapësire publike të një cilësie të lartë:
 - Prezantimin e “*Baukultur*” (një koncept ndërtimor i shoqëruar me estetikën dhe cilësinë), e cila i referohet rritjes së ndërveprimit të projektimit, arkitekturës dhe planifikimit të infrastrukturës urban, në mënyrë që të krijojë hapësira atraktive publike të orientuara drejt nevojave të përdoruesve për të arritur standarde të larta në lidhje me mjedisin e jetesës së qytetarëve.
- Modernizimi i rrjetit infrastrukturor dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë:
 - Nxitjen e qëndrueshmërisë, aksesueshmëri dhe përballueshmëri të transportit urban, menaxhimit të trafikut dhe të infrastrukturës për këmbësorët dhe përdoruesit e biçikletave, koordinon planifikimin e transportit me qendrat e punësimit, banesat, hapësirat publike dhe nevojat për mbrojtjen e mjedisit;
 -
 - Përmirësimin e infrastrukturës teknike, veçanërisht të rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; të përshtatura me nevojat në ndryshim, në mënyrë që të mbulojë kërkesat në rritje të standardeve të një jete më të mire.
 - Nxitjen e funksionimit efikas dhe përmirësimin e rrjeteve të shërbimeve dhe për të siguruar qëndrueshmërinë përmes përdorimit të kujdesshëm të burimeve të tyre natyrore dhe rritje të efikasitetit të energjisë në veçanti në ndërtesa, rinovimin e ndërtesave të pabanuara për të zvogëluar shpenzimet, si për bizneset ashtu dhe konsumatorët dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës.

- Nxit zhvillimin "kompakt" dhe të përzier përdorimi (strehimi, punësimi, arsimim, dhe shërbime argëtuese), nëpërmjet planifikimit të duhur urban dhe hapësinor që parandalon efektivisht kontrollin e shtrirjes së çrregullt urbane për zhvillim, duke trajtuar zhvillimet spekulative;
- Sigurimin e një jete cilësore dhe për të tërhequr bizneset nëpërmjet përdorimit të informacionit të avancuar dhe teknologjive të komunikimit në arsim, punësim, shërbime sociale, shëndetësi, sigurinë dhe mbrojtjen;
- Përshtatjen me kërcënimet e ndryshimeve të klimës; pajton zhvillimin urban me përdorimin e ulët të lëndëve djegëse fosile, përmirëson cilësinë e mjedisit dhe redukton shkarkimet nëpërmjet planifikimit të duhur dhe parashikimeve të reja, si dhe masave zbutëse.
- Prezantimin e politikave proaktive të risive dhe arsimit:
 - Mbështet arsimin dhe sistemet e trajnimit dhe organizatat sociale dhe kulturore; Siguroni mundësi për të mësuarit gjatë gjithë jetës, mbështet universitetet, institucioneve kërkimore dhe rrjetet shkencore ndërmjet industrive, bizneseve dhe komunitetit shkencor, përmes politikave të integruara të zhvillimit urban dhe qeverisjes së mirë.
- Fokusimin në zonat e privuara/degraduara në kontekstin e përgjithshëm të çdo situatë:
 - Zbatimi i strategjive për rritjen mjedisore;
 - Forcimin e ekonomisë lokale dhe punësimin;
 - Nxitjen e arsimimit proaktiv tek të rinjve dhe politikave të trajnimit;
 - Nxitjen për një transport publik efikas dhe të mjaftueshëm për përmbushjen e nevojave.

3.4 Përmbledhje e objektivave

Koordinimi i objektivave kombëtare/ndërkombëtare me ato të Planit lidhur me mjedisin është një nga momentet më të rëndësishme të VSM. Ky koordinim është konsideruar i lidhur ngushtë nga tre pozicione që janë të lidhura me mundësitë që ka dhe krijon Plani nga ana *financiare, burimeve njerëzore dhe zbatimit praktik*. Objektivat e VSM të paraqitura më sipër, janë ngushtësisht të lidhura në radhë *të parë* me mundësitë dhe perspektivat e Planit për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, për shëndetin publik dhe mjedisor. Nga ky këndvështrim Plani brenda problematikës së tij ia arrin qëllimit në masën më të madhe në rastin kur ai dhe VSM do të zbatohen plotësisht. Bashkia Korçë ka të ardhura të mira, gjë e cila siguron burime financiare duke krijuar mundësitë praktike. *Së dyti* këto objektiva janë ngritur bazuar në strategjinë dhe Objektivat për një Mjedis të qëndrueshëm në Shqipëri, strategji e cila është e lidhur ngushtë me politikat për integrimin në BE e për rrjedhojë në përputhje me objektivat ndërkombëtare të përshkruara më lart.

Bazuar në objektivat e mësipërme ndërkombëtare Plani dhe VSM e Korçës kanë prioritete dhe drejtime të rëndësishme të cilat provojnë të adresojnë probleme që sot janë nga më shqetësueset jo vetëm në Shqipëri por edhe në mjaft vende të tjera në botë siç është reduktimi i urisë dhe varfërisë ekstreme, mundësi për të gjithë fëmijët për arsimin fillor, mbështetje të barazisë gjinore dhe emancipimin e femrës, reduktimin e përqindjes së vdekshmërisë të fëmijëve, reduktimi i përqindjes së vdekshmërisë në lindje, sigurimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe krijimin e një rrjeti të partneritetit global.

Problematikën e reduktimit të varfërisë së skajshme dhe atë të urisë Plani mendon ta adresojë përmes komponentes së tij ekonomike ku krijimi i dhe rigjallërimi i zonave të reja ekonomike me një zhvillim të qëndrueshëm dhe qëndrim miqësor kundrejt mjedisit, do të mundësojë rritjen e të ardhurave gjë e cila do të sjellë një zbutje të këtij problemi për 5-10 vitet e ardhshme. Po ashtu duke qenë një vend kufitar do t'i krijojë mundësi të reja për një *“Partneritet Global për zhvillim”*. Krijimi i partneriteteve ndërkombëtare midis Korçës dhe qyteteve të tjera të ngjashme, por në nivelin më të përparuar (në aspektin e zhvillimit ekonomik, planifikimi mjedisor dhe atij urban), mund të ndihmojë Korçën për të marrë njohuri dhe përvojë në përpjekjet e saj për të ndjekur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Siç u përmend më lart, Shumica e Objektivave të Zhvillimit Kombëtar janë në përputhje me disa strategji të BE-së mbi ndryshimet Klimatike, në zhvillimin e biodiversitetit të qëndrueshëm dhe pak a shumë me shtatë objektivat e veçanta të tematikave strategjike të Planit të Veprimit Mjedisor 6 të BE-së edhe pse fillimisht me element të reduktuar të synuara duke ndjekur programet e mëposhtme. Kështu, përveç shtatë strategjive, të tjerat janë më rigorozë, si ajo e ndjekur për parandalimin e mbeturinave dhe riciklimin, (2), për mbrojtjen e tokës (4), për ujin e pijshëm dhe burimet e tjera ujore (3), cilësinë e ajrit në përshtatjen graduale (1) ndërsa të tjerët ende duhet të përfshihen praktikisht në studime kombëtar te planifikimit të mëtejshëm, siç është përdorimi i qëndrueshëm i pesticideve (5), metodat ndërtimore bioklimatike të qëndrueshme (7.3)

Përputhshmëri e objektivave jo gjithmonë është e mundur për shkak se niveli i zhvillimit është i ndryshëm në raport me vendet e BE dhe politikat e saj por sidoqoftë në ato raste kur kjo nuk është e mundur atëherë janë planifikuar dhe parashikuar aktivitete që e çojnë procesin afër nivelit të BE. Kështu ndërgjegjësimi i popullatës lidhur me problematikën e mjedisit kërkon një punë shumë here më të madhe se për vendet e BE për këtë qëllim janë menduar fushata, hartime programesh për shkollat e niveleve të ndryshme etj. Kjo qasje në fund të fundit është bashkëkohore dhe mjaft rezultateve sic e tregojnë edhe eksperiencat e vendeve të ngjashme me Shqipërinë.

Biodiversiteti

Shumëllojshmëria floristike dhe faunistike e Bashkisë Korçë është e lidhur me praninë e habitateve të shumta e në mënyrë të veçantë të pyllit dhe të fushës, por edhe me hapësirat e gjelbërta në brendësi të qytetit si parku Rinia, Shetro, apo edhe parku sportiv etj. Propozimi i VSM për të mbrojtur pyllin e Moravës me kategorinë e mbrojtjes së 5, në bazë të ligjit Nr. 8906, datë 6.6.2002 “PËR ZONAT E MBROJTURA” si “Peizazh i mbrojtur” është në përputhje të plotë me objektivat për shtimin e zonave të mbrojtura dhe e përforcon edhe më tej përputhshmërinë midis objektiveve kombëtare dhe ndërkombëtare me ato të Planit. Përfshirja e lumenjve në një program të mirëfilltë menaxhimi, i cili nuk do të ndikonte në dëmtimin e shumëllojshmërisë biologjike do të kontribuonte edhe më tej më plotësimin e këtij objekti të rëndësishëm.

Menaxhimi i Burimeve Ujore

Në Bashkinë e Korçës tashmë ka një menaxhim dhe shfrytëzim korrekt të burimeve ujore sidomos atij të ujit të pijshëm. Sidoqoftë VSM sugjeron krijimin e një zone sanitare në zonën pranë burimeve ujore të Bashkisë. Po ashtu edhe menaxhimi i ujerave të zeza është mjaft serioz megjithatë VSM sugjeron përmirësimin e mëtejshëm duke marrë në konsideratë edhe zhvillimet e reja ndërtimore që Plani parashikon. Gjithashtu udhëzimet e VSM që lidhen me përdorimin e pesticideve bëjnë të mundur mbrojtjen e ujerave nëntokësore të basenit ujëmbajtës të zonës.

Mbrojtja e Tokës

Në Bashkinë Korçë, ku përfshihet fusha e Korçës por edhe pylli i Moravës , të cilat janë të një rëndësie jetike për banorët dhe bujqësinë e kësaj bashkie, zbatimi i objektiveve kombëtare për tokën merr një rëndësi të veçantë. Objektivat lidhur me fenomenet e tharjes, varfërimit, kripëzimit e pasurimit, rehabilitimit, rrëshqitjes, përmytjes dhe erozionit të tokës dhe ai i përdorimit të panevojshëm të pesticideve janë të realizueshme pasi Plani së bashku me VSM merr në konsideratë dhe sugjeron masat e nevojshme. Kontrolli që vendos Plani mbi ndërtimet, rregullat lidhur me menaxhimin e pyllit si dhe sugjerimi për prodhime “bio” “made in Korca” i koordinojnë këto objektiva strategjinë e BE për tokën.

Cilësia e Ajrit

Vëzhgimi i vlerave të ndotësve të ajrit në Bashkinë e Korçës bie në sy, që me kalimin e viteve nuk ka ndonjë përmirësim. Masat që duhen të ndërmerren janë të lidhura me zgjidhjet për trafikun të cilat Plani i ofron, me cilësinë e karburanteve që mund të monitorohen nga organet përgjegjëse, ndërtimet, emetimet nga vend-depozitimi aktual i mbetjeve që marrin zgjidhje përmes projektit të landfillin rajonal etj. Të gjitha këto

problematika në rast të zbatimit të Planit dhe objektivave të VSM do të sjellin përputhjen e plotë të zgjidhjes së tyre me ato kombëtare dhe ndërkombëtare brenda një periudhe kohore 5 vjeçare. Përdorimi i metodave të reja bashkëkohore të monitorimit të vlerave të përqendrimit do ta bënte këtë objektiv edhe më të kontrollueshëm.

Ndryshimet Klimatike

Sigurisht që përmasat dhe industria e Bashkisë së Korçës janë të tilla që i bëjnë objektivat lidhur me ndryshimet klimaterike jo shumë konkrete, megjithatë kontributi i saj në nivel kombëtar mund të jetë i rëndësishëm. Këto objektiva, që janë të lidhura ngushtë me emetimet në atmosferë të gazeve të gazeve që mund të sjellin ndryshime të klimës, mund të plotësohen nga zgjidhjet e trafikut në bashki, nga përdorimi i filtrave në industri, nga përmirësimi i cilësisë së karburanteve dhe nga përdorimi i pajisjeve moderne që janë miqësore në lidhje me mjedisin. Të gjitha masat e mësipërme përfshihen në objektivat e VSM-se në mënyrë të tillë që Bashkia me administratën e saj por edhe popullatë të japin kontributin e tyre në nivel kombëtar, për të minimizuar emetimet, të inkorporojë përdorimin me efikasitetin të energjisë në të gjitha aktivitetet ekonomike dhe urbane dhe të jenë të gatshëm për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen jo vetëm nga shteti por edhe nga organizma ndërkombëtare, iniciativa ndërkufitare etj.

Menaxhimi i Mbetjeve

Zhvillimi ekonomik që do të vijojë në një mënyrë të disiplinuar në bazë të Planit, kërkon edhe një menaxhim të mbetjeve ku përfshihen mbetjet e materialeve të ndërtimit, mbetjet urbane, spitalore etj. Ndërtimi i landfillin rajonal të zgjidh përfundimisht një pjesë të madhe të problemit por jo plotësisht. Çështjet që lidhen me edukatën dhe ndërgjegjësimin do të kërkojnë më shumë kohë dhe do të përmirësohen përmes programeve të lidhura me këtë tematike, që do të zbatohen nëpër shkolla, mjedise pune etj. Gjithashtu edhe mbledhja e diferencuar e mbetjeve apo përdorimi i teknologjive që realizojnë riciklimin e një numri të madh mbetjesh do të realizonte një pjesë të objektivave të VSM, në përputhje me ato kombëtare dhe ndërkombëtare. Së fundi zbatimi rigoroz i ligjeve në fuqi do ta përmirësonte edhe më tej situatën brenda një periudhe 2-3 vjeçare. Kjo qasje ndaj mbetjeve do të bënte që ato të mos shikoheshin vetëm si të tilla por edhe si burim lënde e parë dhe energjie.

Ndotja nga Zhurmat

Bashkia e Korçës paraqet një problematikë të ndotjes akustike jo akute. Masat e parashikuara në Plan lidhur me sistemimin dhe krijimin e korridoreve të reja do të ndihmojnë në pakësimin e kësaj ndotje. Gjithashtu një zbatim dhe monitorim nga ana e

organeve përgjegjëse i ligjit ekzistues për zhurmat do të sillte një përmirësim të ndjeshëm sidomos në periudhën e sezonit turistik. Të dyja këto masa do të mundësonin plotësimin e objektivave të VSM në përputhje të plotë me ato kombëtare dhe ndërkombëtare.

3.5 Bashkëngjitja e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm në Plan

Një moment i rëndësishëm në Vlerësimin Strategjik Mjedisor është edhe mënyra e ndërthurjes së *objektivave të VSM* me ato të përcaktuara nga strategjitë e sektorëve të ndryshëm të Qeverisë Shqiptare dhe synimet ndërkombëtare të bazuara në të gjitha marrëveshjet dhe konventat ku ajo është partnere. Kjo ndërthurje lehtëson të kuptuarit e qëllimit të objektivave dhe se cilat janë drejtimet kryesore që duhen patur parasysh në punën e Bashkisë lidhur kryesisht me mjedisin dhe shëndetin publik. Skematikisht kjo ndërthurje trgohet edhe në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3.5 Bashkëngjitja e Objektivave të SEA Korçë me Objektivat Kombëtare dhe ndërkombëtare			
Objektivat e VSM	Përshkrimi	Objektivat Kombëtare + Ndërkombëtare	
1	Cilësia e mjedisit 1 (cilësia e ajrit, klima, shëndeti publik)	Siguron një cilësi ajri të pranueshme, vendos një kontroll mbi trafikun dhe automjetet, minimizon ndikimet negative mbi klimën dhe në shëndetin e popullatës duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës.	CA4, CA5, CA1, NK1, NK2
2	Cilësia e mjedisit 2 (uji, toka, biodiversiteti, shëndeti i publik)	Rrit cilësinë e ujit të pijshëm, përmes masave mbrojtëse ndaj pesticideve, ndërtimeve, landfillit ekzistues dhe shkarkimeve të industrive në kanalet drenimit dhe kullimit.	B1, B2, B6, MBU1
3	Cilësia e mjedisit 3 (peizazhi, natyra, toka, shëndeti publik)	Ripyllëzimi i kodrave, shmangia e erozionit të tokës dhe ruajtja dhe shtimi i biodiversitetit përmes programeve, investimeve publike dhe private.	MT1, NA1, MT3
4	Cilësia e mjedisit 4 (uji, toka, shëndeti publik)	Rehabilitimi i tokave bujqësore dhe industriale (deri në pastrimin e thellë të tokës), largimin e veprimtarive ndotëse, mbajtja me aktivitete të ulët ndikimi në mjedis brenda qytetit, ngritjen e gropave septike, zbatimin e masave të përmirësimit të cilësisë së ajrit	MM2, MM5, MM7, MBU2, MBU4

5	Cilësia e mjedisit 5 (njerëzit, uji, toka, shëndet publik)	Ndërgjegjshmëri, përmirësim i sjelljes së njerëzve në qëndrimet ndaj mjedisit, dhe energjisë së gjelbër me anë të vetëdijes, veprimeve konkrete dhe shembujve të iniciativave të sektorit publik,	CC1, CC2, MM7
6	Përmirësim i kushteve të jetesës. (trashëgimia kulturore, njerëzit, asetet materiale, energji)	Siguron shtesa për pronarët e shtëpive tradicionale për t'i rinovuar dhe mirëmbajtur ato si dhe mjediset përreth. Përmirëson cilësinë e shtëpive ekzistuese në drejtim të shërbimeve, kursimit të energjisë, uljes së ndotjes së zhurmave etj.	NK1, NA1, PT2ii, PT5
7	Përmirësim i kushteve të jetesës 2. (njerëz, infrastrukturë)	Siguron hapësira për infrastrukturën ekzistuese dhe atë të planifikuar për transportin rajonal në përputhje me funksionet e tjera urbane. Krijon mundësi për zgjidhje të problemeve të menaxhimit të trafikut në qendër të qytetit përmes krijimit të parkingjeve. Kërkon mundësi për investime në mënyra të qëndrueshme të transportit përmes përmirësimit të rrjetit të transportit publik dhe promovimit të mënyrave të tjera më miqësore për mjedisin (ecje, bicikleta).	CA4, CA5, NA1, PT1, PT2, PT5
8	Përmirësim i kushteve të jetesës 3. (njerëz, toka, peizazhi, asetet e materialeve dhe mjedis)	Promovon rehabilitimin dhe rinovimin e zonave industriale të braktisura me një përdorim plotësues. Vendos rregulla për pastrimin e thellë dhe rehabilitimin e tokës përpara ripërdorimit të saj. Gjithashtu vendos rregulla dhe kushte për industrinë që akoma janë në pranë zonave të banuara apo për përgatitjen e largimit të tyre në zonat e reja industriale.	SP3, NP3, MM5, MT3
9	Përmirësim i kushteve të jetesës 4. (peizazh, hapësira të gjelbërta, ajri, klima, shëndet publik)	Mbron dhe përmirëson sipërfaqet ekzistuese të gjelbërta dhe të lira si dhe zhvillon mundësinë e krijimit të një rrjeti i cili lidh hapësirat e lira dhe të gjelërta të qytetit ma ato të periferisë. Siguron hapësirat e nevojshme për infrastruktura të reja sportive si dhe për hapësirat e reja në zhvillim. Siguron vazhdimësinë për rigjenerimin e hapësirave të lira nga ana e Bashkisë në blloqet e pallateve të reja dhe të vjetra.	CA5, NA1, PT1, PT2, PT5
10	Përmirësim i kushteve të jetesës	Vendos rregulla për mirëfunksionimin dhe organizimin e Pazarit me qëllim kontrollin mbi efektet negative të tij mbi zonën përreth. Gjithashtu promovon dhe rehabiliton zonën e Pazarit së bashku me atë të aktiviteteve të tjera	PT2vi, PT3

	5. (njerëz, asete materiale, kohezion social)	duke rregulluar aktivitetin e tyre si dhe duke mënjanuar efektet anësore negative të tyre mbi zonën. Promovon rinovimin urban të zonës.	
11	Zhvillim i qëndrueshëm socialekonomik 1 (njerëz, punësim)	Krijon mundësi dhe për mënyra të tërheqjes së kursimeve dhe remitancave të emigrantëve në investime prodhuese të ekonomisë lokale. Siguron hapësira dhe zhvillon nisma për aktivitete që mbështesin rolin e qytetit si një qendër ekonomike rajonale. Zhvillon gjithashtu nisma për hapësira për institucione arsimore (shkolla të mesme, universitete, shkolla profesionale etj) sipas drejtimeve ekonomike të qytetit.	PT2iii, PT2vi
12	Zhvillim i qëndrueshëm social ekonomik 2. (njerëz, punësim, toka, asete materiale)	Vendos kufizime për zgjerim urban të paplanifikuar si dhe mekanizmat për kontrollin e zhvillimit, mbrojtjen e tokës bujqësore, mbështetjen për ekonominë bujqësore lokale si dhe për modernizimin e tyre.	MT1,MM 1,MM2
13	Zhvillim i qëndrueshëm social ekonomik 3 (trashëgimia kulturore, peizazhi, njerëz, punësim, asete materiale)	Mbron trashëgiminë arkitekturore të qytetit dhe ruan peizazhin e historik të tij. Gjithashtu mbështet investimet publike dhe private në rehabilitimin e ndërtesave tradicionale me një përparësi krijimin e shërbimeve dhe infrastrukturës turistike për turizmin. Parandalon po ashtu edhe ndërtimet që nuk përputhen me karakterin e ndërtimeve të qendrës së qytetit.	NA1,PT2ii, PT5

Tabela e mësipërme tregon më së miri se si janë të koordinuara dhe të ndërthurura objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare me VSM të Bashkisë Korçë. Kjo tabelë tregon rëndësinë që ka VSM lidhur me Planin pasi orienton dhe udhëzon rrugët dhe mjetet më të përgjithshme dhe të domosdoshme për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm, mjedis që do i shërbejë popullatës dhe që do të ruhet nga të gjitha aktivitetet e dëmshme, si dhe çon në përzgjedhjen e alternativës së Planit që është më afër me këto objektiva.

4

Skenarët/zgjidhjet alternative

4.1 Hyrje

Proçesi i VSM-se është një instrument që ndihmon grupet e interesit për të kuptuar më mirë avantazhet që Plani i jep të zonës së studimit. Për të përmbushur më mirë këtë detyrë ekipi ka të vlerësuar ndikimet e mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike të Instrumentit të Planifikimit Vendor si dhe alternativave të arsyeshme që mund të ishin ndjekur pa ekzistencën e këtij Plani të veçantë. Kjo nuk është roli i VSM për të vendosur mbi alternativat që duhen zgjedhur, por të japi informacion mbi ecurinë relative mjedisore, sociale dhe ekonomike të alternativave të ndryshme, për të lehtësuar marrjen e vendimeve ndërmjet palëve të interesuara dhe të ndihmojë në drejtimit e fundit të Plani Lokal, si dhe, ndryshimet pozitive dhe shtesa.

Përmes këtyre alternativave të arsyeshme VSM përmes një sistemi pikëzimi të thjeshtë vlerëson alternativën në bazë të realizimit të objektivave të përcaktuar në bazë të analizës nga ana e konsulentit. Në bazë të këtij sistemi vlerësimi konsulenti iu jep mundësinë grupeve të interesit të përcaktojnë dhe të diskutojnë mbi secilën alternativë dhe të gjykojë përparësitë dhe të metat e secilës prej tyre. Është e qartë se ky vlerësim duhet t'i japë pikët maksimale Planit Urban që do të miratohet si e vetmja alternativë që plotëson kërkesat për një kombinim optimal të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe urban me impaktet mbi mjedisin dhe shëndetin publik. Pra VSM është në rolin e një instrumenti udhëzues dhe vlerësues por jo vendimarrës për të përzhgjedhur alternativën e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Bazuar në ligjin 91/2013 për VSM ekipi i konsulencës ka formuluar vec Planit Urban për miratim edhe alternativa të tjera.

Ky vlerësim fillon me alternativën e skenarit të quajtur *skenari zero*, ose "**alternativa zero**". Kjo alternativë presupozon sikur zhvillimi i njësisë (Bashkisë) të kryhet pa një plan urban tërësor me gjithë komponentet e tij të studiuar.

Alternativat e tjera të paraqitura janë të përshkruara si :

Skenari 2 me fokus në “**Përmirësimi i mjedisit dhe ruajtja trashëgimisë kulturore**”;

Skenari 3 me fokus në “**Nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe punësimit**” dhe;

Skenari 4 ose **Plani i Përgjithshëm Vendor**.

Të gjitha alternativat e paraqitura këtu janë të bazuara në një sërë kufizimesh buxhetore, të lidhura dhe vendime, si dhe zhvillime skenarësh.

Për të kryer vlerësimi e alternativave të paraqitura, sistemi përdor pikëzimin e çdo alternative në drejtim të realizimit të objektivave të VSM-së dhe efektet pozitive të alternativave do të mund të përfshihen në alternativën përfundimtare.

Vlerësimi i skenarëve do të bëhet sipas një sistemi të pikëzimit sipas gravitetit nga minus dy (-2) të ndikimit të konsiderueshëm negativ në plus dy (2) impakt pozitiv, me rend klasifikimi të filluar "-2, -1, 0 (asnjë ndikim), +1 , +2 ".

Të katër (4) skenarët e zgjedhur, siç përmenden më lart, bazohen duke filluar nga skenari zero; zhvillim absolut minimal urban në kombinim me mbrojtjen mjedisore dhe projektet përmirësuese; një plan që i jep prioritet zhvillimit ekonomik, që më vonë do të krijojë mjedisin buxhetor, që do të kontribuojë në planifikimin e duhur urban dhe mbrojtjen e mjedisit; dhe një plan të plotë urban, që integron ndërhyrjet hapësinore/mjedisore/zhvillimit ekonomik, dhe preferohet nga projekti LAMP, por kërkon një sërë burime për investime. Në detaje të katër (4) skenarët janë:

- 1) ‘Skenari zero’ nënkupton skenar me investime minimale dhe të pakontrolluar dhe në mungesë të një Plani, vlerësimi për impaktin e tij në cilësinë e jetës, interesi në drejtimin turistik të qytetit dhe rritjen e tij, etj.
- 2) Skenari “Zhvillim urban vetëm me përmirësime mjedisore”. Si dhe sa do të ndikojë ky lloj skenari në zhvillimin e qytetit, çfarë duhet bërë për tërheqjen e banorëve të rinj? Ky skenar shmanë zhvillimet informale dhe të çrregullta me gjithë problematikën e tyre që lidhet me mjedisin dhe shëndetin e popullatës.
- 3) Skenari i tretë mundëson të vlerësohet tërësia e projekteve të zhvillimit vetëm ekonomik duke i dhënë përgjigje pyetjeve si: Cili nga projektet e zhvillimit ekonomik dhe rritjes urbane, bazuar në forcën e tregut, do të ndikojë në cilësinë e jetës në qytet? Kjo pjesë do të vlerësojë nën-skenarët e ndryshëm të zhvillimit alternativ të propozuar në fushën e turizmit, logjistikës, agrobiznesit, etj duke

përzgjedhur ata që janë më të qëndrueshëm. Skenari tre (3), trajton problemin e mungesës së punësimit dhe mundësive për zhvillim ekonomik.

- 4) Plani i propozuar mundëson integrimin e të gjitha masat e nevojshme shtesë, për një rritje të qëndrueshme. Në thelln kjo nënkupton, skenarin katër (4), kombinim i 2 dhe 3 në vizionin hapësinor. Më në hollësi këto skenare do të trajtohen më poshtë.

4.2 Vlerësimi i skenarëve

4.2.1 Skenari 1: Skenari zero

Një skenar i “mos bërjes së asgjëje”, nënkupton që qyteti i Korçës do të vazhdojë të zhvillohet në mënyrë të pa harmonizuar duke ju nënshtruar forcave të tregut dhe interesave private. Megjithatë, ky skenar do të ndihmojë për të zbuluar të gjitha efektet negative për drejtimin e qytetit pa një plan, si dhe ndikimet eventuale mbi mjedis nëse nuk ndërhyhet në sektorë të ndryshëm të vlerësuar nga VSM.

SKENARI I PARË – SKENARI ZERO		
OBJEKTIVAT VSM	EFEKTET E SKENARIT	RENDITJA
VSM 1	Sipas “Skenarit të mos bërjes së asgjëje”, ku ndarja e qytetit sipas destinacionit të zonave do të kishte si rezultat përkeqësimin e cilësisë së ajrit pasi do të mungonte një rrjet rrugor i përshtatshëm që do të shtonte qarkullimin e automjeteve në zonat rezidenciale, pasi ndërtimet e pakontrolluara do të ndikonin negativisht, pasi përzjerja e zonave industriale me ato rezidenciale do të sillte një përkeqësim të ajrit për banorët përreth.	-2
VSM 2	“Skenari i mos bërjes së asgjëje”, do të sillte një dëmtim të mundshëm të rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm të qytetit Korçës si rezultat i ndërtimit pa kriter dhe jo në përputhje me mundësitë e shtrirjes dhe të furnizimit të rrjetit aktual, dëmtim të cilësisë së tij nga ndërhyrjet e paautorizuara e për pasojë rritje të sëmundjeve dhe infeksioneve, ulje të detyrimeve dhe pagesave ndaj ndërmarrjes, do të krijonte gjithashtu vështirësi në mirëmbajtje të rrjetit furnizues	-1
VSM 3	“Skenari i mos bërjes së asgjëje”, do të çonte në një përkeqësim të gjendjes së pyllit dhe si rezultat edhe të dëmtimit të biodiversitetit dhe erozionit (rrëshqitjes së tokës) pavarësisht se kohët e fundit ky fenomen është ndalur në një farë shkalle. Sidoqoftë vetëm mungesa e një planifikimi për ripyllëzim të zonave të dëmtuara do të ishte një dëm më vete i madh për cilësinë e jetës së qytetit.	-1
VSM 4	“Skenari i mos bërjes së asgjëje”, do të linte hapur problematikën akute të menaxhimit të mbetjeve në Korçë, pasi akoma projekti rajonal nuk ka filluar të funksionojë e për pasojë nevojitet një aksion i planifikuar që nga mbledhja e mbetjeve e deri tek sistemimi i vendgrumbullimit të tyre. Planifikimi përreth zonës së hedhjes së mbetjeve do të ishte mjaft i rëndësishëm për shëndetin e banorëve që do të vazhdonin të provonin të ndërtonin shtëpitë e tyre në afërsi të kësaj zone. Problematike do të ishte edhe ruajtja e burimeve ujore nëntokësore.	-2
VSM 5	Sipas skenarit 1, mungesa e një plani do të sillte edhe një ndikim negativ në ndërgjegjësimin e popullatës lidhur me mjedisin pasi programet e	-1

	ndërgjegjësimit nuk do të ishin të fokusuara mbi problematika konkrete sipas hapësirave dhe zonave, duke mos krijuar mundësi për projekte pilote dhe të plota mjedisore të lidhura këto me shkollat, zonat e banuara dhe ato industriale.	
VSM 6	Ky skenar nuk sjell ndonjë ndikim pozitiv në drejtim të shtëpive të pronarëve të shtëpive tradicionale dhe nuk stimulon mirëmbajtjen e mjediseve përreth dhe në mënyrë të vecantë nuk përmirëson cilësinë e shërbimeve, nuk sjell efikasitet të enegjise dhe ulje të ndotjes së zhurmave etj.	-1
VSM 7	Zhvillimi përmes një skenari të till do ta përkeqësojë infrastrukturën ekzistuese dhe do të çojë në zgjidhje të sforcuara për planifikimin e transportin rajonal si pasojë e zënies së hapësirave të nevojshme. Ky lloj zhvillimi do të vështirësojë qarkullimin si në qendër të qytetit ashtu edhe në periferi dhe nuk do mund ta zgjidhë çështjen e parkimit në mënyrë të qendrueshme.	-2
VSM 8	Promovon aktivitetet private të reja industriale si dhe shtyn bizneset përmes proceseve të privatizimit në rehabilitimin dhe rinovimin e zonave industriale të braktisura për t'i përdorur ato pa u kujdesur për zbatimin e rregullave, nga ana tjetër ky skenar nuk zgjidh përfundimisht konfliktin midis përdorimit të tokës bujqësore dhe ndërtimeve pa kriter. Mundësia e largimit të industrive që gjenden brenda zonave rezidenciale zvogëlohet.	-1
VSM 9	Ky skenar nuk tregon ndonjë vëmendje të vecantë lidhur me hapësiart e gjelbërta, rigjenerimin e tyre dhe krijimin e korridoreve mjedisore. Nga ana tjetër hapësirat për terrene sportive do të krijohen në vartësi të interesit privat në formën e biznesit.	-1
VSM 10	Sipas këtij skenari, mungesa e një rregulli për mirëfunksionimin dhe organizimin e Pazarit do të shtonte investimet në këtë zonë duke e rënduar edhe më tej efektet negativet tij mbi zonën përreth. Ky skenar nuk do të promovonte rinovimin urban të zonës.	-2
VSM 11	“Skenari mos bërjes së asgjëje”, ne kushtet e një stanjacioni të përgjithshëm ekonomik, teorikisht do të çonte në vazhdimin e degradimit të mjedisit, veçanërisht të fondit pyjor në rrethinat e Korçës, por meqenëse ky fenomen tashme ka ndodhur, ky skenar nuk do të krijonte premise për vazhdimin e mëtejshëm të këtij degradimi, duke nënkuptuar vetëm efektet anësore që mund të kemi nga erozioni dhe rrëshqitja e dherave.	0
VSM 12	Problemi i konsumimit të mëtejshëm të tokës bujqësore do të ishte problemi më i rëndë i ndodhjes dhe degradimit të mjedisit në kushtet e mungesës së një plani dhe kufizimeve të tjera në përdorimin e fondit të tokës bujqësore e cila ndodhet nën administrimin e Bashkisë Korçë. Kjo ka ndodhur edhe në vendet e tjera si Greqia e cila në ndikimin e programeve të Bashkimit Evropian, modernizojë gjithnjë e më shumë sektorin bujqësor, duke e detyruar një pjesë të madhe të popullsisë në fshat të shkonte në zonat urbane. Në këtë mënyrë do të kishim një keqpërdorim të tokës bujqësore në rrethinat e qytetit Korçë, duke mos përdorur në mënyrë efektive fondin ekzistues të banesave.	-2

VSM 13	Mungesa e një plani të përgjithshëm vendor për qytetin e Korçës do të sillte pasoja të pakthyeshme në degjenerimin e zonës karakteristike të qytetit veçanërisht të lagjeve që shtrihen në pjesën lindore dhe përgjatë bulevardit të Korçës, përfshirë edhe pjesën e pazarit karakteristik. Kjo pasi mungesa e një plani të përgjithshëm i cili do të përcaktonte zonat e reja industriale dhe ato të banimit do të krijonte premisa dhe presion mbi ndërtimet karakteristike të qytetit të cilat janë shumë të aksesueshme pasi ndodhen në qendër të qytetit. Pasojat do të ishin të pariparueshme me një humbje të trashëgimisë kulturore të qytetit të Korçës, si një atraksion i veçantë turistik dhe kulturor.	-2
--------	---	----

4.2.2 Skenari 2: Përmirësimi i mjedisit dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore

Ky është një skenar, i cili merr parasysh një buxhet të kufizuar të Bashkisë, i cili i orienton të gjitha fondet lokale në projekte për përmirësimin e infrastrukturës mjedisore dhe trashëgimisë kulturore. Në këtë mënyrë qytetit do të kufizohet në zhvillimin hapësinor ekzistues, pa krijuar hapësirat e duhura për një zhvillim intensiv ekonomik.

Një skenar i tillë për Bashkinë Korçe do të sjelle këto përmirësime:

- Te zonës rezidenciale të qytetit dhe pazarit karakteristik;
- Përmirësimin mjedisor nëpërmjet rryllëzimit të kodrave të qytetit;
- Sigurimin e hapësirave për zonat ekonomike pa investime paraprake;
- Sigurimin e hapësirave për shërbimin arsimor, për kujdesin shëndetësor, si edhe të objekteve kulturore;
- Zhvillojë dhe zgjerojë hapësirat e hapura të gjelbra dhe mjediset sportive të qytetit

Nga ana tjetër Plani bazuar në këtë skenar do të nxisë Bashkinë të mbështesë planin e investimit në projektet e mëposhtme:

- Grumbullimin, seksionimin, transportimin dhe depozitimin më të mirë të mbetjeve urbane;
- Zmadhimin e kolektorit të grumbullimit të ujërave të ndotur dhe sistemin përkatës të përpunimit;
- Ndërtimin e gropave septike në zonat e ndërtimeve informale;
- Zhvillimin e një seti projektesh për rritjen e cilësisë së ujit të pijshëm dhe të parametrave mjedisore të rrjedhjeve ujore dhe kanalit të qytetit.

Ndërhyrjet kryesore që parashikohen në projektin LAMP, në bazë të së cilës parashikohen të drejtohen fondet e Bashkisë Korçe sipas këtij skenari do të jenë:

- Parqet dhe sipërfaqet e gjelbra ekzistuese ruhen dhe mbrohen dhe tani (për shembull Parku Rinia”), ndërkohë që mendohet të krijohen parqe dhe hapësira të reja të gjelbra në mënyrë që t’u shërbejnë nevojave aktuale si dhe popullsisive në të ardhmen. Në përgjithësi ato kombinohen ose me objekte sportive ose me turizëm dhe zona rekreative.
- Qendra e qytetit – Plani përmban dhe mbron zonat e hapura dhe të gjelbra të Qendrës së Qytetit si dhe bulevardet me trotuare të gjera dhe bimësi të lartë, të cilat aktualisht ofrojnë një mikroklimë të veçantë e të këndshme urbane.
- Parqet aktive në nivel qyteti – Plani propozon mbrojtjen dhe përmirësimin e Parkut Rinia, duke e konsideruar atë si vend kryesor çlodhës e argëtues në qytet. Parku “Shetro”, i planifikuar nga Bashkia do të përbëjë një tjetër park domethënës urban, në afërsi të qendrës së qytetit.
- Zonat e reja të gjelbra – zona të reja të gjelbra të nivelit mesatar propozohen për Kompleksin sportiv (në veri të qytetit), pas fabrikës së tullave, dhe në lindje të varrezave (në juglindje të qytetit). Këto zona do të shërbejnë për zgjerimet e reja rezidenciale dhe për lagjet e periferisë, të cilat aktualisht vuajnë nga mungesa e hapësirave të gjelbra. Në këtë zona janë të integruara dhe objektet sportive.
- Rehabilitimi i vend depozitimit ë mbetjeve – heqja e vend depozitimit ndotës do të hapë rrugën për rehabilitimin e tij dhe për zhvillimin e një parku të gjelbër dhe kreativ. Kjo do të jetë një ndër qendrat kryesore të qytetit për aktivitete gjatë kohës së lirë, por do të jetë dhe një faktor i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve mjedisore dhe për cilësinë e jetës për popullsinë lokale.
- Kodrat e Moravës – zhvillimi i propozuar për Kodrat e Moravës do të lejojë rryllëzimin e një pjese të rëndësishme të zonës dhe zhvillimin e pyjeve periurbane, të cilat pjesërisht do të kthejnë peizazhin natyror të qytetit në statusin e tij fillestar.
- Rigjenerimi i hapësirave të hapura – plani nxit vazhdimin e projekteve të ndryshme të rigjenerimit të ndërmarra nga bashkia gjatë viteve të fundit. Këto plane do të duhet të vazhdojnë në zonën në jug të pazarit dhe në hapësirat e hapura të blloqeve kolektive të banesave.
- Korridoret e gjelbra – plani propozon zhvillimin korridoreve të gjelbra përgjatë rrugëve kryesore urbane. Korridoret e gjelbra e lidhin qendrën e qytetit me zonat e banimit në periferi, si dhe me hapësira të gjelbra të niveleve të ndryshme, siç ilustron në Hartën 5.
- Objektet ujore – plani mbron kanalet e ujit që ekzistojnë sot në periferi të qytetit. Pas zgjerimit rezidencial dhe integritimit të zonave informale, këto kanale mund të zhvillohen në hapësira lineare të gjelbra dhe në zona rekreative që do të lidhin

lagjet dhe do të përmirësojnë ndjeshëm imazhin dhe mikroklimën e zonave të banimit aty afër.

Vlerësimi i alternativave të tilla, me buxhet të drejtuar vetëm në projektet mjedisore do të çonte në rivlerësim të objektivave të VSM sipas tabelës së mëposhtme:

SKENARI 2-të – ZHVILLIMI URBAN ME SKENAR PËRMIRËSUES TË MJEDISIT		
OBJEKTIVAT VSM	EFEKTET E SKENARIT	RENDITJA
VSM 1	Zhvillimi sipas skenarit 2 do të ruajë gjendjen aktuale ose mund ta përmirësojë disi cilësinë e ajrit në këtë Bashki si pasojë e rritjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe përmirësimit të parqeve aktuale, por nuk do të shmanjë dot ndikim e ndotjes nga automjetet, ndërtimet dhe shtrirja e pa planifikuar e bizneseve industriale.	+1
VSM 2	Skenari 2 do të ruante dhe do të përmirësonte pjesërisht furnizimin me ujë të qytetit por nuk do të shmangte dot ndërhyrjet e paautorizuara në rrjet si pasojë e ndërtimeve duke sjellë kështu rrezikun e ndotjes së ujit të pijshëm.	+1/+2
VSM 3	Ky skenar do të përmirësonte ndjeshëm situatën e pyllit dhe të zonave të gjelbra të qytetit dhe përreth tij përmes planeve të rehabilitimit dhe ndërtimit të korridoreve të reja mjedisore.	+2
VSM 4	Skenari 2 do të përmirësonte përkohësisht situatën e vendgrumbullimit të mbetjeve, duke e rehabilituar atë si dhe do të ndikonte pozitivisht në menaxhimin e grumbullimit të tyre në Bashki, por planifikimi dhe zbatimi i planit të menaxhimit rajonal do të sillte zgjidhjen përfundimtare.	+1
VSM 5	Skenari i zhvillimi urban me qëllim përmirësim mjedisor do të ndikonte pozitivisht në kushtet e jetesës dhe në ndërgjegjësimin e popullatës për ruajtjen e hapësirave të reja të gjelbra që do të krijoheshin.	+2
VSM 6	Ky skenar do të siguronte një përmirësim të situatës së shtëpive tradicionale për t'i rinovuar dhe mirëmbajtur ato si dhe mjediset përreth. Po ashtu do të përmirësonte cilësinë e shtëpive ekzistuese në drejtim të shërbimeve, kursimit të energjisë, uljes së ndotjes së zhurmave etj.	+2
VSM 7	Ky skenar nuk do sillte ndonjë ndikim pozitiv në infrastrukturën ekzistuese të trafikut, të parkimit apo të rrjetit të transportit publik. Do të mungonin zgjidhjet e reja dhe bashkëkohore për ta menaxhuar situatën dhe problematikat e një trafiku gjithnjë në rritje si dhe investimet e qëndrueshme	0

VSM 8	<p>Promovon rehabilitimin dhe rinovimin e zonave industriale të braktisura me një përdorim plotësues. Vendos rregulla për pastrimin e thellë dhe rehabilitimin e tokës përpara ripërdorimit të saj.</p> <p>Gjithashtu vendos rregulla dhe kushte për industrinë që akoma janë në pranë zonave të banuara apo për përgatitjen e largimit të tyre në zonat e reja industriale.</p>	+2
VSM 9	<p>Zhvillimi sipas këtij skenari mbron dhe përmirëson sipërfaqet ekzistuese të gjelbërta dhe të lira, shton hapësirat e gjelbërta si dhe zhvillon mundësinë e krijimit të një rrjeti i cili lidh hapësirat e lira dhe të gjelërta të qytetit ma ato të periferisë.</p> <p>Gjithashtu siguron hapësirat e nevojshme për infrastruktura të reja sportive si dhe për hapësirat e reja në zhvillim. Ky skenar do të shtojë hapësirat e gjelbërta dhe ato ekzistuese në blloqet e apartamenteve, më zonën e qendrës së qytetit etj.</p>	+2
VSM 10	<p>Nuk sjell ndonjë përmirësim të dukshëm për mirëfunksionimin dhe organizimin e Pazarit me qëllim kontrollin mbi efektet negative të tij mbi zonën përreth.</p> <p>Gjithashtu promovon dhe rehabiliton zonën e Pazarit, ruan hapësirat e lira duke mënjanuar efektet anësore negative të tyre mbi zonën.</p>	+1
VSM 11	<p>Në parim aplikimi i skenarit bazë do të sillte përmirësime në mjedisin e Bashkisë, por për faktin se ky skenar bën pak ose aspak progres për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e punësimit, atëherë presioni i varfërisë mbi mjedisin do të jetë i lartë. Kjo do të thotë që efektet pozitive që do të vijnë nga mjedisi do të eliminohen nga veprimi i njerëzve të dëshpëruar për punësim dhe të ardhura minimale që do të vepronin në kundërshtim me rregullat e mbrojtjes së mjedisit</p>	0
VSM 12	<p>Një planifikim i territorit me prioritet ruajtjen e pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore pa dyshim do të çonte në një kujdesie dhe ruajtje të fondit të tokës bujqësore ekzistuese. Megjithatë, presionet mbi tokën e “lirë” do të ishin më të mëdha në rast se popullsia në zonat rurale nuk do të kishte perspektiva ekonomike në rajonet e tyre të banimit. Kështu që përfitimi nga kjo masë do të jetë i kufizuar përsa i përket ruajtjes së fondit të tokës.</p>	+1
VSM 13	<p>Drejtimi i investimeve publike të Bashkisë Korçë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe asaj urbane, pa dyshim që do të sillte përmirësime të ndjeshme të statusit të zonës karakteristike dhe pazarit të Korçës. Kjo pasi do të investohej në mirëmbajtjen e rrugëve ndërlidhëse ose të ashtuquajtura rrugicat karakteristike të Korçës, do të investohej për rehabilitimin e fasadave dhe infrastrukturës së ujërave të zeza. Po kështu impakt pozitiv do të kishte edhe nga gjelbërimi i qytetit dhe i kodrave për rreth, kështu që impakti i faktorit në mjedis do të ishte i drejtpërdrejtë dhe i qenësishëm.</p>	+2

4.2.3 Skenari 3: Nxitja e zhvillimit ekonomik dhe punësimit

Sipas këtij skenari zhvillimi i territorit do të përcaktohet se si dhe sa mbështet zhvillimin ekonomik dhe nxitjes së punësimit. Në këtë rast Plani jo vetëm duhet të

sigurojë zona të mirëfillta ekonomike por gjithë interesi i publikut për te zhvilluar pronën e tij do të lidhet me rritjen e mundësive për vetë punësim dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, pa marrë parasysh karakterin e zonës në të cilën ndodhet kjo pronë. Në këtë rast jo vetëm territori por edhe drejtimi i përdorimit të burimeve financiare lokale dhe ato kombëtare do të përdoren për mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës që siguron nxitjen e investimeve dhe rritjen e punësimit.

Ky skenar presupozon se buxheti i kufizuar i Bashkisë do të jetë i parashikuar vetëm për iniciativat e zhvillimit ekonomik dhe pritet që kjo të krijojë pasuri dhe të ardhura shtesë nga taksat, do të kontribuojë në një fazë të mëvonshme për zbatimin e zhvillimit të kontrolluar urban.

Fokusimi në zhvillimin ekonomik do të nënkuptonte përgatitjen e një programi të integruar të zhvillimit lokal, që do të bazojë ndërhyrjen e tij në asetet ekzistuese dhe cilësinë e strukturës ekonomiko - sociale dhe vizionin e Korçës për zhvillimin e një qyteti, i cili jo vetëm të ketë një qendër e afte te ofroje shërbime cilësore por edhe me zona ekonomike që të lejojnë kryerjen e veprimtarive të mirëfillta prodhuese, për të mbështetur zhvillimin e agrobiznesit dhe industrinë e fasonëve.

Në këtë kuadër Plani LAMP nxit rritjen ekonomike dhe prosperitetin duke i prezantuar qartë zonat ekonomike dhe duke hequr përdorimet e papërshtatshme të tokës. Investimi në këtë drejtim të burimeve financiare të Bashkisë Korçë do të na krijonte Zonat ekonomike ndahen në qytet si më poshtë:

- Përqendrim i lartë i aktiviteteve ekonomike gjendet përgjatë hyrjes kryesore të qytetit, përgjatë aksit rrugor drejt Tiranës. Plani parashikon zgjerimin e zonave ekzistuese dhe organizimin e duhur të tyre dhe lejon vetëm prodhim me ndikim të ulët dhe mesatar ndërsa heq industrinë e rëndë. Transferimi i zhvillimit të hekurudhës në të ardhmen në këtë anë të aksit, së bashku me qendrën e re logjistike, parashikon krijimin e një zone të re aktivitësh të shitjes me shumicë dhe një Qendër Rajonale Ekspozitash të re, e cila do të mbështesë fort këtë përqendrim si aksin kryesor të zhvillimit ekonomik të qytetit.
- Një pol i dytë krijohet përgjatë hyrjes në qytet kur vjen nga Bilishti, duke u bazuar sërish në tendencat ekzistuese. Ky pol ka aktivitete të përziera ekonomike dhe tregtare, por ofron dhe hapësirë për zhvillimin e një parku industrial të ri e të organizuar. Pas konsultimeve të shumta me ekspertë për mjedisin dhe pas analizimit të të gjithë parametrave mjedisore, kjo fushë mbledh kërkesat e nevojshme për park të ri industrial. Këto kërkesa janë stabiliteti nëntokësor, mbrojtja e ujit nëntokësor, erërat mbizotëruese dhe pozicioni i saj në afërsi të unazës së jashtme dhe hyrjes nga Bilishti.

- Një pol i tretë formohet përgjatë rrugës për në Drenovë, duke i kushtuar rëndësi aktiviteteve agro-përpunuese, ndërsa ofrohet dhe mundësia për një park industrial.
- Së fundmi plani nxit heqjen e zonave të caktuara ekonomike për arsye afërsie me zonat e banimit në mënyrë që të shmangen rreziqet mjedisore. Kjo është zona në juglindje të qytetit, e cila përfshin dhe fabrikën e tullave dhe atë të cigareve.

Nga krahu tjetër PLANI LAMP kombinon zhvillimin ekonomik të qytetit me fuqizimin administrativ të qytetit të Korçës, si qendra me e rëndësishme urbane e rajonit Juglindor të Shqipërisë, duke përcaktuar zhvillimin e të gjitha shërbimeve publike për qytetaret si me poshtë:

- Transportin publik;
- Shërbim shëndetësor;
- Shërbim arsimor;
- Shërbim profesional,
- Shërbim argëtimi,;
- Shërbim turistik;
- Shërbim kulturor.

Me qëllim për të krijuar një rrjet të integruar të shërbimeve, një sërë investimesh të tilla si ndërtesat publike (p.sh. për shëndetin parësor, administratën, arsimin) duhet të planifikohen, ashtu edhe një sërë hapësirash për ndërtesa tregtare në shërbime private dhe shtëpitë duhet të jenë të ndara. Ndërtimi i Qendrave të Biznesit dhe Qendrave Tregtare do t'i lihet sektorit privat.

Është e qartë se fokusimi i investimeve publike vetëm në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe nxitjen e punësimit do të kishim një ridimensionim të objektivave strategjik të mjedisit të cilat reflektohen në tabelën e mëposhtme.

SKENARI I 3-të – SKENARI I VETËM I ZHVILLIMIT EKONOMIK		
OBJEKTIVAT VSM	EFEKTET E SKENARIT	RENDITJA
VSM 1	Sipas skenarit 3 kemi krijimin e tre poleve të rëndësishme industriale të cilat do ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit në këto zona dhe do ta përmirësojnë disi cilësinë e ajrit në qendrën e qytetit. Gjithashtu përmirësimi i transportit	0

	publik dhe ai i qarkullimit të automjeteve do të ndikojnë pozitivisht në cilësinë e ajrit. Mungesa e masave specifike dhe mungesa e investimeve të mirëfillta në lidhje me mjedisin nuk do të mund të përballojnë ndotjen si pasoje e rritjes ekonomike, ndërtimeve etj.	
VSM 2	Skenari 3 do të krijojë kushtet e mjaftueshme për shtrirjen e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm për polet e reja ekonomike të Bashkisë dhe ruajtjen e tij nga ndërhyrjet e paautorizuara por sjell një rrezik për ndotjen e mundshme të ujerave nëntokësore nga shtimi i ujerave të ndotura industriale	0/+1
VSM 3	Skenari 3, “vetëm i zhvillimit ekonomik”, nuk do të sjellë ndonjë ndikim pozitiv në drejtim të pyllëzimit, biodiversitetit dhe erozionit përkundrazi do t’i cenojë ato edhe më shumë.	-2
VSM 4	Shtimi i aktiviteteve ekonomike sipas skenarit 3 do të çojë në një rritje të mëtejshme të mbetjeve duke e rënduar edhe me tej situatën aktuale në rast se ky zhvillim nuk do të shoqërohet më masat e duhura si lidhur me grumbullimin e tyre ashtu edhe në lidhje me vend-depozitimin aktual të tyre	-2
VSM 5	Sipas skenarit 3, shtimi i aktiviteteve ekonomike nuk le pas dore zhvillimin e sektorit të arsimit dhe atë kulturor që mbase mund të ndikojnë përmes programeve të ndërgjegjësimit në rritjen e ndërgjegjes qytetare në mbrojtje të këtij mjedisi kryesisht me tendencë të varfër zhvillimi.	+1
VSM 6	Ky skenar nuk sjell ndonjë ndikim pozitiv të dukshëm në drejtim të shtëpive të pronarëve, të shtëpive tradicionale dhe nuk stimulon mirëmbajtjen e mjediseve përreth dhe në mënyrë të vecantë nuk përmirëson cilësinë e shërbimeve, nuk sjell efikasitet të enegjise dhe ulje të ndotjes së zhurmave etj.	+1
VSM 7	Ky skenar do të sigurojë hapësira për infrastrukturën lidhur me transportin rajonal në përputhje me funksionet e tjera urbane por nga ana tjetër shtimi i numrit të bizneseve do të sjellë një vështirësi të problemeve të menaxhimit të trafikut në qendër të qytetit. Do të sillte rritje të investimeve të lidhura me transportin përmes përmirësimit të rrjetit të transportit publik.	+1
VSM 8	Sipas këtij skenari zonat e braktisura industriale do të zhvillohen me aktivitete prodhuese dhe të tjera ndërsa industritë që gjenden në afërsi të zonave rezidenciale të qytetit do të vazhdojnë të zgjerojnë edhe më tej aktivitetin e tyre duke sjellë edhe një ndotje edhe më të madhe në mjedis. Kjo do të vështirësojë largimin e tyre në të ardhmen nga këto qendra.	-1
VSM 9	Ky skenar nuk tregon ndonjë vëmendje të vecantë lidhur me hapësiart e gjelbërta, rigjenerimin e tyre dhe krijimin e korridoreve mjedisore. Nga ana tjetër krijon mundësi për infrastruktura të reja sportive si dhe për hapësirat e reja në zhvillim.	0
VSM 10	Sipas këtij skenari organizimi i Pazarit nuk do të jetë i orientuar në ruajtjen e karakteristikave të tij dhe mund të sjellë efekte negative mbi zonën përreth. Promovon zhvillimin urban të Bashkisë si dhe të zonës përreth pazarit.	+1
	Pa dyshim që fokusimi i planit në zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e punësimit	+2

<i>VSM 11</i>	do të çojnë në uljen e presionit mbi burimet natyrore, për shkak se përfitimi që do të kenë njerëzit nga shfrytëzimi i këtyre burimeve do të jetë më i ulët se sa përfitimi që do të kenë ata në përfshirjen e tyre si të punësuar apo punësues për shkak të rritjes së mundësive për punësim dhe aktiviteteve të tjera biznesi.	
<i>VSM 12</i>	Zhvillimi i një plani me prioritet zhvillimin ekonomik nëpërmjet planifikimit të zonave të reja ekonomike në qytet do të çojë në kursimin e fondit të tokës bujqësore ekzistuese, pasi aktiviteti i ri ekonomik do të përqendrohet në zona të veçantë, çka presupozon jo presion mbi fondin e tokës bujqësore. Megjithatë mungesa e projekteve mjedisore mund të çojë në një fare degradimi të kësaj sipërfaqe, duke e vlerësuar në ‘neutral’ ndikimin e këtij faktori	0
<i>VSM 13</i>	Fokusimi i buxhetit të Bashkisë vetëm në zhvillimin e infrastrukturës që lejon zhvillimin ekonomik do të çojë në rritjen e presionit mbi zonat muzeale dhe pazarin e Korçës që përbejnë trashëgiminë kulturore të qytetit për rrjedhojë do të kemi një humbje graduale të kësaj trashëgimie në periudhën në vazhdim, duke sjelle pasoja negative.	-2

4.2.4 **Skenari 4: Skenari i Planit Urban për një zhvillimin të qëndrueshëm**

Ky skenar synon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të qytetit duke siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe kujdesur në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të qytetit të Korçës, mbi bazën e Vizionit të zhvillimit të Bashkisë Korçë të përcaktuar në Planin e mbështetur nga projekti LAMP, si dhe objektivave strategjike të përcaktuar në këtë Plan.

Nga vlerësimet e bëra tek *VSM* edhe të tre (3) skenarëve të tjerë, është e qartë që Korça ndeshet me një kompleks sfidash në:

- Në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit;
- Zhvillimin si një qendër e rëndësishme ekonomike dhe administrative.
- Rehabilitimin e mjedisit veçanërisht në zonat rekreative të kodrave të qytetit, parqeve, zonave sportive dhe korridoreve mjedisore.

Kështu programet që do të trajtojnë këto sfida, duhet të jenë të integruara (në aspektin hapësinor, ekonomik dhe mjedisor), dhe jo thjesht të planifikuara. Ekipi LAMP zgjedh këtë qasje në procesin e tyre të planifikimit urban dhe ekipi i *VSM* është i predispozuar në drejtim të këshillimit të grupeve të interesit në qytet, në zgjedhjen e këtij skenari si të preferuar.

Kështu, Skenari i katërt (4) është në thelb skenari LAMP, dhe përfshin disa veprime të tjera dhe ndërhyrje shtesë të shpallura që nga analizat e skenarëve të dytë (2) dhe të tretë (3), domethënë kombinimi i zhvillimit ekonomik me vizionin hapësinor dhe

presionet e mjedisit. Siç është përmendur në Skenarin 2, një përpjekje e re mund të jetë e nevojshme për të planifikuar një program të integruar të zhvillimit ekonomik, që do të sjellë detaje të tilla si ato të planifikimit hapësinor.

Ky skenar është baza për konsultime të mëtejshme me grupet e interesit, analizave të mëtejshme në drejtim të projekteve të veçanta, një vlerësim i bashkëveprimit LAMP - VSM, matjeve dhe indekseve që lidhen me monitorimin e objektivave të arritshme të VSM dhe arritjeve të LAMP, si dhe konsultimeve të mëtejshme. Pasqyrimi i këtyre ndërhyrjeve të kombinuara me faktorët mjedisorë do të pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

SKENARI I 4-I SKENARIT TË Planit (kombinim i skenarit 2 dhe 3)		
OBJEKTIVAT VSM	EFEKTET E SKENARIT	RENDITJA
VSM 1	Zhvillimi sipas skenarit 4 që është orientimi i planifikimit urban kryesisht sipas LAMP, do të çojë në rritje të cilësisë së mjedisit urban, në përmirësim të rrugëve, të qarkullimit rrugor, rehabilitimin e vend-depozitimit të mbetjeve, kontroll të ritmit të ndërtimeve rezidenciale dhe industriale duke ndikuar kështu pozitivisht në cilësinë e ajrit në këtë Bashki dhe për pasojë në shëndetin e popullatës.	+2
VSM 2	Skenari 4 e mbron rrjetin aktual të furnizimit me ujë nga ndërhyrjet e paplanifikuara dhe të paautorizuara duke ruajtur kështu cilësinë e ujit të pijshëm që furnizon qytetin si dhe sasinë e nevojshme ditore për banor.	+2
VSM 3	Ky skenar ruan dhe shton sipërfaqet e gjelbra të qytetit, rehabiliton zonën e vend-depozitimit të mbetjeve duke e shndërruar atë në një hapësirë rekreative, shton korridorët mjedisore duke ndikuar pozitivisht në rritjen e sipërfaqeve të ripyllëzuara e për pasojë shton hapësirat për Habitatet duke përmirësuar Biodiversitetin dhe ul efektet negative të erozionit.	+1+2
VSM 4	Ky skenar koordinon rehabilitimin e vend-grumbullimit të mbetjeve me atë në nivel rajonal si dhe përmirëson mundësinë e grumbullimit dhe të riciklimit të tyre.	+2
VSM 5	Zhvillimi proporcional i të gjithë hapësirës dhe në përputhje me interesat e popullatës do të rrisë kërkesat dhe shkallën e ndërgjegjes së popullatës në drejtim të ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit, si dhe do rrisë interesin e palëve të interesuara për një kontroll sa më të mirë të pastërtisë, gjelbërimit, mbetjeve duke hartuar projekte pilote, programe dhe fushata ndërgjegjësimi të mbështetura këto edhe nga institucionet përgjegjëse si ARM, Bashkia etj.	+2
VSM 6	Ky skenar do të sigurojë një përmirësim të situatës së shtëpive tradicionale për t'i rinovuar dhe mirëmbajtur ato si dhe mjediset përreth. Po ashtu do të përmirësonte cilësinë e shtëpive ekzistuese në drejtim të shërbimeve, kursimit të energjisë, uljes së ndotjes së zhurmave etj.	+2

	ELEMINIMI I KONFLIKTEVE TE PERDORIMIT TE TOKES REZIDENCIALE KUNDREJT PERDORIMIT INDUSTRIAL TE SAJ DHE RINOVIMI I BROWNFIELD	+	+	+	d+	+	d+	d+	+	d+	0	d-	d-	+	<p>Ndikime akumulative: Shume aspekte te ketij komponenti kane impakt pozitiv kumulativ. Qyteti do te behet atraktiv per te punuar si dhe per tu vizituar dhe situata me jdisore dhe shendetesore do te permiresohet.</p>
													<p>Ndikime sinergjike: Shume aspekte te ketij komponenti kane impakt pozitiv sinergjik. Qyteti do te behet atraktiv per te punuar si dhe per tu vizituar dhe situata me jdisore dhe shendetesore do te permiresohet.</p>		
													<p>Aktet korigjuese: Planifikimi i zonave te reja ekonomike duhet te ndiqet nga rregulla strikte mjedisore ne lidhje me aktivitetet ekonomike qe do te zhvendosen.</p>		

Tabela 2.4- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I II-të : Plani strukturor Bashkiak (vazhdim)															
POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
	4														<p>Komente: Masat e ndermarra ne kete komponent do te kontribojne pozitivisht tek VSM duke mbrojtur dhe rinovuar pasurite me atraktive te qytetit ne te mire te qytetareve dhe te zhvillimit te qendrueshem ekonomik.</p> <p>Efekte anesore: Efekte pozitive ne cilesine e mjedisit te qytetit. Zonimi do te jape nje mesazh te qarte nepermjet mire administrimit dhe ndergjegjesimit klimatik te qytetareve per ruajtine e vlerave pasurore te qytetit. Efekt negativ potencial ne reduktimin e nje sere investimesh private ne zonat e mbrojtura historike.</p>
0		0	0	d+	+	+	d+	d+	d+	+	+	d+	+	<p>Ndikime akumulative: Pozitive per komunitetin, punesimin, cilesine e jetes dhe per mjedisin urban.</p>	2. Jep incentiva tek pronaret e tokes ne zonat e trashegimise kulturore per rinovim ose rishfrytezimin e ndertesave.
													<p>Ndikime sinergjike: Ruatja dhe rinovimi i vlerave pasurore te qytetit do te kete nje impakt sinergjik ne biznesin e turizmit , rritje te punesimit te qytetareve dhe te kohezionit social</p> <p>Aktet korigjuese: Edukimi dhe ndergjegjesimi i duhur i qytetareve per te parandaluar rezistencen kundrejt zonave ekonomike ekzistuese pasi interesi i tyre mund te ndikoje kete komponent.</p>	<p>3. Skema e Bashkepunimit Publik dhe privat per financimin e projekteve rehabilituese.</p> <p>4. Promovimi i nje programi special per ndryshimin e karakterit te pazarit te Korces.</p>	

Tabela 2.5- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I II-të : Plani strukturor Bashkiak (vazhdim)

Tabela 2.5- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I II-të : Plani strukturor Bashkiak (vazhdim)																
POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN	
	5															<p>Komente: Masat e ndermarra te ketij komponenti kontribojne pozitivisht te VSM ne krijimin e perdorimit te qendrueshem te burimit te tokes dhe permiresimi i formes urbane. Kontrolli urban do të gjenerojë dy situata pozitive për kerkesen ndaj tokës brenda kufijve të qytetit dhe gjithashtu mbrojtjen e tokës bujqësore përreth urbanizimi sporadik.</p> <p>Efekte anesore: Humbje potenciale te ardhurave nga zhvillimet e aktiviteteve komerciale te zhvendosura ne unazen e qytetit te cilat kontradikotjne forcimin dhe vitalitetin e aktivitetit komercial ne qender te qytetit.</p>
SHMANGIA E SHTRIRJES URBANE JASHTE KUFLJVE EKZISTUES TE ZHVILLIMIT		d+	+	+	+	+	0	+	0	0	0	d-	+	d+	<p>Ndikime akumulative: Efekte pozitive kumulative per mejdisin urban dhe lehtesimi i organzimit te aktiviteteve, eficenca ne energji nepermjet reduktimit te nevojës se transportit. Reduktim afat gjate te kostove per infrastrukturen dhe sherbimet bashkiake.</p>	2. Parandalimi i ndonje modifikimi te perdorimit dhe ndarjes se tokes tek zonat e percaktuara si zona bujqesore.
													<p>Ndikime sinergjike: Permiresimi i peisazhit do te kete ndikim sinergjik ne rritjen e industrise se turizmit dhe rritja e standarteve te jeteses per banoret aktuale.</p>			
													<p>Aktet korigjuese: Promovimi i planeve te detajuara urbane per te lehtesuar pjesmarrjes e popullsise dhe aktiviteteve tek zona e urbanizuar.</p>			

Tabela 3.1- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë

Tabela 3.1- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë																
POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN	
1														<p>Komente: Ripyllëzimi i kodrave përreth qytetit është pozitive për qytetin në drejti të përmirësimit të cilësisë së jetës së banorëve, shëndetit publik, peizazhit dhe imazhit urban si dhe për turizmin ditor.</p>	1.Përgatitja e një programi për ritmin e mbjelljes, llojin e pmëve për zonat që do të ripyllëzohen	
														<p>Efekte anesore: Ripyllëzimi do të mënjanojë fenomenin e erozionit të tokës dhe degradimin e mëtejshëm të saj, do të sjellë përmirësim të cilësisë së tokës, do të rrisë hapëirën e gjelbër në Bashki dhe do të sjellë një përmirësim të cilësisë së ajrit në zonë. Gjithashtu do të sjellë një rritje të pranisë së shërbimeve turistike në afërsi të korave.</p>	2.Të sigurohen fonde për një një shërbim ruajtje të vazhdueshëm në zonat e pyllit më të frekuentuara nga vizitorët për shmangjen e dëmtimeve të natyrve të ndryshme që mund të vijnë nga aktivitetet e ndryshme.	
	RIPYLLËZIMI I KODRAVE TË MORAVËS	+	d-	+	0	+	0	0	0	+	0	+	0	+	<p>Ndikime kumulative: Realizimi i këtij objekti do të sjellë një rritje në vite të biodiversitetit, të cilësisë së ajrit, të zonave ku mund të argëtohen fëmijë dhe të rritur si dhe do të ndikojë në vitë.</p>	3.Të mërren masa përmes hartimit projektesh për të ndihmuarshkrimin e biodiversitetit sidomos të llojeve të rrezikuara
														<p>Ndikime sinergjike: Përmirësimi i imazhit të qytetit, duke e bërë atë më tërheqës për turistët, do të sjellë një rritje në numrin e bizneseve, të aktiviteteve si dhe rritje të punësimit në zonë.</p> <p>Aktet korrigjuese: Rritja e ndërgjegjes qytetare përmes fushatave të iniciuara nga Bashkia dhe shoqëria civile për mbrojtjen e mjedisit në zone, hartimi i rregulloreve efikase dhe të lexueshme në vende të posacme.</p>	4.Duhen përcaktuar zonat ku mund të lëvizin njerëzit për të evituar dëmtimet që mund të ndodhin nga papërgjegjshmëria qytetare	

Tabela 3.2- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë (vazhdim)

	Tabela 3.2- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë (vazhdim)													KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN		
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13				
2	POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE													<p>Komente: Përmirësimi qasjes ndaj transportit do te ketë një ndikim pozitiv në mjedisin urban, organizimi i aktiviteteve ekonomike dhe treguesit e zhvillimit socio-ekonomik të qytetit. Qyteti do të bëhet më pak lodhës dhe më tërheqës për vendndodhjen e aktiviteteve dhe për banorët urban.</p> <p>Efekte anesore: Efekti më pozitiv vjen në cilësinë e ajrit në qytet për shkak të rehabilitimit të rrugëve, uljes së qarkullimit pasiv të makinat, për shkak të reduktimit të gjatesise si dhe pakësimit të ndotjes akustike. Pqercaktimi i korsive për biçikleta dhe këmbësorë do të rrisë përdorimin e biçikletave dhe do i shtyjë banorët të kryejnë aktivitete fizike.</p>	<p>1. Plani per mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve duke u fokusuar në zonat informale që do të kërkojnë planifikim të detajuar i cili do të sigurojë alokimet e duhura për të drejtat e rrugës.</p>		
	<p>PERMIRESIMI I TRANSPORTIT BRENDA QYTETIT DHE LIDHJEN MIDIS PJESEVE TE NDRYSHME, KRIJIMI I RRUGEVE PER BICIKLETA DHE TROTUARE PER KEMBESORET.</p>															<p>Ndikime kumulative: Përmirësimi i cilësisë së jetës është pozitiv për njerëzit, shëndetin. Eliminimi i konflikteve të krijuara nga përzierja e flukseve të trafikut dhe vizitorët lokal trafikut. Reduktimi i aksidenteve dhe rritjen e sigurisë rrugore duke e bërë qytetin më të sigurt dhe shoqëror. Përmirësimin e përdorshmërisë së hapësirave publike do të ketë një efekt pozitiv kumulativ në jetën sociale dhe në ndërveprimet ndërmjet banorëve urban.</p>	<p>2.Kontroll të rreptë të ndërtimit në afërsi të korridoreve turistike, të tilla si zonën e Kodrave te Moravës.</p>
																<p>Ndikime sinergjike: Njohja e qytetit si një qendër për turizmin rajonal, do të çojë në tërheqjen e banorëve të rinj, që do të çojë në rritjen e nevojave të strehimit. Mundësitë e transportit te qytetit dhe projektet e "zbukurimit" te qytetit do të tërheqë më shumë turistë, kështu që ka një ndikim synergjik mbi rritjen e biznesit të turizmit dhe përmirësimin e jetesës për banorët.</p>	<p>3.Transferimi i stacionit të autobusëve në afërsi të hyrjes së qytetit, në rrugën që vjen nga Tirana.</p>

		Aktet korigjuese: Planifikimin e transportit në lidhje me aksesin e vendeve tërheqëse, zhvillimi i parkimit për vizitorët dhe të biznesit, monitorimi i ngushtë i ndërtimit në afërsi të korridoreve turistike.	4.Studimi i veçantë për transportin/parkimin/shkarkimin e mallrave e menaxhimin e qarkullimit të vizitorëve në lidhje me funksionin e Pazarit të Korçës.
--	--	--	--

Tabela 3.3- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë (vazhdim)

Tabela 3.3- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë (vazhdim)																
POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN	
3														<p>Komente: Krijimi i një rrjeti të integruar hapësirash të hapura e të gjelbërta do të përfshijë kodrat e Moravës, Parkun Rinia, Kompleksin sportiv Skënderbeu, hapësirat e vogla në lagje, zonat informale si dhe hapësirat e reja të planifikuara nga PPV, duke siguruar një tërësi me koridore të gjelbra, promovimin e biçikletave dhe këmbësorëve zonave.</p>	Nuk ka	
														<p>Efekte anesore: Zbatimi i këtij investimi strategjik të PPV do rrisë sipërfaqet e gjelbërta dhe ato të hapura, do të ndihmojë në krijimin e koridoreve të gjelbërta në qytet dhe në zonat</p>		
	KRIJIMI I RRJETIT TE HAPESIRAVE TE GJELBRA	+	0	+	0	+	0	d+	0	+	0	d+	0	+	<p>Ndikime kumulative: Tërësia e ndryshimeve në hapësirat e hapura dhe to gjelbërta do të ndikojnë në ndryshimin e mikroklimës.</p>	
														<p>Ndikime sinergjike: Në një periudhe afatgjatë do të sjellë përmirësimin e cilësisë së ajrit në qytet dhe rritjen e biodiversitetit</p>		
													<p>Aktet korigjuese: Ky proces të realizohet paralelisht me ndërtimin e sistemit kullues.</p>			

Tabela 3.4- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë (vazhdim)

	Tabela 3.4- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë (vazhdim)													KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13		
4	POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE													<p>Komente: Projektet që lidhen me rehabilitimin e vendgrumbullimit të mbetjeve urbane janë realizuar pjesërisht dhe tentojnë ta zgjidhin atë përfundimisht, pra përmes kthimit në park të gjelbër dhe qendër rehabilitimi dhe depozitimin e mbetjeve në landfillin e rajonal të Maliqit. Po ashtu edhe sistemi i grumbullimit do të drejtohet në grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.</p> <p>Efekte anesore: Përfundimi i këtyre projekteve do të ketë efekte anësore që lidhen me rritjen e sipërfaqes së gjelbër, përmirësimin e cilësisë së jetesës, se ajrit, shëndetit publik</p>	1. Fushata dhe iniciativa konkrete për pastrimin e qytetit nga mbeturinat;
	REHABILITIMI I VENDEPOZITIMIT TË MBETJEVE DHE MENAXHIMI I HEDHJES SË MBETJEVE														
														<p>Ndikime sinergjike: Prania në të ardhmen e industrive përpunuese të mbetjeve mund të ndikojë negativisht në cilësinë e ajrit përmes clirimit të gazrave. Përzgjedhja e teknologjive duhet të bëhet me kujdes dhe mundësisht nga prania e këtyre industrive të mund të përfitohet në energji duke ndikuar edhe në shtiimin e vendeve të punës</p> <p>Aktet korigjuese: Plan për menaxhimin e materialeve inerte duke i paraprirë këtij fenomeni ; Studim fizibiliteti për zhvillimin e qendrës së riciklimit</p>	3. Paraprakisht krijimin e një programi bashkiak riciklimi dhe zhvillimin e një qendre përzgjedhje manuale

Tabela 3.5- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë (vazhdim)

Tabela 3.5- VLERËSIMI I VSM KOMPONENTI I III-të : Plani strategjik i investimeve në infrastrukturë (vazhdim)															
POLITIKA, PROGRAME, PROJEKTE	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	KOMENTE/AKTE KORRIGJUESE/EFEKTE ANËSORE/AKUMULATIVE, SINERGJIKE, EFEKTET AFATSHKURTRA/MESME DHE GJATË	MASA PËR PARANDALIMIN, REDUKTIMIN, NDIKIMET ZBUTËSE PËR MJEDISIN DHE SHËNDETIN
5														<p>Komente: Plani parashikon investime në drejtim të përmirësimit të sistemit të kullimeve në Korçë dhe ai do të vijojë me ndarjen e sistemit të kanalizimeve nga sistemi i kullimeve, duke ndërtuar një sistem të ri kullimi nën tokë. Kjo do të realizohet në përputhje me tipografinë e tokës, pjerrësisë etj.</p> <p>Efekte anesore: Sistemimi i këtij rrjeti do sjellë një rritje të sigurisë për cilësinë dhe shmangien e ndotjeve të ujërave nëntokësore, reduktimin e përbytyjeve sidomos në zonat e sheshta dhe reduktimin e aromave të këqija në zona të ndryshme të qytetit</p>	
														<p>Ndikime akumulative: Do ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës, shëndetin publik. Po ashtu ujërat e sistemuara do të mund të përdoren për qëllime ujëtyje dhe do të lehtësojnë funksionimin e impiantit të ujërave të zeza</p>	1. Të mbahet parasysh në realizimin e këtij elementi të PPV tendenca e zhvillimit dhe diferencimet për zona rezidenciale dhe ato industriale
	SISTEMI KULLIMIT	0	+	+	d+	d+	d+	0	0	d+	d-	0	0	0	<p>Ndikime sinergjike: Përfundimi i sistemit të kullimit do të sjellë një përmirësim të cilësisë së ajrit në zonat ku kanalet janë të hapura, dhe do të displinojë trajtimin e ujërave. Do të ndikojë pozitivisht në reduktimin e fenomenit të erozionit të tokës Ndërtimi i këtij sistemi do të sjellë një rritje të punësimit.</p> <p>Aktet korigjuese: Ky sistemim duhet të koordinohet më zhvillimin e zonave të gjobërta dhe ato të hapura si dhe me standardet e planifikimit urban për zonat informale dhe ato të reja</p>

5.3 Vlerësim i detajuar i efekteve të pritshme mjedisore nga zbatimi i planit lokal dhe masat parandaluese/zbutëse

Gjatë procesit të vlerësimit të alternativave të ndryshme të skenarëve të zbatueshëm, kemi identifikuar disa efekte pozitive dhe negative, të cilat mund të ndikojnë në zbatimin e planeve.

Bazuar në skenarin e preferuar, analizën e detajuar të komponentëve të tij dhe metodologjinë e vlerësimit të detajuar, të paraqitura në kapitullin e mëparshëm, puna e kryer nga konsulentët e VSM-së u fokusua në identifikimin e ndikimeve negative. Parashikimi i ndikimeve negative, efekteve sinergjike dhe kumulative të komponentëve të ndryshme të planeve, dhe përpunimin e zgjidhjeve zbutëse, që është dhe përmbajtja kryesore e tabelave të mëposhtme të vlerësimit të detajuar.

Prioritizimi dhe zgjidhja e ndikimeve negative është një proces i përpunuar dhe i komplikuar, i cili është thjeshtuar pjesërisht nga teknikat e matricës së përdorur. Është e nevojshme të përmendim në këtë pikë, që ndikimet në këtë fazë të vlerësimit janë të lidhura kryesisht me kushtet mjedisore dhe të jetesës së banorëve, që kanë të bëjnë me kriterin, si rrjedhim vlerësimi të çon në propozime për parandalimin dhe zbutjen, të cilat duhet të zbatohen në mënyrë paralele ose në disa raste përpara zbatimit të komponentëve të planit urban. Indekset e monitorimit që do të paraqiten në kapitullin e ardhshëm janë gjithashtu rrjedhojë e njohjes së kriterëve të përmendura më lart, dhe nevojës për të ndjekur efektet e zbatimit të planit me kriteret dhe objektivat specifike të përcaktuara ose nga vetë VSM-ja, ose legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar, të përmendura në kapitujt e mëparshëm.

Ashtu si vlerësimet e ndikimit në mjedis të projekteve të veçanta, rezultatet e planit lokal të VSM - së janë të detyrueshme për vendimmarrësit dhe të paraqesin bazën kryesore për gjykimin e tyre, në pranimin në aspektin mjedisor të Planit, si dhe masat korrigjuese që ata duhet të vlerësojnë, të marra para ose gjatë zbatimit të tij. Rekomandimet janë propozuar nga ekspertët e VSM-së dhe bazohen në metodat analitike apo krahasime empirik me situata të ngjashme të zhvillimit, që janë hasur në të kaluarën. Është i pashmangshëm parashikimi në plan i shumë aspekteve për shkak edhe të statusit (të tilla si ato ekonomiko - sociale) dhe të statusit të veçantë, përcaktuar në aspekte të tjera (të tilla si planifikimi urban, sipërfaqja e mbulimit të parcelës, koeficientët e ndërtimit etj.), kështu është e pamundur të përcaktohet aspekti sasior i pasojave negative. Ekspertët propozojnë një paketë korrigjuese dhe zbutëse dhe sugjerojnë një monitorim të vazhdueshëm që do të çojë në minimizimin e pasaktësive në këtë fazë. Kështu hapat e mëtejshëm të pranimin, të vlerësimit të detajuar të mëposhtëm, nga vendimmarrësit e qytetit, është të planifikojnë dhe propozojnë masat korrigjuese dhe zbutëse, si administrativisht dhe financiarisht, si

dhe për të vendosur sistemin shtëpiak, të ndjekura nga plani dhe VSM - ja, e cila do të paraqitet e detajuar në kapitullin e monitorimit.

Në përfundim, sugjerimi kryesor për vendimmarrësit, pas leximit të matricave të këtij kapitulli, është për :

- a. planin e veprimeve të korigjimeve (plani urban dhe masat administrative);
- b. planifikimin për nevojat për investime për të redaktuar efektet negative;
- c. prioritetet për projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe veprimet e propozuara për korrektimin.
- d. përgatitjen e strukturës administrative për ndjekjen e VSM-së, dhe integrimin e rekomandimeve përfundimtare të pranuar në rregulloren e tyre, si dhe në punët përkatëse të zhvillimit.

6

Vlerësimi i përgjithshëm i sistemit të PPV-Monitorimit

6.1 Vlerësim i përgjithshëm

Zbatimi rigoroz i Planit të paraqitur do të sjellë ndikime të rëndësishme në të gjitha aspektet në Bashkinë Korçë. Ndikimet do të vlerësohen edhe përmes realizimit të 13 objektivave të VSM të përcaktuara më sipër. Vlerësimi i këtyre objektivave do të mund të bëhet përmes një sistemi monitorimi, i cili do të ndjekë ecurinë e tyre gjatë gjithë kohës që shtrihet zbatimi i këtij Plani shumë të rëndësishëm për këtë Bashki. Përputhja e objektivave të VSM me zhvillimin e aktiviteteve të gjithanshme dhe shumëllojshme ekonomike –sociale është një moment i rëndësishëm për mjedisin dhe shëndetin publik. Bujqësia, industria e veshjeve, ajo e pijeve sikurse edhe ajo e ndërtimit, turizmi me shërbimet e tij por edhe elementë të tjerë të lidhur me to, si trafiku, cilësia e karburanteve dhe e automjeteve të transportit, duhen monitoruar në mënyrë rigoroze nga institucionet përkatëse. Realizimi i këtyre projekteve dhe plotësimi i objektivave të VSM do të sjellë një përmirësim në jetën e banorëve dhe të të ardhurve si në infrastrukturë, mjedis, shërbime dhe për shëndetin publik përmes rritjes së cilësisë së ajrit, ujit të pijshëm etj.

Vlerësimi dhe monitorimi në tërësi i masave dhe projekteve të parashikuara lidhet ngushtë edhe me potencialet turistike të Bashkisë Korçë, duke pasur në konsideratë këtu Korçën si një bazë të rëndësishme turistike edhe për zonat përreth me potencialistik si Voskopojë, fshati Dardhë etj.

Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të Planit me të gjithë elementët e tij të lidhur me mjedisin dhe shëndetin publik, janë një sfidë e re për administratën e kësaj Bashkie.

Mungesa e një eksperience në këtë drejtim si dhe mungesa e kapaciteteve njerëzore për të bërë të mundur vlerësimin dhe monitorimin nxjerr në pah një nga vështirësitë për plotësimin e këtij procesi dhe e bëjnë të domosdoshme shtimin e kapaciteteve dhe të specialistëve të mjedisit në këtë Bashki, pavarësisht pranisë së Agjencive të Mjedisit. Kërkesat bashkëkohore kërkojnë një staf të ngritur dhe me njohuri të qëndrueshme i cili do të mundësojë ngritjen e një sistemi, i cili duhet të realizojë një përputhje të kërkesave kombëtare dhe ndërkombëtare me ato rajonale si dhe të parashikojë edhe kërkesat që mbase për momentin mund të duken si jo realiste. Sigurisht që mungesa e një administrate të specializuar do të shtonte mundësitë e mosplotësimit të kushteve për realizimin e objektivave të VSM dhe mbase do të conte në një shmangie të detyrimeve nga ana bizneseve dhe aktiviteteve të tjera në respektimin e rregullave dhe normave të përcaktuara me ligj.

Niveli profesional i ekspertëve të Bashkisë dhe sistemi i monitorimit që do të ngrihet, i cili përmban objektiva të qarta, do të sigurojnë implementimin e Planit dhe paralelisht do të përcaktojnë edhe masat e detajuara të impaktit. Sistemi i monitorimit të VSM mund të rezultojë nga mjaft i thjeshtë në mjaft i ndërlikuar, të dyja këto duke u bazuar si në të dhënat e grumbulluara deri më tani e deri tek mjetet e monitorimit dhe metodologjia.

Sidoqoftë sistemi është mjaft elastik dhe mund të bëhet mjaft i ndërlikuar kur flitet për mjetet dhe monitorim përmes matjesh konkrete si cilësia e ajrit, e ujit etj por edhe mjaft i thjeshtë kur është fjala për monitorime për plotësim të disa kushteve për industrinë, bujqësinë etj. Prandaj eksperti ka ngritur një sistem që është i bazuar kryesisht në të dhënat që janë gjetur dhe grumbulluar nga administrata aktuale për fusha të ndryshme, nga të dhëna në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, sidomos në strategjitë kombëtare dhe evropiane, si dhe në raportet dhe të kërkimet e realizuara për Planin duke marrë parasysh këtu edhe mundësitë për ekspertë dhe të aftësive të tyre. Kjo në stadin aktual nuk është e lehtë pasi kërkon një përputhje midis realizimit të Planit dhe plotësimit të objektivave të VSM, megjithatë nëpërmjet disa dokumenteve bazë ekspertët janë munduar, bazuar edhe në eksperiencën e mëparshme në të tilla studime në Shqipëri dhe në vende të tjera, për të krijuar një metodologji monitorimi që të mundësojë ndjekjen e vazhdueshme të zbatimit të Planit duke marrë parasysh edhe mungesën e kapaciteteve të specializuara në administratë.

6.2 Sistemi i monitorimit

Numri i madh i investimeve që parashikohet që do të realizohen në këtë Bashki përmes zbatimit të këtij Plani si dhe perspektiva e zhvillimit të aktivitetit ekonomik në hapësirën e saj bëjnë të domosdoshme monitorimin e këtij zhvillimi. Ky monitorim

duhet të mbulojë të gjithë aspektet e jetës që lidhen me mjedisin dhe shëndetin e popullatës pasi ndikimi i këtyre aktiviteteve do të jetë i gjithanshëm, pra me efekte pozitive dhe negative. Kjo e bën të domosdoshme ngritjen e një sistem monitorimi me mjete dhe synime të qarta për të ardhmen. Përmes këtij monitorimi i cili, mund të jetë i vazhdueshëm për disa nga parametrat dhe periodik për disa të tjerë, do të mundësohet më së paku paralajmërimi në kohë i efekteve negative të zbatimit të një projekti duke iu dhënë mundësi autoriteteve përkatëse të marrin masat e nevojshme për t'i zbutur ato apo për t'i parandaluar. Monitorimit do t'i vijë në ndihmë edhe raportet e parashikuara nga ligji për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) lidhur me çdo aktivitet. Përgjegjësia e hartimit të këtyre Vlerësimeve është e madhe për ruajtjen mjedisit dhe të shëndetit të popullatës, prandaj ato duhet të kryhen dhe të pranohen konform legjislacionit. Në kushtet e mungesës së një praktike të konsoliduar në të kaluarën si dhe të mungesës së mjeteve por edhe të personelit të specializuar, Bashkia një pjesë të këtyre monitorimeve mund t'i kryejë edhe përmes të tretëve.

Sidoqoftë, duke pasur parasysh këto vështirësi pjesërisht objektive, konsulenti ka menduar për vendosjen e një numri indikatorësh që do të përbënin dhe bazën e sistemit të monitorimi. Gjetja dhe përcaktimi i indikatorëve dhe monitorimi i tyre në kohë do të mundësojë edhe mbajtjen nën kontroll të gjithë parametrave bio-shëndetësor, do të vendoste përpara përgjegjësish të gjithë aktorët kryesorë për zbatimin e një projekti dhe nuk do të lejonte një projekt të vazhdonte në kundërshtim me synimet e përcaktuara përmes këtyre indikatorëve. Indikatorët mund të jenë të drejtpërdrejt, kur është e mundur, dhe të tërthortë. Kufijtë e vlerave të tyre do të përcaktohen nga vlerat e lejuara në shkallë kombëtare, ndërkombëtare apo edhe në mënyrë subjektive. Përcaktimi i kufijve të lejuar do ta bënin zbatimin e VSM më të thjeshtë, praktik dhe të mundur.

Në përgjithësi mund të themi se nevojitet një kuadër dhe qasje për monitorimin e Planit por edhe të projekteve të tjera, të cilat do t'i mundësojë autoriteteve dhe grupeve të interesit monitorimin dhe vlerësimin e:

- a) Impakteve apo ndikimeve mbi mjedisin si rezultat i projekteve të parashikuara nga Plani si dhe aktivitetit ekonomik në rritje
- b) Afateve kohore që duhet të synohen nga autoriteti lokal dhe ai qendror mbi bazë të strategjive për mbajtjen brenda vlerave të përcaktuara nga ligji
- c) Realizimin e objektivave të përcaktuara nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor
- d) Paralajmërimin në fazë të hershme në rast të efekteve negative të parashikuara duke ofruar mundësinë për veprime korigjuese të përshtatshme
- e) Transparencën e nevojshme për publikun

Gjithashtu përmes monitorimit mund të kontrollohen edhe Autoritetet përgjegjëse të caktuara për realizimin e objektivave dhe zbatimin e ligjshmërisë.

Sistemi i indikatorëve të monitorimit, i qëllimeve dhe metodave të matjes do të paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Ekspertët që do të realizojnë këto monitorime, të cilët do jenë të fushave të ndryshme, duhet që në mënyrë periodike sipas një marrëveshje paraprake midis të gjitha palëve të interesuara (përfaqësues të pushtetit lokal dhe qendror, specialistë të mirëfilltë, përfaqësues nga banorë etj) të paraqesin në formën e një raporti rezultatet e monitorimit. Raporti i përgatitur duhet t'i paraqitet Këshillit Bashkiak dhe do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme me qëllim për të siguruar një paralajmërim në kohë të përshtatshme. Kur specialistët apo përfaqësuesit hasin në raste të një dëmtimi serioz të mjedisit meqenëse nevojitet një ndërhyrje energjike mund të provokohet një raportim edhe jashtë radhe. Në rastin më të përgjithshëm raporti duhet që minimalisht të paraqitet një herë në vit. Përmes raportit të monitorimit krijohet mundësia që të vendoset një sistem referimi lidhur me gjendjen e mjedisit duke gjykuar kështu për shkallën e përmirësimit apo të përkeqësimit të tij. Sigurisht ky vlerësimin do të lidhet ngushtë me objektivat VSM, parametrat kombëtare dhe ndërkombëtare të monitorimit.

Është e rëndësishme që procesi i monitorimit të VSM dhe ai i zbatimit të Planit duhet të bëhen paralelisht. Përmes këtij procesi ekziston mundësia që Shqipëria të përshtatë edhe më tej standardet e saja me ato të BE që mund të kushtëzohen nga marrëveshje ndërkombëtare të reja (p.sh për cilësinë e ajrit, objektivat për klimën dhe efektin serrë etj), duke bërë kështu të mundur që sistemi i monitorimit të përmirësohet me këto objektiva të reja. (si dhe arritje të tjera të rëndësishme).

Duke i marrë në konsideratë të gjithë parametrat mjedisorë dhe shëndetësorë, strategjitë mjedisore kombëtare dhe konventat ku Shqipëria bën pjesë si dhe bazuar mbi një logjikë normale qytetare do të paraqesim synimet për të ardhmen në Bashkinë Korçë.

a) Monitorimi i ujërave

➤ Uji i pijshëm

Monitorimi i ujit të pijshëm në Korçë është mjaft i rëndësishëm sepse lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shëndetin e popullatës. Korça ka një furnizim me ujë të pijshëm nga më të mirët në Shqipëri si përsa i përket burimeve, kohëzgjatjes (24 orë) ashtu edhe për rrjetin e shpërndarjes dhe sasisë për banorë(direktiva 11 evropiane për

ujin është 200l/d/b), por investimet e reja dhe rritja e aktiviteteve ekonomike kërkojnë një monitorim nga ana e autoriteteve përkatëse për ta ruajtur këtë cilësi të shërbimit në Korçë. Gjithashtu, bazuar edhe në sugjerimet e specialistëve të UKKO duhet që zona e puseve që furnizojnë me ujë qytetin e Korçës të mbrohen me një status si “zonë sanitare” (Ligj Nr. 8093, 21.3.1996).

Ujësjiellësi monitorohet çdo dite nga ana e drejtorisë duke marre mostra uji në 16 pika, nga të cilat 15 pika janë fikse dhe 1 pikë është e lëvizshme sipas njoftimeve që merren nga qytetaret. Ky monitorim bëhet paradite dhe pasdite. Sidoqoftë duke u bazuar në Direktivën Evropiane për Ujin e Pijshëm, uji i pijshëm duhet monitoruar përditë dhe në mënyrë të rregullt për rreth 48 parametra kimik dhe mikrobiologjik, ndërkohë që aktualisht këtu bëhet një kontroll periodik për një numër më të vogël elementësh. Po i njëjti monitorim duhet kryer edhe për 11 çezmat me vetërrjedhje dhe jo çdo tre muaj siç bëhet aktualisht.

Tabela 14- Synimet e ujit të pijshëm –Qyteti i Korçës		
Parametri	Vlerat aktuale (mg/l)	Synimet në zgjerim të rrjetit
		Norma kombëtare (mg/l)
pH		6,5-8,5
Cl i mbetur		>1 mg/l
NH ₄ ⁺		Maks 0,05
NO ₂ ⁻		>50
NO ₃ ⁻²		>5
CO ₂ ⁻²		>500
HCO ₃ ⁻²		>500
O ₃		
Fortësia gjermane		>20°

Tabela 15 Normat dhe synimet për cilësitë fiziko-kimike					
Nr	Indikatorët kimikë	Vlerat e monitoruara në Korçë	Standardet kombëtare	Vlerat maksimale të lejuara	Synimet për 2016 (CD 98/83/EC & tjetër)
1	Shija dhe aroma			2deg12 ⁰ C, 3 deg25 ⁰ C	I pranueshëm për konsumatorin; pa ndryshime jonormale
2	Ngjyra & paraqitja (mg/l shkalla Pt/Co)		1	20	I pranueshëm për konsumatorin; pa ndryshime jonormale
3	pH		6,5-8,5	9,5	≥ 6.5 dhe ≤ 9.5
4	Konduktiviteti elek. (μS/cm) 20°C		400		2500
5	Kalcium (mg/l)		75	200	200
6	Pezulli të ngurta mg/l)				0

7	Turbiditeti (FTU)		0,4	4	S'ka afat
8	Alkaliniteti (mg ekv/l)			x	pH i pranueshëm
9	Karbonatet (mg/l)				250
10	Bikarbonate (HCO ₃ ⁻) (mg/l)		H ₂ O CaCO ₃	x	pH i pranueshëm
11	Amoniak (mg/l)		0	0,05	0.50
12	Nitrite (mg/l)		0	0,05	0.5
13	Nitrate (mg/l)		25	50	50
14	Fortësia (°dH)			20	36-71
15	Fosfate (mg/l)		0,4	2,5	2.5
16	Lënda Organike (mg/l)		1	3	3
17	Kloride (mg/l)		25	200	250
18	Sulfate (mg/l)		25	250	250
19	TDS (mg/l)		500		≤1500
20	Magnezium (mg/l)		20	50	0.05

Tabela 16.- Indeksi mikrobiologjik i ujit të pijshëm Bashkia Korçë					Synimet për 2015
Nr	Indeksi Mikrobiologjik	Klorinimi në burim	Vlerat në Bashki	Standardet kombëtare ml/ujë	C D 98/83/EC ml/ujë
1	E. Coli			0/100	0/250
2	Strept			0/100	0/250
3	Pseudomonas aeruginosa			X	0/250
4	Koloni në 22°C			X	100/ml
5	Koloni në 37°C			X	20/ml

➤ Lumenjtë

Lumi i Drenicës dhe i Dunavecit përpara shumë vitesh kanë qenë problematik pasi gjatë vërshimit përmytnin zonat përreth, ndërsa në kohën e sotme niveli i ujërave të tyre ka rënë dhe nuk paraqesin asnjë problem në këtë drejtim për qytetin e Korçës.

Gjendja aktuale e këtyre lumenjve paraqitet e kërcënuar nga zhvillimi i aktiviteteve industriale dhe nga hedhja e mbetjeve të ndryshme duke krijuar probleme me ujitjen e tokave dhe aromave të këqija sidomos në lagjet 15, 16 dhe 17 të Korçës. Edhe banorë të Turanit, në afërsi të të cilit gjenden pusët e ujit të pijshëm që furnizojnë qytetin, ankohen se përveç erës së keqe, u janë ndotur rrugët dhe tokat dhe për më keq, u kanë ngordhur bagëtia. Monitorimi në vazhdimësi dhe hartimi i një *Plan Veprimi për Menaxhimin e plotë të vijës rrjedhëse të këtyre lumenjve është një domosdoshmëri për tu synuar brenda vitit 2016*. Brenda këtij kufiri kohor duhet që Bashkia të sigurojë burime ujore për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbra që nuk janë lidhura me ujin e pijshëm.

b) Monitorimi i Tokës, synimet

Monitorimi i tokës në Bashkinë e Korçës është i një rëndësie të vecantë për vetë sipërfaqen e saj të madhe dhe shumëllojshmërinë e saj, kryesisht 75% tokë kodrinore dhe malore. Toka bujqësore kërcënohet nga presioni i ndërtimeve informale si dhe nga ato formale duke e zvogëluar sipërfaqen e saj si dhe duke mos u kultivuar për një periudhë relativisht të gjatë rrezikon të varfërohet. *Nevoja për rehabilitimi të tokës bujqësore është prioritare dhe duhet të shoqërohet me masa teknike të njohura.* Problematike paraqitet situata e tokës dhe në ish zonat industriale, toka pranë zonës së vend grumbullimit të mbetjeve si dhe ajo pranë kanaleve të hapura të ujërave të patrajtuara. Është e domosdoshme që këto toka t'i nënshtrohen një *plani veprimi për rehabilitimin* e tyre përpara se ato të marrin një destinacion të ri.

Po ashtu sipërfaqe të tëra pyjore janë dëmtuar sidomos në vitet '90 duke rrezikuar edhe më tej fondin pyjor. Hartimi dhe zbatimin i një *Plani Veprimi për mbrojtjen e tokës nga erozioni* është i nevojshëm për të parandaluar dhe rehabilituar terreni i dëmtuar.

Në tabelën e mëposhtme jepen disa nga synimet për treguesit e tokës në Bashkinë Korçë.

Tabela 17 : Shpërndarja e përdorimit të tokës në Qarkun e Korçës dhe synimet					
Emri	Sipërf. totale (ha)	Sipërf. e kultiv (ha)	Sipërf. pyjore (ha)	Kullota(ha)	Të tjera (ha)
Korça	172,478	44,207	54,900	23,604	49,767
Synimi 2018 (rritje në %)	-	+20%	+10%	+10%	-20%

Monitorimi i këtyre hapësirave do mund të realizohet përmes sistemit GIS të koordinatave që shoqërojnë Planin.

c) Cilësia e ajrit dhe standardet

Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë ka shumë vjet që bën monitorimin e ajrit në qytetin e Korçës. Problematike për qytetin e Korçës kanë qenë dhe mbeten gazrat që çlirohen nga djegia e druve të zjarrit për ngrohje në sezonin fund vjeshte – pranvere. Të tillë gazra si gazi karbonik, monoksidi i karbonit, gazi metan, etj, do të monitorohen në vazhdim. Po ashtu edhe cilësia e karburanteve dhe e automjeteve ndikon për keq në cilësinë e ajrit në bashki. Rezultatet në 5 vitet e fundit jepen në tabelën e mëposhtme. Në dy vitet e fundit 2011 dhe 2012 monitorimit të cilësisë së ajrit i janë shtuar edhe parametra të rinj si tolueni, benzeni etj. Zhvillimet e ardhshme në hapësirën e kësaj Bashkia e bëjnë të domosdoshëm monitorimin dhe mbajtjen brenda normave të përcaktuara nga Direktiva 2008/50/EC për cilësinë e ajrit si dhe ato të ligjit Shqiptar 8897 16.05.2002 për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

Me rëndësi është ruajtja e disa ndotësve në vlerat e lejuara si dhe ulja e disa të tjerëve të cilat janë mbi normat e lejuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Në tabelat e mëposhtme po japin llojin e ndotësve që duhen monitoruar dhe vlerat e lejuara, brenda të cilave ato duhet të mbahen pavarësisht zhvillimit ekonomik apo rritjes së automjeteve etj, në hapësirën e Bashkisë Korçë.

Monitorimi në të ardhmen duhet të bëhet me metoda më të avancuara, të bëhet në varësi të sezonit me një shpeshti të caktuar. Në tabelat e mëposhtme tregohen edhe mënyra dhe ndotësit që duhen monitoruar dhe se si duhen monitoruar.

Tabela 18- Ndotësit e ajrit që duhen monitoruar në Bashkinë e Korçës			
NDOTËSIT	PËRQËNDRIM MAX. (I LEJUAR)	PERIUDHA MESATARE	VITI I SYNUAR PËR REDUKTIM
PM_{2.5}	25 µg/m ³	1 vit	1.1.2015
SO₂	350 µg/m ³	1 orë	Të ruhet
	125 µg/m ³	24 orë	Të ruhet
NO₂	200 µg/m ³	1 orë	Të ruhet
	40 µg/m ³	1 vit	Të ruhet
PM₁₀	50 µg/m ³	24 orë	1.1.2014
	40 µg/m ³	1 vit	1.1.2014
Plumbi (Pb)	0.5 µg/m ³	1 vit	Të ruhet
CO	10 mg/m ³	Mes ditore 8 orë	1.1.2013
Benzen	5 µg/m ³	1 vit	Të ruhet
Ozon	120 µg/m ³	Mes ditore 8 orë	1.1.2013
Arsenik (As)	6 ng/m ³	1 vit	31.12.2016
Kadmium (Cd)	5 ng/m ³	1 vit	31.12.2016
Nikel (Ni)	20 ng/m ³	1 vit	31.12.2016
Hidrokarbure policiklike aromatike	1 ng/m ³ (bazuar në përqendrimin e Benzo(a)pyrene)	1 vit	31.12.2016
PM_{2.5} Përqendrimi ndaj ekspozimit	20 µg/m ³ AEI (indikatori mesatar i ekspozimit)	Bazuar në mesataren e 3viteve	31.12.2018
LNP	80	1 vit	31.12.2015

Realizimi në periudhën e synuar të vlerave të mësipërme kërkon një punë shumë serioze nga ana e Bashkisë në të gjitha drejtimet, në konstatim, matje vlerësim dhe masa. Në përputhje me direktivat e BE Bashkia duhet të marrë masat për të siguruar transparencën lidhur me informacioni mbi cilësinë e ajrit për grupet e interesit dhe publikun.

c) Ndotja akustike

Bazuar në vlerat e monitorimi të zhurmave në Bashkinë Korçë (kapitulli 2) tregon se Korça në zona të caktuar paraqet shqetësime lidhur me nivelin e zhurmave. Një bashkëpunim i Bashkisë me të tretët, si p.sh ISHP apo vetë nga specialistët e mjedisit të licencuar, do të mundësonte një monitorim edhe më efikas të zhurmave, bazuar edhe në Ligjin Nr. 9774, datë 12.07.2007 “ Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” dhe VKM Nr. 587 datë 07.07. 2010 dhe udhëzimit përkatës.

Në këto zona mund të vendosen indikatorë të harmonizuar për nivelin e zhurmave në bazë të ligjit për ditën që zgjat 13 orë, prej orës 06.00 deri në orën 19.00; për mbrëmjen që zgjat 4 orë, prej orës 19.00 deri në orën 23.00; dhe për natën që zgjat 7 orë, prej orës 23.00 deri në orën 06.00 duke përcaktuar L_{dit} (niveli zanor ditë), L_{mbr} (niveli zanor në mbrëmje) dhe $L_{natë}$ (niveli zanor i natës) në mënyrë të veçantë për baret gjatë sezonit turistik veror, fabrikat si dhe për çdo lloj aktiviteti me burim zhurme. Gjithashtu zgjerimi i hapësirës së monitoruar është një tjetër synim apo objektiv që duhet të arritur për të siguruar një kontroll më të plotë dhe të gjerë në Bashki. Për të realizuar këtë duhen marrë masa të përshtatshme që të jenë në përputhje me parimet dhe objektivat kombëtare dhe ato ndërkombëtare e sidomos me Direktivën e Zhurmave në Mjedis 2002/49/EC.

Një detyrë tjetër, që buron nga zbatimi i ligjit, është edhe *hartëzimi i zhurmave* në Bashki e cila në të ardhmen do t'i bashkëngjitet edhe hartëzimin në nivel kombëtar.

d) Synimet për mbetjet

➤ Menaxhimi i mbetjeve urbane

Problematika e mbetjeve në Bashkinë Korçë mbetet problem shqetësues pavarësisht projekteve në zbatim të përmendura në kapitullin 2 (KFW dhe projekti i landfillin rajonal të Maliqit). Kjo problematikë lidhet ngushtë me a) mënyrën e grumbullimit të tyre në qytet, b) me ndërgjegjen e banorëve si dhe me c) vendgrumbullimin e tyre. Kontenierët shpeshherë janë të dëmtuar, dhe nuk janë për të realizuar një grumbullimin të diferencuar të mbetjeve gjë që nuk e favorizon riciklimin e mundshëm.

Në nivel qarku po zbatohet projekti rajonal “Studimi i fizibilitetit për menaxhimi i mbeturinave të ngurta në Shqipërinë Juglindore” nga konsorciumi gjermano-shqiptar, IGIP/IU/HUK. Ky projekt synon: i) të ngrejë një sistem modern mjedisor dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve në rajonin e Korçës; ii) të ngrejë fushën e parë sanitare të grumbullimit të mbetjeve në Shqipëri; iii) të zbatojë për herë të parë konceptin e menaxhimit të integruar të mbetjeve; iv) të japë shembullin e parë për

qeverisjet vendore, që bashkëpunojnë në rrugë institucionale për menaxhimin e mbetjeve.

Ligjin e ri Shqiptar mbi menaxhimin e mbetjeve hap mundësi të reja ekonomike lidhur me riciklimin e mbetjeve dhe sigurisht që kontribuon në zbatimin e tre parimeve të BE lidhur me reduktimin e sasisë së mbetjeve: 1. *Parandalimi të krijimit të mbetjeve*; 2. *Duke ndihmuar në riciklim dhe ripërdorim*; 3. *Duke përmirësuar grumbullimin final të mbetjeve dhe duke monitoruar*. Kjo qasje e re do të çojë në një përmirësim të gjendjes së mbetjeve në hapësirën e Bashkisë Korçë.

- **Parandalimi i krijimit të mbetjeve:** Është një faktor shumë i rëndësishëm në strategjinë e menaxhimit të mbetjeve, që fillon me masa konkrete si dhe duke ndërgjegjësuar bizneset dhe qytetarët. Bashkia duhet të synojë pakësimin e krijimit të sasisë së mbetjeve që në origjinë si dhe reduktimin e rrezikut që vjen prej tyre nga pakësimi i substancave të dëmshme, për pasojë edhe hedhja e grumbullimi i tyre do të jetë sigurisht më i lehtë.
- **Ndihmë për industrinë e riciklimit:** aprovimi i ligjit të ri për menaxhimin e mbetjeve nga ana e Qeverisë Shqiptare krijon hapësira për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve, për riciklimin e tyre pra do të rrisë interesin e industrisë së riciklimit. Kjo në mënyrë indirekte do të sjellë largimin dhe pastrimin edhe më të mirë të mjediseve publike .
- **Përmirësimi hedhjes së mbetjeve dhe monitorimi:** Një rritje e ndërgjegjes qytetare si për banorët ashtu edhe për bizneset do të mundësojë në përmirësimin e hedhjes së mbetjeve. Kryerja e fushatave publicitare dhe ndërgjegjesuese nga ana e Bashkisë në bashkëpunim me shoqërinë civile do të ishte një hap i rëndësishëm në këtë drejtim. Atje ku është e mundur, për mbetjet të cilat nuk mund të riciklohen dhe të ripërdoren ato duhet të dërgohen në incinerator dhe në mundësi të fundit në landfill. Të dyja këto mundësi kërkojnë një monitorim të thellë e të kujdesshëm pasi mund të sjellin dëmtime serioze për mjedisin.
- Një punë e mirë mund të kryhet për **shmangien e hedhjes së mbetjeve** buzë rrugës, nëpër lumenj apo kanale apo në çdo vend tjetër jo të destinuar për hedhje mbetjesh. Një synim i menjëhershëm duhet të jetë monitorimi i aktivitetit të ndërtimit, industrive prodhuese dhe turizmit.

Bazuar nga sa u përshkrua më sipër si edhe në strategjinë kombëtare të mjedisit, tabela e mëposhtme jep disa objektiva dhe synime kohore lidhur qasjen e përmendur me sipër.

Tabela 19- Synimet për reduktimin e mbetjeve		
Parimi	Synimi	Prej vitit
Parandalimi i krijimit të mbetjeve	Reduktimi i sasisë së mbetjeve me 10%	2014
Riciklim dhe ripërdorim	Mbledhje e diferencuar e mbetjeve në masën 80%	2016
Përmirësim i hedhjes së mbetjeve dhe monitorimi	Grumbullim dhe hedhje në landfill në masën 100%	2015
Shmangie të hedhjes së mbetjeve në vende jo të autorizuara	Për të gjitha mbetjet në masën 100%	2014

Realizimi i synimeve të mësipërme do të mund të realizohet përmes *vrojtimeve, raportit* të sasive totale përpunuara me ato të prodhuara, pakësimit të pikave të nxehta ekzistuese etj.

➤ Mbetjet ujore dhe ujërat e zeza

Strategjia Kombëtare e mjedisit dhe Ligji Nr115/2003, thekson se viti 2011 duhet të ishte viti i fundit për realizimin e sistemit të ujërave të ndotura dhe i vendosjes së impianteve për trajtimin e tyre. Korça është një nga qytetet e pakta në Shqipëri që e ka një sistem kanalizimesh të ujërave të zeza dhe urbane si dhe një impiant trajtimi të tyre. Sidoqoftë mbetet akoma për tu bërë në lidhje me *zonat informale* dhe ato *industriale* si dhe me *mbylljen e kanalizimeve të hapura* në zonat periferike dhe futjen e tyre në tubacione. Kërkesa ndaj bizneseve për *trajtimin paraprak* të ujërave të tyre mbetet një sfidë për të ardhmen.

Në tabelat e mëposhtme ekspertët kanë vendosur disa objektiva dhe synime të reja kohore, në mungesë të një synimi të ri në nivel kombëtar, për ujërat e ndotura dhe çështjet e lidhura me to.

Tabela 20- Synimet për reduktimin e ujërave të ndotura		
Parimi	Synimi	Prej vitit
Riciklim i ujërave dhe ripërdorim për qëllime ujitje	Riciklim dhe ripërdorim në masën 80%	2018
Përmirësim të kriterëve dhe procedurave për licencimet, ri-licencimet dhe monitorimet (industri & bujqësi)	Kritere të reja dhe monitorim në masën 100%	2015
Zonat e reja dhe ato informale (ujërat urbane & ujërat e zeza)	Mbulimi me rrjetin përkatës në masën 100%	2018

f) Monitorimi i hapësirave të gjelbra

Hapësirat e gjelbërta duke përfshirë këtu edhe kodrat përreth qytetit janë relativisht të shumta por që duhen monitoruar dhe shtuar edhe më tej për të arritur standardet ndërkombëtare. Gjithashtu shtimi i sipërfaqes së gjelbër do të krijojë mundësi më të mira për llojet e ndryshme të florës dhe faunës duke shtuar habitate të reja. Lidhur ngushtë me shtimin e sipërfaqes së gjelbër është edhe objektivi i tokës lidhur me rritjen e sipërfaqes pyjore. Lejet e reja të ndërtimit duhen kushtëzuar me krijimin e hapësirave të gjelbra përreth.

Tabela 21- Monitorim dhe shtim i sipërfaqeve të gjelbra		Synime
Parimi	Synimi	Prej vitit
Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra për m ² /banor	Rritje të sipërfaqes së gjelbër 30%	2014
Parandalimi i dëmtimit i hapësirave ekzistuese	Mbrojtja nga ana e Bashkisë përmes strukturave të sajë	2014

Monitorimi do të mund të bëhej edhe përmes sistemit GIS, hartëzimit etj.

g) Industria, turizmi, qendrat shëndetësore

Numri jo i vogël i bizneseve dhe i aktiviteteve që kanë ndikim mbi mjedis në Bashkinë Korçë janë një arsye për të kryer monitorimin dhe kontrollin mbi ta. Bashkia përmes strukturave të saj duhet të luajë një rol shumë të rëndësishëm së bashku me ARM në monitorimin e ndikimit të tyre në mjedis. Ri-licensimi dhe rinovimi i lejeve për këto industri është një proces i një rëndësie të veçantë dhe duhet të bëhet në respekt të ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse (udhëzim 3, Maj 2006 Ministria e Mjedisit, ligj për Vlerësim e Thelluar Mjedisor shtesa 1 Ligj 8990/2003). Po ashtu industria e turizmit duhet monitoruar sidomos porsa i përket shkarkimit të ujërave të ndotura dhe mbetjeve, në mënyrë të veçantë gjatë sezonit turistik. Po ashtu ndotjet spitalore duhen monitoruar me një kujdes të veçantë duke pasur parasysh rëndësinë e këtij spitali në rajon.

Tabela 22- Monitorimi i industrive etj		
Parimi	Synimi	Prej vitit
Parandalim i dhënies dhe rinovimit të licencave pa vendosjen e filtrave	100%	2013
Parandalimi dhe pezullim të dhënies se		

licencave për aktiviteteve tregtare(restorant, hotel etj) pa plotësim të kushteve	100%	2013
Detyrim për trajtim paraprak të mbetjeve ujore	80%	2014
Trajtimi mbetjeve spitalore në bazë të ligjit	100%	2015

Sigurisht që monitorimi është kompleks në këtë rast pasi përfshin shumë drejtime por ai mbete e vetme mënyrë për të mbajtur nën kontroll cilësinë e mjedisit në Bashki.

Në tabelat e mësipërme shpjegohet se si një numër monitorimesh dhe vlerësimesh është i nevojshëm gjë e cila kërkon dhe një seri sistemesh dhe metodash matjeje që duhen të zbatohen në zonë. Ndër më kryesoret mund të përmendim:

1. Sistemi i monitorimi GIS i PPV. Kjo do të monitoroje të dhënat hapësinore, parametrat peizazhit, pyjet, kullotat bregdetin, zhvillimi dhe pasqyrimi, hapësira të gjelbëria, zonën industriale
2. Matjet shkencore caktohen nga bashkia palëve të treta të specializuara, të tilla si cilësia e ujit të pijshëm, cilësia e ujit të detit, cilësia e ajrit, matje të cilësisë tokës
3. Metoda e gjetjes se të dhënave nga burimet ekzistuese brenda Bashkisë Korçë, ose regjistrat kombëtare, siç janë licencat e strehimit, të dhënat e popullsisë, urbanistikes, te dhënat studentëve dhe kompanive, të dhëna mbi pronësinë.
4. Hartimi i rregulloreve në përputhje me ligjin nga ana e Bashkisë për përdorimin e pesticideve, plehrave kimike etj.
5. Sondazhet bashkiake dhe statistikat mbi çështje që lidhen me kushtet e strehimit, kontrollet ndaj ndërmarrjeve për normat mjedisore qe duhen respektuar, sondazhe të pasurive natyrore të tilla si përrenj, lumenj etj.
6. Këshilli bashkiak dhe veprimet, investimet e vendimet administrative që zgjidhin ne mënyre përfundimtare, problemet kryesore mjedisore (p.sh. heqja e buxhetit te investimeve për vend-depozitimet e mbeturinave të pakontrolluara apo për vend-depozitime të reja), apo zhvillimin e fushatave ndërgjegjesuese, projekteve pilot mbi “energjinë e gjelbër”, për riciklimin,etj.
7. Kontrolli mbi aktivitetin e industrive si kontroll mbi përdorimin e filtrave, trajtimet paraprake të mbetjeve dhe ujërave të ndotura etj.

OBJEKTIVAT, INDIKATORËT, SYNIMET për VSM e BASHKISË KORCË

Nr. i OBJEKTIVIT TË VSM	FUSHAT KRYESORE & PARAMETRAT MJEDISORE	SYNIMET	INDIKATORËT	METODA E MATJES
<p><u>VSM 1</u> Cilësia e mjedisit 1 (cilësia e ajrit, klima, shëndeti publik)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Cilësia e jetës • Akses rrugor • Përmirësim të prodhimeve turistike- punësim • Shëndet publik • Cilësia e ajrit • Mjedis urban 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje vjetore të hapësirave të parkimit me 5% • Zhvillimi i 2-3 qendrave për parkim • Zhvillimi i rrugëve për biçikleta në akset rrugore kryesore deri më 2015 • Shmangia dhe reduktim te trafikut përreth qendrës historike të qytetit deri më 2016 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i vendeve për parkim • Km rrugë për biçikletat • Numri i rrugëve të reja transporti publik • Numri i pasagjerëve që përdorin rrugët e reja të transportit publik • Numri i çiklistëve që bëjnë vajtje – ardhje në punë në mënyrë të rregullt 	<ul style="list-style-type: none"> • Studime për trafikun dhe sondazhe • Një përditësim i sistemit GIS të PPV duke përfshirë të dhëna për trafikun etj. • Cilësia e ajrit
<p><u>VSM 2</u> Cilësia e mjedisit 2 (uji, toka, biodiversiteti, shëndeti publik)</p>	<p>Cilësia e jetës dhe kohezioni social</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kushtet e jetesës së popullatës • Masat për politikat për peizazhin • Larmia biologjike (biodiversiteti) 	<p>Kontroll mbi sipërfaqen tokës, cilësinë e saj përmes masave mbrojtëse ndaj pesticideve, ndërtimeve, landfillin ekzistues dhe shkarkimeve të industrive në kanalet drenimit dhe kullimit, ruajtjen e peizazhit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tabela e synimeve për ujin e pijshëm • Shtim i larmisë biologjike përmes zmadhimit të hapësirës së gjelbër me 	<ul style="list-style-type: none"> • Analizat e ujit të pijshëm në zona të ndryshme • Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta • Numri i industrive që trajtojnë ujërat • Analiza të tokës 	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i monitorimit GIS të PPV • Regjistrat e Bashkisë dhe sondazhet • Vrojtime specialistësh për biodiversitetin

		30% deri në 2015		
<p><u>VSM 3</u></p> <p>Cilësia e mjedisit 3 (peizazhi, natyra, toka, shëndeti publik)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Cilësia e jetës • Ripyllëzimi i kodrave, shmangia e erozionit të tokës • Rritje të biodiversitetit. • Përmirësim i cilësisë së ajrit 	<ul style="list-style-type: none"> • Shtim i numrit të fidanëve të mbjellura në kodrat përreth qytetit në përputhje me rritjen e synuar të sipërfaqes pyjore • Kontroll mbi përdorimin e pesticideve • Shtim i sipërfaqes së gjelbër nëpër rrugët e qytetit • Krijimi i korridoreve të gjelbërta 	<ul style="list-style-type: none"> • Shtim i numrit të llojeve dhe i sasisë së tyre • Matja e sipërfaqeve të gjelbërta • Vlerat e ndotësve të ajrit 	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi GIS i PPV • Vrojtime specialistësh të florës dhe faunës
<p><u>VSM 4</u></p> <p>Cilësia e Mjedisit 4 (uji, toka, ajri, shëndeti i njeriut)</p>	<p>Mangësitë e Menaxhimit te mbeturinave</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i padiferencuar i menaxhimit të mbetjeve • Vendgrumbullimi jo i përshtatshëm rrezikon shëndetin e njeriut dhe cilësinë e jetesës • Kushte të rrezikshme për shëndetin e popullatës • Kushtet e jetesës së popullatës 	<ul style="list-style-type: none"> • Asnjë vendgrumbullim mbetjesh informale deri më 2014 • Një reduktim i sasisë së mbetjeve me 10% deri më 2015 • Grumbullim i diferencuar deri në masën 80% deri më 2016 • Rehabilitim i plotë i vendgrumbullimit aktual të mbetjeve deri më 2020 • Trajtimi i mbetjeve ujore në masën 100% deri më 2018 	<ul style="list-style-type: none"> • % e ujërave të zeza të trajtuara në vend trajtimit sipas PPV • % e banesave në zonat informale që kanë gropa septike, • % e aktiviteteve industriale që kanë sistemin e tyre të përpunimit • % e gjatësisë së kanaleve që janë të menaxhuara në mënyrë të rregullt • Kontroll i cilësisë së ujërave të përrenjve • % e reduktimit të derdhjeve në kanale 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimet e administratës bashkiake • Sondazhet e Bashkisë, • Sondazhe monitoruese nga ana e shërbimeve bashkiake • Raporte vjetore për gjendjen e trajtimit të mbetjeve në Durrës

<p>VSM 5 Cilësia e Mjedisit 5 (njerëzit, ajri, uji, toka, shëndeti i njeriut)</p>	<p>Cilësia e jetës dhe Kohezioni shoqëror</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësim i imazhit të qytetit • Larmia biologjike dhe cilësia e ajrit • Mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor të popullsisë dhe aktiviteteve produktive • Kohezioni shoqëroro-ekonomik 	<p>Një fushatë ndërgjegjësimi në vit për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Grumbullimin dhe riciklimin e mbetjeve • Kurimin e energjisë • Rigjenerimin e tokës • Përdorim të biçikletave dhe transport publik <p>Një projekt pilot me kohëzgjatje 2-3 vjeçare për secilën nga çështjet e mësipërme</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i fushatave ndërgjegjësuese • Numri i projekteve pilot të zhvilluara • Numri i qytetarëve pjesëmarrës në projektet për ndërgjegjësimit • Numri i vendeve të punës të krijuara nga projektet e ndërgjegjësimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Raportet vjetore të programeve • Sondazhe dhe statistika të shënjestruara
<p>VSM 6 Përmirësim i kushteve të jetesës për popullatën 1. (trashëgimia kulturore, njerëzit, asetet materiale, kohezioni social, ajri, klima)</p>	<p>Përkeqësimi i Cilësisë së Strehimit(banesat e komunizmit)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kushtet e jetesës së popullsisë • Peizazhi • Trashëgimia kulturore (mbrojtja dhe restaurimi) • Mjedisi urban 	<ul style="list-style-type: none"> • Pastrimi i zonës përreth përreth pazarit deri më 2016(ndërtimi i infrastrukturës) • Restaurim dhe ri-veshje të fasadave historike në çdo 10 vite • Krijim hapësirash për parkim • Rritje e efikasitetit të energjisë 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i shtëpive të restauruara • Rritja e sipërfaqeve të parkimit. • Sipërfaqja e re e gjelbëruar sipas PPV 	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi GIS i monitorimit të PPV. • Regjistri i Administratës së Bashkisë për restaurimet. • Monitorimi i zbatimit të PPV (emergjenca për gjelbërim)
<p>VSM 7 Përmirësim i kushteve të jetesës për popullatën 2.</p>	<p>Problemet e aksesibilitetit dhe menaxhimit të trafikut</p> <ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura rrugore dhe 	<ul style="list-style-type: none"> • Hapësira të reja parkimi • Përdorim të biçikletave dhe transport publik 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i vendeve të parkimit • Gjatësia e rrugëve të reja • Gjatësia e rrugëve të shtruara 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistra bashkiak • Sistemi GIS i monitorimit të PPV • Vëzhgime të shënjestruara

(njerëz, infrastruktura publike)	<p>mjete alternative të transportit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kushtet e jetesës 	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i hapësirës për vendosjen e infrastrukturës për stacionet e autobuzëve, taksive, hekurudhor • Investime për një transport të qëndrueshëm 	<p>rishtas</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i përdoruesve të bicikletave 	<ul style="list-style-type: none"> • Studime të matjeve për trafikun
<p>SEA 8: Përmirësim i kushteve të jetesës për popullatën 3 (njerëzit, toka, peizazhi, mjedis i ndërtuar, asetet materiale)</p>	<p>Konflikti i Përdorimit të tokës ndërmjet vendeve industriale në afërsi të zonave të banuara</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kushtet e jetesës së popullsisë • Shëndeti publik • Krijimi i mundësive për punësim • Infrastruktura sipërmarrëse • peizazhi 	<ul style="list-style-type: none"> • largimi i të gjitha mbetjeve të rrezikshme brenda 2015 • përgatitja e zonës industriale brenda 2017 • largimi i shërbimeve industriale nga qyteti brenda 2020 • vendosja e rregullave për pastrimin e tokës 	<ul style="list-style-type: none"> • % e larguar e materialit të rrezikshëm • % e infrastrukturës së zonës industriale e kompletuar • Numri i ndërmarrjeve dhe vendeve të reja të punës në zonën e re industriale • % e aktiviteteve industriale të larguara nga qyteti 	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi GIS i PPV me të dhënat e komponentëve të aktiviteteve të biznesit • Raportet specifike vjetore të VSM në përputhje me kërkesat e departamentit të mjedisit në Ministri • Raportet tematike të PPV për progresin tregtisë dhe biznesit • Dispozita të detajuara për nënndarjet industriale të planit
<p>VSM 9 Përmirësim i kushteve të jetesës për popullatën 4 (peizazhi, zonat e gjelbra, ajri, klima, shëndeti i njeriut)</p>	<p>Humbja e zonave të gjelbra, hapësirave publike të hapur dhe infrastrukturës sportive</p> <ul style="list-style-type: none"> • kthimi i pronave • cilësi jetesës • shëndet publik • mjedisi urban 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e sipërfaqes së gjelbër • Ngritja dhe rehabilitimi e parqeve sportive publike • Përmirësim i cilësisë së ajrit 	<ul style="list-style-type: none"> • % e rritjes së sipërfaqes së gjelbër • Numri i parqeve sportive të reja • Numri i parqeve sportive të rehabilituara 	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi GIS i monitorimit të PPV • Matje të cilësisë së ajrit • Raporte tematike të PPV për përparimin e hapësirave publike

<p><u>VSM 10</u> Përmirësim i kushteve të jetesës për popullatën 5 (njerëzve, asetet materiale, kohezioni social)</p>	<p>Degradimi i zonës pas Pazarit te Korçës</p> <ul style="list-style-type: none"> • degradimin i lagjeve tradicionale të banimit • infrastruktura urbane • kushte banimi • ndotja akustike 	<ul style="list-style-type: none"> • rehabilitimi i zonës së Çarshisë • hapësira parkimi të reja në zonë • largimi i tregtisë me shumicë brenda 2016 • spostimi i stacionit të autobusëve 	<ul style="list-style-type: none"> • numri i parkimeve të reja • niveli i zhurmave • cilësia e ajrit • projekte pilot për rehabilitimin e Çarshisë 	<ul style="list-style-type: none"> • matje të nivelit të zhurmave • matje të cilësisë së ajrit • numri i banesave të rehabilituara • sistemi i monitorimit të PPV
<p><u>VSM 11</u> Zhvillim i qëndrueshëm shoqëror-ekonomik 1 (popullata, punësimi)</p>	<p>Varfërim i burimeve natyrore për një zhvillim të qëndrueshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> • mundësi për punësim • kohezion socio-ekonomik • infrastrukturë arsimit 	<ul style="list-style-type: none"> • investime të qëndrueshme përmes remitancave • krijimi pranë universiteteve të degëve të specializuara dhe trajnime profesionale • projekte pilot për Korcën si qendër e rëndësishme rajonale • zhvillimi i strategjisë së qytetit sipas strategjive tematike pasuese për biznes, turizëm, shëndet dhe shkollim brenda 2014 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i studentëve në Universitet • Numri i të punësuarve • Numri i projekteve pilot • Numri i bizneseve të reja 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrat e Bashkisë për bizneset • Regjistrat në universitete • Sondazhe, vëzhgime, dhe studime vlerësimi
<p><u>VSM 12</u> Zhvillim i qëndrueshëm shoqëror-ekonomik 2 (njerëz, punët, toka, asetet materiale)</p>	<p>Konsumi i tokës pjellore bujqësore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Peizazhi • Infrastruktura ekonomike • Politika punësimi 	<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja e sasisë së sipërfaqes se tokës bujqësore • Përmirësimi i cilësisë së tokës bujqësore • Zhvillimi i strategjive për prodhime “bio” • Kufizim ndërtimeve informale 	<ul style="list-style-type: none"> • Sasia e tokës bujqësore • Prodhimet “bio” • Numri i bizneseve agro • Numri i të punësuarve në bujqësi 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrat e bashisë për bizneset • Sistemi GIS i tokave • Lejet e ndërtimit

<p>SEA 13</p> <p>Zhvillim i qëndrueshëm shoqëror-ekonomik 3</p> <p>(trashëgimia kulturore, peisazhi, njerëzit, punët, asetet materiale)</p>	<p>Trashëgimia kulturore (mbrojtja dhe restaurimi)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Peizazhi, mjedisi urban, punësimi • Turizëm <p>Cilësia e jetës dhe kohezioni shoqëror</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Projekte për restaurime • Parandalimi i ndërtimeve brenda hapësirave • investimeve për ndërtime tradicionale në qendrën historike 	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i investimeve publike dhe private për ndërtime tradicionale sipas PPV • Numri i projekteve të restaurimit • Numri i vizitorëve në zonat tradicionale 	<ul style="list-style-type: none"> • Lejet e ndërtimit • Numri i banesave të rehabilituara • Regjistri i Administratës së Bashkisë për restaurimet.
---	---	---	--	--

7

Studimet Referuese Kryesore

- **STRATEGJIA MJEDISORE - (Strategjia Mjedisore dhe Ndersektoriale ; nëntor 2007) -** Gjendja e mjedisit ; Ndikimi mjedisor i aktivitetit për njësi; Vizioni, prioritetet strategjike dhe synimet; Përbushja e standardeve mjedisore; Përgjegjësia, monitorimi dhe vlerësimi.
- **UNDP 2004 –STRATEGJIA LOKALE ZHVILLIMIT TE QENDRUESHEM TE BASHKISE KORCE (2004)** Parimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm;Strategjia e Zhvillimit Rajonal; Profili Rajonal; Analiza SWOT.
- **STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR- Bashkia Korce (2005 – 2010)**
- **PLANI LOKAL I VEPRIMIT NE MJEDIS – Bashkia Korce (2005)**
- **STRATEGJIA E TRANSPORTIT – (Strategjia Sektoriale e Transportit 2008-2013)** Situata Aktuale ; Vizioni, Prioritetet, dhe Qëllimet ; Politikat për Realizimin e Objektivave.

-
- **STRATEGJIA NDERSEKTORIALE (Bujqësia)- (Strategjia ne Sektorin Bujqësor dhe Ushqimor 2007-2013)** ; Situata Aktuale ; Toka Bujqësore; Agro Industria; Zgjerimi , Kërkimet dhe transferimi i Teknologjisë ne Bujqësi; Politikat ndersektoriale.
 - **STRATEGJIA E FURNIZIMIT ME UJË (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013).**

8

Vështirësitë e hasura

Vështirësitë e hasura nga Grupi Konsulent VSM janë të lidhura me mungesën e disponueshmërisë së të dhënave dhe matjeve shkencore, komunikimi i dobët institucional dhe dobësitë administrative, mungesa e teknologjisë së duhur dhe sistemet e monitorimit.

Fusha e monitorimit dhe mbrojtjes të mjedisit është ende mjaft i dobët në Shqipëri, me gjithë hapat pozitive të ndërmarra në vitet e fundit drejt përmbushjes së standardeve të BE, siç është miratimi i Strategjisë Kombëtare të Mjedisit. Matje shkencore të aspekteve bazë janë ende të pakta dhe jo të rregullta në kohë. Monitorimi kërkon një përpjekje të koordinuar dhe angazhimin e të dy palëve, në nivel kombëtar e lokal, në mënyrë që të mbajë të dhëna të besueshme dhe të qëndrojë në bashkëpunim të vazhdueshëm. Konsulenti ka hasur vështirësi si në marrjen e të dhënave të përditësuara nga institucionet si dhe ndërlidhjen midis institucioneve, në mënyrë që të arrihte konkluzione të vlefshme. Dokumentet e Studimit LAMP, gjithashtu, pavarësisht spektrit të gjerë të referencave në intervistat dhe institucioneve të kontaktuar, reflektojnë dobësinë e të dhënave në disa aspekte veçanërisht në sektorin socio-ekonomik.

Procesi i zbatimit të VSM-se është një përpjekje kolektive që duhet të zhvillohet me kalimin e kohës, në etapa të rëndësishme, por edhe si pjesë e veprimeve rutinë të autoriteteve bashkiake. Ndërtimi kapaciteteve lokale është një faktor shumë i rëndësishëm, i cili është evidentuar qartë në objektivat e projektit LAMP. Kjo përpjekje ka filluar, por mbetet akoma për t'u bërë. Trajnimi i administratës bashkiake në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, duhet të shoqërohet me angazhimin dhe investimet në pozicionet e tyre të punës. Mungesa e rrjeteve të komunikimit institucional të themeluara dhe bashkëpunimit mes nivelit lokal, rajonal dhe kombëtar

është një pengesë e madhe në këtë përpjekje për të krijuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri.

Teknologjia është gjithashtu një faktor shumë i rëndësishëm për monitorimin e VSM-se. Zbatimi i Planit në vetvete përmban një mjet shumë të vlefshëm, qe është përditësimi i bazës së të dhënave të GIS, i cili mundëson përditësimin e vazhdueshëm të ndryshimit të përdorimit të tokës dhe të procesit të zhvillimit. Gjithashtu, leja e zhvillimit të procesit, sipas ligjit 10119/2009, e cila kërkon transferimin e vendimeve të zhvillimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, përbëjnë mjetet, që sipas përkufizimit, lejojnë monitorimin e vazhdueshëm të procesit të zbatimit të planit.

Ende të dyja këto mjete teknologjike nuk mund të zbatohen para se bashkitë të marrin software-in duhur GIS. Sistemi mbështetës aplikohet në nivelin kombëtar për të mbuluar të gjithë territorin e vendit (12 qendrat asistence).

Deri sa këta faktorë të maturohen, procesi VSM do të vazhdojë të zbatohet me vështirësi në hapat e tij të para dhe është i bazuar në angazhimin dhe përkushtimin e stafit bashkiak.

9

Përmbledhje joteknike

Hyrje

Qëllimi i këtij raporti mjedisor është :

- të sigurojë informacion mbi procesin e Vlerësimit Strategjik të Mjedisit (VSM) lidhur me Planin e Përgjithshëm Lokal të Korcës;
- të identifikojë, përshkruajë dhe vlerësojë efektet e mundshme të rëndësishme të Planit; dhe
- të sigurojë mundësi për Këshillin Bashkiak, autoritetet në nivel kombëtar (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit) dhe publikut në përgjithësi pikëpamje mbi Raportin Mjedisor.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor kërkohet sipas *Ligjit 10119/2009 "Për Planifikimin e Territorit"* të ndryshuar dhe *Ligjit 91/2013 për "Vlerësimin Strategjik Mjedisor"* dhe ligjit 10440/2011 për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis". Ai synon të:

- integrojë vendimmarrjen mjedisore në përgatitjen e planit dhe vendimmarrje;
- përmirësojë planet dhe forcojë mbrojtjen mjedisore; dhe
- rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore.

Konteksti i Planit të Përgjithshëm Vendor të Planifikimit të Territorit

Studimi i Planit Vendor të Përgjithshëm të Territorit të Lushnjës u përgatit në periudhën 2009-2010 në bazë të projektit LAMP II të Qeverisë së Shqipërisë, me mbështetjen financiare dhe teknike nga Banka Botërore. Përgatitja e planit mori në konsideratë dispozitat e Ligjit

10119/2009 mbi planifikimin territorial, që reflekton parimet e BE-se mbi planifikimin e qytetit si dhe standardet ndërkombëtare dhe parametrat në planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit. Propozimet e planit janë zhvilluar duke pasur parasysh politikat e një numri të ndryshëm të ministrive dhe të institucioneve në nivel kombëtar, si dhe direktivat rajonale. Në fazat e mëvonshme Bashkia është angazhuar me mbështetjen e konsulentëve të specializuar (TP DEVELOPMENT GROUP), për të rregulluar komponentët rregullatore dhe formatimin e planit në mënyrë që të sigurojë përputhjen me legjislacionin dytësor dhe rregulloret kombëtare, si dhe vendosjen e kontakteve dhe bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Plani i cili parashikon një vizion afatgjatë për zhvillimin e ardhshëm dhe rregulloret e detyrueshme për 10 vitet e ardhshme është dorëzuar për konsultim publik në faza të ndryshme, duke ndjekur udhëzimet e ligjit. Ai ka tre komponentë kryesore të përbërë nga : 1. një vizion të zhvillimit territorial dhe strategjinë lidhur me zhvillimin e ardhshëm të qytetit, 2. një plan hapësinor, i cili përmban përdorimin e tokës dhe Rregulloret e Kontrollit të zhvillimit për tërë territorin bashkiak dhe 3. Një Plan investimi strategjik të Infrastrukturës e cili përfshin struktura prioritare projektsh te lidhura me struktura urbane të qytetit.

Presionet kryesore mjedisore te fushës se Studimit

Analiza e gjendjes ekzistuese e fushës se Studimit ka zbuluar këto çështje kyçe mjedisore dhe problematika qe duhet të adresohen nga Plani:

- Standardi i ulët i cilësisë së ajrit
- Ndotja e ujit të pijshëm
- Shpyllëzimi, erozioni tokës dhe humbja e biodiversitetit
- Mangësitë e Menaxhimit tembeturinave
- Mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor
- Perkeqesimi i Cilësisë se Strehimit
- Problemet e aksesibilitetit dhe menaxhimit të trafikut
- Konflikti i Përdorimit te tokës ndermjet vendeve industrial në afërsi të zonave të banuara
- Humbja e zonave të gjelbra, hapësirave publike të hapur dhe pajisjeve
- Degradimi i zonës pas Pazarit te Korçës
- Rreziku i paqëndrueshëm ne rrugën e zhvillimit ekonomik që shteron burimet natyrore
- Konsumi i tokës pjellore bujqësore
- Identiteti dëmtues historik dhe zhvillimi potencial i turizmit të qytetit

Objektivat e VSM-se

Raporti Mjedisor ka adaptuar 13 objektiva të VSM-se, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me presionet kryesore mjedisore siç ato janë zbuluar nga analiza e fushës së studimit.

Këto objektiva janë grupuar në tre kategori që lidhen me qëllimin e planit dhe orientimin, përkatësisht i) krijimin e një mjedisi të përmirësuar të jetesës për njerëzit, ii) krijimin i një zhvillimi të qëndrueshëm socio-ekonomik, dhe iii) ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit. Objektivat përmbushin kërkesat e Direktivave të BE-së dhe legjislacionit shqiptar (Ligji.91/2013; L.10440/2011) dhe ata janë të lidhur me objektiva ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm dhe objektive kombëtare të mjedisit dhe planifikimit territorial (Kapitulli 3).

Skenarët Alternative

Gjatë kryerjes së VSM-se, ekipi duhet të vlerësojë efektet e mundshme mjedisore, sociale dhe ekonomike të planit urbanistik, si dhe të alternativave të arsyeshme që mund të kishin ndjekur pa ekzistencën e këtij plani të veçantë Urban. Kapitulli 4 kryen vlerësimin e katër alternativave në lidhje me ndikimin e tyre mbi objektivat e VSM:

- ‘Skenari zero’ nënkupton skenar me investime minimale dhe të pakontrolluar dhe në mungesë të një Plani, vlerësimi për impaktin e tij në cilësinë e jetës, interesi në drejtimin turistik të qytetit dhe rritjen e tij, etj.
- Skenari “Zhvillim urban vetëm me përmirësime mjedisore”. Si dhe sa do të ndikojë ky lloj skenari në zhvillimin e qytetit, çfarë duhet bërë për tërheqjen e banorëve të rinj? Ky skenar shmang zhvillimet informale dhe të çrregullta me gjithë problematikën e tyre që lidhet me mjedisin dhe shëndetin e popullatës.
- Skenari i tretë mundëson të vlerësohet tërësia e projekteve të zhvillimit vetëm ekonomik duke i dhënë përgjigje pyetjeve si: Cili nga projektet e zhvillimit ekonomik dhe rritjes urbane, bazuar në forcën e tregut, do të ndikojë në cilësinë e jetës në qytet? Kjo pjesë do të vlerësojë nën-skenarët e ndryshëm të zhvillimit alternativ të propozuar në fushën e turizmit, logjistikës, agrobiznesit, etj duke

përzgjedhur ata që janë më të qëndrueshëm. Skenari tre (3), trajton problemin e mungesës së punësimit dhe mundësive për zhvillim ekonomik.

- Plani i propozuar mundëson integrimin e të gjitha masat e nevojshme shtesë, për një rritje të qëndrueshme. Në thelb kjo nënkupton, skenarin katër (4), kombinim i 2 dhe 3 në vizionin hapësinor.

Vlerësimi i Planit te qytetit

Kapitulli 5 përfshin vlerësimin e ndikimeve të pritshme mjedisore te skenarëve të përzgjedhur dhe masat e parandalimit / zbutjen. Procesi Vlerësimit është bazuar në një korrelacion matricor dhe metodologjinë e vlerësimit, që krahason 14 VSM-te të zhvilluara në kapitullin 3, kundrejt një sërë nen-veprimesh, programesh dhe projektesh për secilin prej 3 komponentëve te Planit te Zhvillimit Urban Plan LAMP.

Komponenti 1: Strategjia dhe Vizioni i zhvillimit te Qytetit

Në përgjithësi, masat e zhvillimit sipas këtij komponenti, u gjetën për te pasur një efekt neutral ose një efekt pozitiv në VSM, që lidhen me krijimin e një mjedisi tërheqës ekonomikisht të qëndrueshëm, duke forcuar rolin e Korces si nje qender rajonale ekonomike me ndikim pozitiv në të ardhurat e njerëzve dhe financat bashkiake.

Një numër i efekteve të mundshme negative u identifikuan në lidhje me shtimin e trafikut, degradimin e cilësisë së ajrit, ndotjes akustike (zhurma) dhe konsumin e tokës bujqësore me prioritet të parë.

Ndikimi me i madh pozitiv do të jetë në rritjen e popullsisë, si dhe në cilësinë e jetës, ndërsa efekt negativ potenciali kumulativ është degradimi i cilësisë së mjedisit urban në mungesë të masave parandaluese. Te gjitha efektet se bashku kane rezultuar në rritjen e biznesit, tërheqjen e investimeve dhe të banorëve të rinj, si dhe bizneseve dhe ndërtesave për banim të shoqëruara me rritjen e trafikut. Zhvillimi i aktiviteteve të reja industriale duhet të jetë i balancuar në lidhje me efektet e tij negative në reduktimin potencialisht ne atraktivitetin e qytetit si një destinacion turistik.

Komponenti 2: Plani i Strukturës bashkiake

Të gjitha politikat e zhvillimit hapësinor, sipas këtij komponenti, kontribuojnë pozitivisht në VSM që lidhet me krijimin e një qyteti kompakt, me një imazh të përmirësuar civil dhe veprimtari tregtare, si dhe nxitjen e bashkëveprimit social.

Eliminimi i konflikteve të shfrytëzimit të tokës përmes rregulloreve do të ketë një efekt pozitiv në shëndetin publik, cilësinë e ajrit, cilësinë e ujit dhe atraktivitetin e mjedisit urban, duke parandaluar zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve të rrezikshme afër zonave të banimit, ndërkohë që mbrojtja e hapësirave të gjelbra periferike-urbane dhe tokës bujqësore do të kontribuojë në ruajtjen e peizazhit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të tokës. Stimujt për të përmirësuar cilësinë e strehimit në zonat urbane ekzistuese, do të ketë një ndikim pozitiv mbi cilësinë e jetës dhe të kursimit të energjisë.

Efektet potenciale negative në mjedis, që rrjedhin nga këto politika hapësinore përfshijnë rritjen e densitetit urban në mungesë të zbatimit të duhur të rregullave, rritjen e çrregullimeve mjedisore nëse infrastruktura e duhur nuk është e planifikuar në ish zonat informale dhe bllokimet e trafikut në mungesë të marrjes së masave të duhura. Kufizimet e përdorimit të tokës mund të çojnë në humbjen e të ardhurave nëpërmjet zhvendosjes së disa aktiviteteve operative dhe bllokimin e investimeve të reja për zhvillim. Politikat do të kenë një efekt të madh pozitiv në atraktivitetin e qytetit si një vend për të punuar, jetuar, luajtur dhe studiuar dhe do të përmirësojë kushtet ekonomike dhe shëndetësore të banorëve.

Aneksimi i zonave të reja urbane brenda planit do të ketë një ndikim pozitiv ndër-funksional në strukturën e qytetit dhe organizimin e aktiviteteve, si dhe një bashkëveprim social të qytetit dhe do të sigurojë burime shtesë financiare për Bashkinë. Modifikimi i përdorimit të strukturës së tokës do të ketë një ndikim të përzier sinergjik mbi modelet e lëvizshmërisë, ndërsa përmirësimi i peizazhit do të ketë ndikim sinergjik në rritjen e biznesit të turizmit.

Komponenti 3: Plani strategjik i Investimeve në Infrastruktura

Të gjitha projektet e infrastrukturës sipas këtij komponenti, përfaqësojnë investime me prioritet të lartë që do të përmirësojnë pozitivisht situatën për shëndetin publik në qytet dhe do të ketë ndikim pozitiv mbi cilësinë e jetës në përgjithësi. Ripyllëzimi i kodrave të kombinuara me zhvillimin e infrastrukturës së turizmit do të ketë një efekt pozitiv mbi cilësinë e ajrit dhe biodiversitetit, imazhin e qytetit dhe atraktivitetin e turizmit të qytetit, si dhe rritjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe hapësirat publike të hapura dhe mundësitë rekreative të ofruara për banorët urban. Investimet në infrastrukturën e transportit vendos rolin e qytetit si një qender rajonale ekonomike,

tregtare e administrative dhe përmirësojnë lidhjen midis zonave të qytetit dhe zonave të reja të banimit. Gjithashtu rindërtimi i rrugëve dhe rehabilitimi i tyre do të përmirësojë cilësinë e rrugëve me efekte anësore pozitive në reduktimin e ndotjes nga pluhuri në qytet. Rehabilitimi i venddepozitimeve të mbetjeve ekzistuese dhe permiresimi i menaxhimit të mbeturinave do të reduktojë në shkallë të lartë emetimet e dyoksidit në ajër dhe rritjen e sipërfaqeve të gjelbra me mbjelljen e pemëve përgjatë rrugëve për këmbësorë biçikleta, do të ndikojë pozitivisht në zbukurimin e qytetit dhe krijimin e një qyteti modern, duke ofruar hapësira për zbavitje dhe kohë të lirë për komunitetin.

Cilësia e jetesës është ndikimi me pozitiv që krijon përmirësimi i infrastrukturës. Permiresimi i shëndetit publik përmes trajnimit fizik do të jetë një nga efektet pozitive nder-funksionale. Përmirësimi i mjedisit dhe mikroklimës urbane do të ndihmojë në aktivitetet rajonale turistike, do të çojë në tërheqjen e banorëve të rinj të cilët si pasojë do të rrisin nevojat e tyre për strehimin. Gjithashtu duke ulur përdorimin e mjeteve motorike do të zvogëlohet niveli i ndotjes që lidhen me trafikun. Zbatimi i rregullave më strikte për ndërtimin, do të zvogëlojë rrezikun sizmik, por mund të çojë në humbjen e vendstrehimeve për disa familje që janë vendosur në ndërtimet problematike. Zbatimi i rregullave më të rrepta për funksionimin e Pazarit të Korçës do të ketë efekte pozitiv sinergjik mbi kushtet e trafikut, si dhe reduktimin e zhurmës, ndotjes së ajrit dhe zbutjen e ndikimeve negative në zonat fqinje qendrore rezidenciale.

Masat zbutëse Mjedisore

Raporti Mjedisor duhet të tregojë masat e parashikuara për të parandaluar, zvogëluar dhe kompensuar çdo efekt negativ në mjedis nëpërmjet zbatimit të Planit. Disa masa zbutëse janë ndërtuar në politikën e planit, deri aty sa i kërkon zhvilluesve të adresojnë çështje të ndryshme mjedisore. Do të jete në dorë të Bashkisë për të siguruar, për aq sa është e mundur, se këto kërkesa janë plotësuar, për të minimizuar ndikimet mjedisore që rrjedhin nga zhvillimi. Për më tepër disa nga propozimet e planit, kryesisht projekte të infrastrukturës, të tilla si rryllëzimi i kodrave, përmirësimi i infrastrukturës së transportit, rehabilitimi i venddepozitimeve etj , përbëjnë masat zbutëse për ndikimin mjedisor e masave të tjera zhvillimore dhe politikën hapësinore të Planit. Vlerësimi i propozimeve specifike të Planit identifikuan masa lehtësuese të nevojshme për propozimet e zhvillimit individual, të cilat janë të përcaktuara në tabelat e Kapitullit 5.

Monitorimi

VSM kërkon që Bashkia të monitorojë efekte të rëndësishme mjedisore të zbatimit të çdo plani ose programi kualifikues, për të cilën ai ka kryer një vlerësim mjedisor dhe të identifikojë efekte të paparashikuara negative në një fazë të hershme, si dhe të ndërmarrë veprime korigjuese të përshtatshme. Një proces monitorimi dhe rishikimi është projektuar për t'u drejtuar paralelisht me zbatimin e PPV-se, duke qenë një pjesë integrale e tij. Të gjitha të dhënat, synimet dhe shifrat janë të bazuara në objektivat aktuale të PPV-se, në kërkesat e standardeve kombëtare dhe pritet të përmirësohen gjatë të njëjtës rrugës që Shqipëria po ndërmerr për të aplikuar standarde që propozohen nga BE apo marrëveshje të tjera ndërkombëtare. Matjet do të bazohen në metoda dhe burimeve të ndryshme, duke përfshirë sistemin GIS të PPV-se, të dhënat kombëtare, statistikat lokale, matjet shkencore dhe të këshillit bashkiak, si dhe vendimet administrative (të tilla si lejet e zhvillimit).

Konkluzioni i Raportit

Procesi VSM është një pjesë integrale e procesit të përgatitjes së planit. Ndërsa elemente të procesit të vlerësimit mjedisor janë miratuar gjatë përgatitjes së Planit, ato nuk janë regjistruar formalisht. Plani i VSM, duke identifikuar disa ndikime negative mjedisore, duhet të ketë efektin e përmirësimit të përgjithshëm të kushteve mjedisore në të gjithë qytetin, veçanërisht në ato zona të cilat do të përjetojnë forma të tjera zhvillimi ose rinovimi. Kjo do të adresojë disa nga objektivat mjedisore që mund të monitorohet me kalimin e kohës. Kudo që të jetë e mundur, masat zbutëse duhet të paraqiten në skemat zhvillimore, të cilat kanë potencial për të ndikuar negativisht mbi mjedisin, në mënyrë që të minimizohet ndonjë ndikim i pafavorshëm, duke synuar të reduktojë “gjurmët ekologjike” në qytet.

10

Referenca

Raporti i vizionit dhe strategjisë për zhvillimin e qytetit (për qytetet Berat, Gjirokastrë, Korçë, Korçe). Projekti LAMP II Shkurt 2010

Raporti i Planit Strukturor të Bashkisë (për qytetet Berat, Gjirokastrë, Korçë, Korçe). Projekti LAMP II Prill 2010

Raporti i Planit Strategjik për Investimet në Infrastrukturë (për qytetet Berat, Gjirokastrë, Korçë, Korçe). Projekti LAMP II Maj 2010.

Raporti i Planit Rregullues (për qytetet Berat, Gjirokastrë, Korçë, Korçe). Projekti LAMP II Gusht 2010.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 8934/2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 8990/2003, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Vendimi 259/2007 “Për miratimin e rregullores për normat minimale të planifikimit urban dhe standardet e urbanizimit të zonave informale”

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Vendimi 282/1961, “Për rregulloren e ndërtimit të planifikuar të qyteteve” [Vetëm në variantin shqip].

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Vendimi 455/2005, “Për projektimin e ‘Qendrës Historike’ dhe ‘Ansambli urban, arkitekturor dhe tradicional’ të Korçës”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Vendimi 676/2002 “Për deklarimin e monumenteve natyrore në Shqipëri si zona të mbrojtura”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Vendimi 722/1998 “Rregullorja e Urbanistikës”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Vendimi 826/2005, “Për administrimin e qendrës historike të qytetit muze të Beratit”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Vendimi 832/2003, “Për miratimin e rregullores së administrimit të qytetit muze të Gjirokastrës”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Projektvendimi 860/2007, “Për miratimin e rregullave bazë për krijimin dhe funksionimin e zonës ekonomike”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 10119/2009, “Për planifikimin e territorit” [draft përkthim në anglisht].

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 7501/1991, “Për tokën”

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 7623/1992, “Për pyjet dhe shërbimin e policisë pyjore”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 8093/1996, “Për burimet hidrike”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 8378/1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 8405/1998, “Për planifikimin urban”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 8652/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 8906/2002, “Për zonat e mbrojtura”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 9048/2003, “Për trashëgiminë kulturore”.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 9235/2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 9482/2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtesave pa leje”

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ligji 9789/2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”.

Bashkia e Korces

Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë

Marrëdhënia ndërmjet Direktivave të VNM-së dhe VSM-së, Imperial College of London, Raporti Përfundimtar i Komisionit Evropian, 2005.

Metodat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Redaktuar nga Peter Morris dhe Riki Therivel, Botimi 3-te, 2009

